



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 21, 24, 25 DHE 30 JANAR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 21, 24, 25. I 30. JANUARA 2013. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e organeve,
5. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës,
6. Shqyrtimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017,
7. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
8. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o transplantaciji organa,
5. Razmatranje predloga Vlade Republike Kosova o izmeni i dopuni Statuta Univerziteta u Prištini,
6. Razmatranje Strategije i Plana delovanja protiv korupcije za period 2013 - 2017,
7. Izbor članova Saveta nezavisne komisije za medije,
8. Izbor članova Saveta Radiotelevizije Kosova.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, e përcakton rendin e ditës për mbledhjet e radhës së Kuvendit, prandaj rendin e ditës e kemi dhe sipas Rregullores po fillojmë në kohën e përcaktuar paraprakisht nga Kryesia bashkë me grupet parlamentare.

Është koha e deklarimeve jashtë rendit të ditës. Po, urdhëro zoti Beqiri për rend të ditës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe pse kolegët janë duke ardhur, unë në fillim të seancës, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kërkoj që kjo seancë të mos mbahet sot, përkatësisht të shtyhet për të enjten. Arsyeja është se sot është 21 janari, 7-vjetori i vdekjes së Presidentit Rugova, dhe grupi ynë parlamentar, por edhe të tjerët, kemi aktivitete institucionale dhe në emër të Grupit Parlamentar kërkoj që kjo seancë të shtyhet për ditën e enjte, dhe sigurisht janë shefat e grupeve parlamentare të partive tjera politike që do të deklarohen. Unë e kam bërë një konsultim edhe me ata, por për këtë ju njoftojnë vetë ata. Prandaj, edhe një herë kërkoj që kjo seancë të shtyhet, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne e kemi të pamundur të jemi pjesë, qoftë tash, qoftë pasdite, e punimeve në këtë seancë dhe mendoj që është minimumi i respektit që mund ta bëjmë për këtë që e thashë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo çështje është diskutuar në Kryesinë e Kuvendit, bashkë me shefat e parlamentare. Është përcaktuar hapësira kohore dhe të gjitha mundësitë janë që duke filluar nga ora 11:00 deri në 15:00 për aktivitetet që janë përcaktuar të jemi të lirë.

Unë mendoj se nuk ka ndonjë problem sa më përket mua, por është obligim sipas Rregullores dhe Kushtetutës, prandaj ne po vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka kërkuar zoti Shaip Muja. Nuk është këtu. Zoti Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryesues!

Edhe ne Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim kërkesën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Vlerësojmë se nuk ka asnjë kuptim që ne sot të vazhdojmë me seancë, përderisa ka aktivitete shumta, prandaj kërkojmë që të shtyhet kjo seancë për ditën e enjte. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERY: Faleminderit kryesues!

Nuk është se sot nuk kemi çka të diskutojmë. Natyrisht, kemi shumë ngjarje që po ndodhin edhe në Kosovë, por edhe me shqiptarët gjithandej dhe qytetarët e Kosovës do të kishin pritur që Kuvendi ta thotë fjalën e vet rreth këtyre gjërave, mirëpo nëse janë shumica për ta shtyrë seancën, ne nuk e kundërshtojmë. Domethënë e pranojmë shtyrjen, por megjithatë do të kishim për çka të flisnim sot.

KRYESUESI: Zoti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit nënkryetar!

Edhe ne e mbështetim mocionin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për shtyrjen e seancës për ditën e enjte. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Duke marrë parasysh se sot është përvjetori i vdekjes së Presidentit Rugova, atëherë edhe Aleanca për Kosovën e Re e përkrah Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që seanca e ardhshme të mbahet ditën e enjte.

KRYESUESI: Sasha Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: I mi se slažemo sa ostalima da se ova sednica odloži za četvrtak.

KRYESUESI: Zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit i nderuar nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për shtyrjen e seancës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në sallë janë 66 deputetë. E hedh në votim formal kërkesën pothuaj të të gjitha grupeve parlamentare. Votojmë tash! Kush është për shtyrjen e seancës? Kundër? Asnjë.

Kryesia e Kuvendit do të ju njoftojë për seancën e radhës. Faleminderit!

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes plenare, më 24 janar 2013.)
(Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i vazhdon punimet sipas rendit të ditës të mbledhjes plenare, të ndërprerë më 21 janar 2013.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit 3 minuta.

Vazhdojmë. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Të falënderoj dhe meqenëse Vjosa do të flasë në emër të Grupit, a bën nëse më vjen radha, të jem i dyti. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë, dhe ju ministra që jeni sot prezent.

Lidhja Demokratike e Kosovës edhe një herë përshëndet miratimin e Rezolutës dhe rekomandimeve të Këshillit të Evropës që u përgatitën nga deputeti suedez, Bjorn von Sydow.

Përkundër paragjyqimeve të mëdha që kishin një numër i deputetëve në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, u arrit të miratohet një rezolutë që ka një përmbajtje më të mirë se ajo e vitit të kaluar.

Këtu duhet të njihet edhe kontributi i Kuvendit të Kosovës që nëpërmjet kontakteve të shumta me Asamblenë Parlamentare ka arritur të ketë një rol të rëndësishëm në miratimin e këtyre dokumenteve.

Më e rëndësishmja për vendin tonë, natyrisht, është thirrja që bëhet në rezolutë për kontakte të drejtpërdrejta në mes të zyrtarëve të Këshillit të Evropës dhe institucioneve të Kosovës dhe po ashtu ftesa që i bëhet Grupit të Grave Deputete, për të vënë kontakte të drejtpërdrejta me mekanizmat e Këshillit të Evropës, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grave.

Siç e dimë shumë prej nesh, nga viti 2008 ky institucion kishte kontakte shumë të kufizuara, në disa nivele madje edhe inekzistente, me institucionet e Kosovës, për shkak të politikës neutrale ndaj statusit, prandaj intensifikimi i kontakteve dhe zhvillimi i tyre në nivelet më të larta, natyrisht se është një hap pozitiv.

Megjithatë, duhet të gjithë ta kemi të qartë që hapi drejt anëtarësimit të Kosovës në këtë mekanizëm, nuk bëhet me rezoluta. Hapi drejt anëtarësimit të Kosovës në këtë institucion, mund të fillojë vetëm e vetëm nga Kosova. Gabohemi nëse presim që ftesën të na e bëjë Këshilli i Evropës. Anëtarësimi bëhet me një votim final në Këshillin e Ministrave të këtij institucioni dhe Kosova tashmë e ka plotësuar kushtin formal, sepse ka 34 nga 47 vota, pra më shumë se 2/3 që kërkohet.

Është prandaj për të ardhur keq që Qeveria e Republikës së Kosovës ka hezituuar të bëjë hapa konkret drejt anëtarësimit në këtë organizatë, përkundër asaj që LDK-ja vazhdimisht ka bërë thirrje të ndërmerren hapat e parë të lobimit në Asamblenë Parlamentare, në Sekretariatit të Këshillit të Evropës, ambasadorët e akredituar në Strasburg dhe ka më se dy vjet që kemi bërë thirrje që të hapet një përfaqësi në Strasburg, që do të merrej ekskluzivisht me Këshillin e Evropës.

Ministria vazhdimisht i ka injoruar këto kërkesa dhe e ka injoruar Kuvendin si institucion duke mos i ofruar Kuvendit asnjë informatë rreth zhvillimeve në këtë organizatë. Zhvillimi i diplomacisë parlamentare, prandaj ka mbetur në nivelin zero, përkundër asaj që është pjesë e strategjisë së MPJ të miratuar në Qeverinë e Kosovës. Ministria nuk përfshin Kuvendin në asnjë aktivitet të saj diplomatik. Tani që më në fund u hap Konsullata në Strasburg, MPJ nuk e pa të udhës as të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës, që është emëruar një konsull i përgjithshëm në atë vend.

Madje, ne si deputetë u ndiem shumë keq kur një ambasador i një vendi të Kuintit në Strasburg duke aluduar në mungesën e kontakteve me institucionet e Kosovës tha se i ka ardhur shumë rënd kur për Konsullatën e Kosovës në Strasburg e mori vesh nga përfaqësuesit e Serbisë.

Edhe pse një hap i vonuar, ne bëjmë thirrje që kjo konsullatë të funksionalizohet, të përforcohet edhe me staf shtesë në mënyrë që të avancojë kontaktet me Këshillin e Evropës. Anëtarësimi në këtë organizatë duhet të jetë prioriteti numër një i Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2013.

Nuk duhet harruar që asnjë shtet nuk ka arritur të hyjë në BE pa qenë paraprakisht anëtar i Këshillit të Evropës. Kjo njëherësh do t'i hapte rrugë qasjes së qytetarëve të Kosovës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfundimisht, të nderuar deputetë, nuk duhet harruar që edhe pse kjo rezolutë konsiderohet hap pozitiv sa i përket aspektit politik të kontakteve, pasqyra e Kosovës aty paraqitet mjaft e errët. Fjalët që mbizotërojnë janë: korrupsion, krim i organizuar, varfëri, mungesë e sundimit të ligjit, trafikim i njerëzve, dhunë, joefikasitet dhe fenomene tjera

negative, që në fakt janë pasqyrim i një realiteti të hidhur me të cilin duhet të ballafaqohet Qeveria e Kosovës.

Prandaj, në vend se të fshehët prapa një paragrafi të mirë të kësaj rezolute, Qeveria do të duhej urgjentisht të merret me sfidat e paraqitura aty.

Ne kemi dëshmuar edhe në të kaluarën se përkundër numrit shumë më të vogël të njohjeve kemi arritur anëtarësimin në institucione të rëndësishme ndërkombëtare, si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe të tjera, krejt kjo falë një përkushtimi, koordinimi institucional që është esencial, dhe lobimi intensiv me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe me shtetet jonjohëse.

LDK-ja vlerëson se vetëm me një qasje të tillë si ajo e anëtarësimit në Bankën Botërore dhe FMN, Kosova do të mund të arrijë anëtarësimin në këtë institucion të rëndësishëm evropian.

LDK-ja mbetet e hapur të japë kontributin e saj institucional dhe....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit kryetar!

Përshëndetje për të gjithë.

Në Këshillin Evropian është miratuar një rezolutë e mirëpritur kohë të gjatë në favor të Kosovës dhe kjo duhet t'i gëzojë dhe t'i inkurajojë të gjithë qytetarët e Kosovës.

Por, përmbajtja e raportit në Asamblenë e Këshillit të Evropës ma imponon një sentencë nga një dialog i një bujku me bashkëshorten e tij në kohën e iftarit.

Duke dyshuar në saktësinë e orës së tij, bujku e porosit bashkëshorten për të dëgjuar ndonjë zë daulleje si lajmëtar për iftar.

Kur iu duk se po vonohej ajo, ky e pyet: A po ndien ndonjë tupan?

Edhe gruaja ishte lodhur nga agjërimi dhe nuk u besonte veshëve, me ndrojtje i tha: Një tupan po ndihet.

Ky me rrëmbim ia ktheu: A, surlet po i pret, a?

Të nderuar deputetë,

Edhe lidërshipi i skenës politike të Kosovës, pozitë dhe opozitë, duhet të përjetojnë si lajmëtar dhe sinjal të kohës së veprimit dhe nuk duhet të hamenden duke pritur tingujt e surleve për të ndryshuar këtë realitet. Duke i ndryshuar qasjet e tyre dhe duke u bërë më të përgjegjshme, pozita t'i largojë zyrtarët me qasje abuzive, ndërsa opozita të largojë nga energjitë negative dhe projektet rrënuese e obstruktive që i ka në zhvillim.

Raporti i vlerësimeve në Këshillin e Evropës për gjendjen në Kosovë, na pëlqeu apo nuk na pëlqeu, është real apo i njëanshëm, institucionet e Kosovës duhet t'i mobilizojë për të ndryshuar këtë perceptim evropian dhe këtë vlerësim të Këshillit të Evropës.

Kjo nuk bëhet me abra kadabra, kjo nuk arrihet me justifikime patetike, as me retorikë etatiste, as me manire e establismente megalomane dhe madje kultivimi i këtyre diskurseve që nga dje, është i pafalshëm për klasën politike dhe për gjithë neve që shkojmë mbrapa tyre.

Për këto arsye i gjithë lidershipi duhet të reflektojë dhe duhet të tregohet më i përgjegjshëm për interes të vendit dhe të qytetarëve tanë, duke kaluar mbi interesa personale, klanore dhe partiake, duke mos qenë rob nga edukata e traditës sonë në raporte të ndërsjella, në këto zhvillime politike të cilat i imponojnë kthesa dhe ndryshime të domosdoshme.

Partnerin në koalicion e tipizon mungesa e kohezionit dhe vizionit politik, për mungesë të profilimit dhe për arsye të reduktimit deri në kufijtë e pamjaftueshëm për të funksionuar në partneritet të duhur.

Është koha për të bërë ndryshime në Qeveri dhe në politikat qeverisëse. Për këtë arsye, lidershipi karizmatik i AAK-së duhet të reflektojë realisht për interesa të vendit dhe jo të rrëshqasë në kalkulime të paakceptueshme për të përvetësuar nga momenti ndonjë objektiv të paarritshëm, sepse edhe nuk mund ta arrijë. Duhet të pranojë bashkëqeverisje duke kërkuar pozitë ekzekutive dhe autoritative, për të koordinuar së bashku me resorët e drejtësisë dhe të sigurisë edhe me shtyllat përkatëse të kompetencës ndërkombëtare, në bashkëpunim edhe me ta të ndryshohet realiteti dhe të krijojmë imazh që kërkohet nga Rezoluta e Këshillit të Evropës për një Kosovë ku funksionon ligji dhe siguria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Liburn Aliu e ka fjalën në emër të Grupit.

LIBURN ALIU: Në një intervistë të fundit që ua dha mediave, kryeministri i Kosovës akuzoi krerët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit si dhe i bëri përgjegjës shqiptarët e asaj ane - pse nuk e mbrojtën përmendoren e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, të cilën e hoqi xhandarmëria e Daçiqit?

Në fillim të negociatave ishte vetë kryeministri ai që u premtoi shqiptarëve atje se do ta shtronte çështjen e Luginës në negociata me Serbinë dhe se do t'i mbronte interesat e shqiptarëve në këto negociata. Është pikërisht çështja e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë ajo që u shndërrua në atmosferën relaksuese gjatë këtyre negociatave, aludohej herë në këmbim territoresh, e herë në të drejtat e tyre.

Për shkak të kësaj, shqiptarët atje, i kthyen plotësisht sytë kah Prishtina me shpresë se të drejtat e tyre do të shtroheshin në takimet e Thaçit me Daçiqin, dhe pikërisht për shkak të kësaj që atyre iu premtua, ata edhe i përkrahën negociatat.

Në takimet që unë pata me përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe në bisedë me ta, më të vështirën e kisha që t'i bindi ata se ata nuk do të jenë temë në këto negociata, pasi nuk do të jenë madje as kusht.

Gjatë gjithë kohës politikanët atje, pra edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës, politikanët tanë i mbajtën në iluzione dhe me premtimin se do t'i mbrojnë e madje edhe t'i inkurajojnë të rrinë dhe gjatë tërë kohës ata i inkurajuan ata që të integrohen në jetën institucionale, atje. Dhe gjatë tërë kohës, përderisa ndodhnin negociatat, shqiptarët atje vazhdonin të duronin terrorin e dhunën nga Serbia e tash kur përnjëmend duhet të mbrohen, ata akuzohen për qyqarllëk.

Këta politikanë shtetin e kanë ndërtuar për vete, për pasurim personal dhe për sigurinë e vetvetes, por kur është puna e mbrojtjes së shqiptarëve të pambrojtur, u thonë atyre: bëjani zgjidhjen vetes. Vetë nuk guxojnë t'i dalin Serbisë përpara e as t'ia qesin asnjë kusht asaj në negociata, e nga qytetarët kërkojnë të bëhen mish për top.

Në veri mungon forca e shtetit, hiqen kioskat e policisë tonë, tërhiqet policia nga Kroi i Vitakut dhe në të njëjtën kohë ky kryeministër i akuzon qytetarët e pambrojtur dhe të pa përkrahur për dobësi. Kjo është e pandershme dhe pafytyrësi e papranueshme.

Kryeministri Thaçi, është kryeministër qe pesë vjet. Përpos që nuk ka vënë kushte për këto negociata për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, le të tregojë së paku sa cent ai i ka dhënë për shqiptarët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë.

Sikur qeveria jonë përgjatë këtyre viteve të ndante një shumë për ta, dhe këtë ta bënte edhe Republika e Shqipërisë, ndryshe do të ishte gjendja sot atje.

Por jo, në vend se të jep, Qeveria jonë merr nga shqiptarët për çdo hyrje që cilido shqiptar nga Presheva, Bujanoci apo Medvegja, hyn në Kosovë.

Çka u ka ofruar në fakt kryeministri ynë qytetarëve, atje? Ai u ka ofruar atyre vetëm inkurajimin e Daçiqit. Dhe tani Daçiqi godet në të dy anët. Për Kosovën harton platformë dhe në të njëjtën kohë i godet shqiptarët në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë. Nuk ka si të veprojë ndryshe. Atë e ka befasuar dobësia e kryeministrit tonë në takim më të. Jam i bindur që ka pritur rezistencë të fortë nga Prishtina, pasi kështu i mban mend ai shqiptarët përgjatë dekadave.

Pra, në fakt edhe hartimin e platformës së Serbisë e edhe heqjen e lapidarit e ka bërë dobësia e Thaçit në negociatat ku shqiptarët e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës dhe reciprociteti nuk janë as kusht e as temë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kohëve të fundit kemi përjetuar një fenomen shumë të rrezikshëm për të ardhmen e vendit. Ky fenomen që është sa trishtues aq edhe i rrezikshëm, po e fut Kosovën në rrugë pa kthim dhe pasojat e saj nuk janë të riparueshme.

Ky fenomen, përveç dimensionit ekonomik, ka edhe dimensionin e vet politik dhe këto veprime nuk mund të bëhen pa qenë e koordinuar nga një qendër mirë e organizuar.

Jam duke folur sot për veprimet e koordinuara të përndjekjes së investitorëve të huaj që kanë shënjestër për ndjekjen e investimeve që vijnë nga vendet që kanë qenë liderë në rrugëtimin e Kosovës, nga okupimi drejt pavarësisë së saj.

Ky është imazhi i projektuar i Kosovës nga gazeta më e madhe amerikane “New York Times”, që botoi artikullin e Agjencisë më të madhe në botë Rojters me titull: “Kosova imazh i Perëndimit të egër për investitorët”. Artikulli bën fjalë për atë që Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka tërhequr në mënyrë të paligjshme katër nga pesë licencat sa i kishte dhënë kompanisë britanike Fox Morbell për industrinë e gurit në Kosovë. Artikulli nuk lë mëdyshje tek investitorët se në Kosovë biznesi dhe politika janë një, është në duar të grupeve të organizuar, në formë klanesh mafioze, ku vendimet përcillen me eko të fjalëve të kryetarit të Komisionit dhënë gazetës “Icon Fan” dhe i ka munguar vetëm edhe deklarata se pa hise kjo punë nuk bëhet.

Pra, aty po merren vendime arbitrarisht nga anëtarët e një grupi politik, nga kryetari i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i cili deri para 2 muajsh ishte zyrtar i lartë i këtij grupi politik në Mitrovicë, tash kryetar i akomoduar në një institucion të pavarur. Ndoshta, kryetari paska qenë i akomoduar në Komisionin e Pavarur, që ky Komision të varësohet dhe mendoj se ky qëllim është arritur.

Dhe tani shtrohet pyetja: përse punojnë këta njerëz, për të krijuar një imazh negativ në botë, sepse e dimë edhe kur janë harxhuar për projektin e parë për përmirësimin e imazhit, ishin në valët e njëjta? Të gjithëve na kujtohet si doli reklama NewBorn.

Shpjegim tjetër logjik nuk mund të ketë, përpos se qëllim të përbashkët e kanë që të dobësojnë shtetin aq sa disave që janë pakicë u mjafton, kurse të tjerët që janë qytetarët e Kosovës, të dobësohen aq sa nuk mund të mobilizohen për ndryshim. Kjo është një lojë delikate dhe është mirë e orkestruar.

Ky artikull e trajton edhe me raste të tjera Kosovën, tenderi me pasaportat biometrike apo me prapavijë politike.

Dhe që të mos bëhem monotone, ministri s’qenka këtu, sepse si duket ai është i vetmi që e din çfarë po ndodhë me aferën e pasaportave, ose të paktën po e lë këtë përshtypje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kulturën tonë ne flasim shumë për vlera, flasim për traditë dhe kode, mirëpo veprimet të cilat po i bëjmë dhe po bëhen nga klasa politike janë krejtësisht e kundërta, janë keqpërdorimi që është veprim i ulët dhe është veprim i frikacakëve që po pretendojnë të hidhen si trima.

Po i kthehem edhe një herë artikullit të botuar në “New York Times”, ku me të drejtë drejtuesit e kompanisë “Fox Marbell” deklarojnë se kjo çka ka ndodhur për ta është katastrofale, por për Kosovën është vetëvrasëse. Dhe si të ishte profeci, na paraqitet ndjellakeqes Ministria e Punëve të Brendshme me paralajmërim për gjakderdhje.

Ju lutem që kjo të përmbillet, sepse është e tepërt. Nuk mund të arsyetohet ryshfeti me patriotizëm dhe në kosto të xhepit të qytetarit, edhe kështu tepër të varfër të Kosovës.

Në këto momente kur Kosova është zhytur thellë në korrupsion, i drejtohem Kuvendit, sepse kjo agjenci në fakt i përgjigjet Kuvendit.

I drejtohem Qeverisë duke pasur argumente që është agjenci e korruptuar e i politizuar nga Grupi më i madh politik në vend, por edhe EULEX-it, që të ndalojnë këtë përndjekje të investitorëve të huaj.

Të hetohet cilat kanë qenë arsyet e veprimit të tillë dhe drejtësia ta luajë rolin e vet që ka.

Kryetari i Komisionit duhet të na japë llogari, a i shkaktoi dëme Kosovës me vendimet e tij? Dhe Kosova sot po trajtohet si perëndim i egër nga gazetatat me renome. Ndoshta ai nuk i lexon këto gazeta, por ta dijë se këto janë gazeta që janë në tavolinën e politikëbërësve dhe investitorëve botërorë.

Prandaj, mendoj se ka ardhur fundi kur të gjitha shtetet e tjera në rajon, sidomos në Ballkan, po luftojnë për të sjellë investime, Kosova dhe Qeveria e Kosovës me veprimet e veta po i refuzon në vazhdimësi investitorët.

Mendoj se kjo është mjaft dhe se ky Kuvend duhet të kërkojë llogari dhe të marrë vendime që sa më parë të fillojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re përshëndet të gjithë qytetarët e Kosovës me rastin e miratimit të Rezolutës së Këshillit të Evropës, duke marrë parasysh se Qeveria dhe qytetarët së bashku janë ata që mund të arrijnë edhe aty ku s’mendojnë ndoshta rasti i ish-kolegut deputet dhe mendon që në rast se partneri i koalicionit do të qeverisë atëherë e ka një metodë tjetër dhe jo metodë të largimit dhe t’i lë çelësat përjashta dhe për këtë arsye

të apeloj që të shkosh te kryetari i partisë tënde dhe të kuptosh a do të rri në koalicioni apo jo. Se shumë e rrugës është që ti së pari ke nevojë një herë për vetveten të shikosh a je për koalicion apo s'je për koalicion.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dola sot të ngre një shqetësim të vazhdueshëm që e kanë diku 912 punëtorë të Fabrikës së Çelikut dhe të Tubave në Ferizaj, për mosrespektim të vendimeve gjyqësore të institucioneve tona.

Kjo nuk është përzierje që do ta them sot në pavarësinë e gjyqësorit, por pikërisht është në përkrahje të pavarësisë së gjyqësorit dhe ky vend yni me moszbatimin e aktgjykimeve dëshmon se nuk është për sundim të rendit dhe të ligjit.

Punëtorët e fabrikës në fjalë, që nga viti 2000 e këtej, të gjitha instancat gjyqësore, që nga Gjykata komunale, e Qarkut, e pastaj ajo Supreme - Dhoma Speciale dhe deri te aktgjykimi që është ky i Gjykatës Kushtetuese e kanë fituar të drejtën e kompensimit për kohën sa kanë qenë të larguar nga puna.

Nuk kemi të drejtë morale, as njerëzore e as humane që këtyre punëtorëve të mos ua kompensojmë atë që ua njeh ligji, gjegjësisht gjykata. Me të cilën të drejtë nuk ekzekutohet ky vendim dhe aktgjykimi obligon, në mes tjerash, edhe kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Thaçi, që këtë obligim ta kryejë dhe agjencinë, tash ish-AKM-në - Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Prandaj, ky është mosrespektim dhe kjo sanksionohet. Dikush duhet të japë llogari se pse ata punëtorë nuk e realizojnë atë që e kërkojnë.

Andaj, zoti kryetar, unë kërkoj në këtë pikë dhe po e shfrytëzoj rastin që të them se dikush nga Qeveria të na japë përgjigje, e nëse do të ishte kryeministri është më së miri : pse nuk ekzekutohet një aktgjykim, jo vetëm i një gjykate por i të gjitha gjykatave, të gjitha instancave që është obligim ligjor. Nuk është me rëndësi a janë 25 milionë euro, por është shumë me rëndësi për ato familje sepse u takojnë, ua njeh ligji, ua njeh gjykata dhe pse kjo nuk po ndodh?

Andaj, unë kërkoj sot që edhe kjo çështje të futet në rend të ditës me të vetmen arsye, që të na jepet sqarim se pse kjo nuk po ndodh dhe ky Kuvend e ka obligim të nxjerrë edhe rekomandim që gjykata, gjegjësisht ata që janë kompetentë të respektojnë vendimin e gjykatës.

Prandaj, zoti kryetar, në pjesën kur vij unë, tash po e them, si Grup Parlamentar kërkojmë që kjo të futet në rend të ditës dhe të na jepet sqarim: pse nuk po ekzekutohet vendimi i të gjitha instancave gjyqësore dhe e fundit edhe e Gjykatës Kushtetuese, të cilën e respektojnë disa kur iu duhet, ndërsa nuk i respektojnë vendimet e tyre kur tash nuk e di për çfarë arsye, nuk iu konvenon. Prandaj, ata punëtorë, familje, ata fëmijë meritojnë që t'u kompensohet e gjithë ajo që për shumë vite nuk u është njohur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Fjalën e ka kryetrari i Grupit të SLS-së, deputeti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani članovi Vlade,

Drage kolege,

Samostalna liberalna stranka sprovodi politiku mira, tolerancije, međuetničkog poštovanja i uvažavanja. Samostalna liberalna stranka se u duhu takve politike oduvek zalaže za očuvanje jezika, tradicije, kulture i vere srpskog naroda na ovim prostorima. I zato ne možemo a da ne reagujemo na dešavanja koja ugrožavaju Srpski narod, veru i kulturu.

Poslednjih dana se nižu događaji u kojima se oskrnavljeno na desetine pravoslavnih grobova i spomenika u Kosovu Polju, Goraždevcu, Prizrenu, Peći, Klokotu, Vitini, Prištini, Priluzju, Plemetini i Babljaku gde je oštećena i crkva svete trojice i obijene 3 srpske kuće, a u selu Belo Polje kod Peći je zapaljena jedna srpska kuća. Takođe je juče pucano na jednu ženu u Osojanu, bačen je molotovljev koktelj na srpsku kuću u selu Bresju i u Uroševcu je crkva svetog cara Uroša ispisana grafitima.

Građani Kosova,

Prijatelji međunarodne zajednice,

Predstavnici Vlade i drage kolege,

Ovakvi događaji usporavaju proces uspostavljanja demokratije u našem društvu, šire nacionalnu netrpeljivost, ugrožavaju slobodu Srpske zajednice vraćaju nas unazad i velika su, velika prepreka na putu ka pomirenju Srpskog i Albanskog naroda na ovim prostorima.

Zahvaljujemo se Vladi koja je odvojila sredstva za sanaciju pravoslavnog groblja u Kosovu Polju, podržavamo brzu reakciju Kosovske policije i privođenje osumnjičenih za vandalizam u Kosovom Polju i zahtevamo od Ministarstva unutrašnjih poslova da učine sve kako bi slučajevi koji su do sada desili budu rešeni i počinioци budu najoštrije kažnjeni.

I na kraju, ovim putem želimo da apelujemo na predstavnike svih naroda na Kosovu da utiču na svoje sunarodnike da se ovakva nedela više nikada ne dogode jer one nas sputavaju od zajedničke budućnosti u koje ima mesta za sve da zajedno i normalno živimo bez obzira na etničku, nacionalnu i versku pripadnost. Hvala!

KRYETARI: Vazhdojmë. Në emër të Grupit të Partisë Demokratike fjalën e ka kërkuar deputeti Zenun Pajaziti. Këta që flasin në emër të Grupit, është mirë të lajmërohen me letër së paku, që ta dimë në fillim të seancës.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra dhe kolegë deputetë,

U shtruan këtu disa çështje që janë të rëndësishme, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të shpreh shqetësimin për ngjarjet e fundit që

ndodhën në Luginë dhe me reagimet që pasuan në një proces jashtëzakonisht të rëndësishëm të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, një proces i mbështetur edhe nga institucionet ndërkombëtare, Shtetet e Bashkuara dhe BE, një proces i cili ka rezultuar me një progres nga këto bisedime është Beogradi ai që po e minon këtë proces duke bërë veprime të cilat kanë shkaktuar indinjatë të thellë jo vetëm te banorët e Luginës me heqjen e monumentit të dëshmorit, por edhe te qytetarët e regjionit të Anamoravës, të gjithë Kosovës dhe gjithkund në rajon.

Më lejoni të shpreh shqetësimin për këtë reagim të dhunshëm të institucioneve të Beogradit dhe të kërkojmë nga përfaqësuesit politikë të Luginës që të jenë sa më të bashkuar në përgjigjen ndaj këtyre veprimeve dhe të marrin masa të koordinuara në kthimin e lapidarit dhe po ashtu në koordinimin e aktiviteteve që kanë për qëllim kthimin e të drejtave të qytetarëve shqiptarë që jetojnë atje.

Njëkohësisht, ne jemi të shqetësuar edhe me veprimet arrogante në Kosovë që kanë rezultuar me shkatërrimin e disa varrezave. Ne kërkojmë nga të gjitha institucionet, nga të gjitha institucionet vendore dhe qendrore, nga institucionet e sigurisë që të marrin masa të mos lejojnë aktivitete të tilla vandaliste, të cilat e dëmtojnë imazhin e vendit tonë në një proces, i cili po rezulton të jetë efektiv dhe një proces në të cilin vetë serbët janë aktivë dhe po i realizojnë të drejtat e tyre në Kosovë në institucionet lokale.

Pra, kërkojmë nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe institucionet përkatëse të mos lejojnë veprime të tilla.

Më lejoni që në emër të Grupit po ashtu të ritheksoj atë që u tha nga përfaqësuesi ynë që e kemi përshëndetur dhe e përshëndesim Rezolutën në Këshillin e Evropës. Partia Demokratike e Kosovës në mënyrë të koordinuar përmes Qeverisë dhe Kuvendit ka marrë pjesë në këtë institucion i cili herë pas herë nuk ka qenë edhe i favorshëm për imazhin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës përmes delegacionit unik në këtë institucion përveç Partisë Demokratike dhe partive opozitare, edhe pakicave, ka marrë pjesë dhe kështu do të vazhdojmë atje. Po ashtu, Qeveria e Kosovës e ka vendosur edhe personin në Strasburg që besojmë se është një hap edhe më i mirë, një hap më tepër në procesin e marrëdhënieve tona me Këshillin e Evropës deri në anëtarësimin tonë atje.

Pra, synimi ynë është që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Me këtë është harxhuar koha prej 30 minutash. Ministri i Punëve të Jashtme, deputeti Enver Hoxhaj po e kërkon fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar, ju falënderoj që ma dhatë fjalën.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Dua në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës ta uroj edhe Kuvendin e Kosovës, edhe institucionet e Kosovës për miratimin e Rezolutës në Këshillin e Evropës. Mendoj që është një ngjarje e madhe dhe e rëndësishme për Republikën e Kosovës. Dua që t'i falënderoj të gjithë deputetët e të gjitha partive politike për bashkëpunimin që e kanë pasur me këtë institucion dhe mendoj që falë këtij bashkëpunimi dhe koordinimi Rezoluta, e cila u miratua para disa ditësh është padyshim një ngjarje e rëndësishme në relacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Evropës.

Dua të ju informoj se gjatë vitit të kaluar unë kam qenë dy herë në Këshillin e Evropës dhe kam takuar shumicën e deputetëve të pranishëm në Këshill të Evropës. Po ashtu gjatë vitit të kaluar kemi pasur takime me 43 ambasadorë të vendeve, të cilët janë të pranishme në Këshillin e Evropës dhe kemi pasur një koordinim shumë të ngushtë me kryesues të Këshillit të Evropës, me Britaninë e Madhe, me Andorrën dhe me Shqipërinë.

Po ashtu, vitin e kaluar ka ndodhur edhe një takim i rëndësishëm që ka qenë takim i parë në mes kryeministrit Thaçi dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, zotit Jagland. Është një takim i cili ka rezultuar pikërisht me atë formulim i cili është edhe në Rezolutën e Këshillit të Evropës që të ketë kontakte direkt në mes institucioneve të Kosovës dhe Këshillit të Evropës.

Vitin e kaluar, Bjorn von Sidow e ka vizituar Kosovën dhe ne si Ministri e Punëve të Jashtme, unë si ministër kam pasur takime të rregullta dhe ne gjatë këtij viti synojmë që të aplikojmë në Bankën e Këshillit të Evropës për të cilin aplikim i kemi edhe votat.

Arsyeja pse unë dola në këtë foltore është që ta kërkoj mbështetjen tuaj dhe ta bëj një precizim ta jap një dallim të qartë. Republika e Kosovës, është fakt se i ka votat që të aplikojë për anëtarësimin e saj në Këshill të Evropës, mirëpo nuk i kemi votat edhe të gjithë deputetëve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. I ftoj deputetët e Kuvendit që punojnë me deputetët e Asamblesë së Këshillit të Evropës, për derisa ne si Ministri e Punëve të Jashtme e kemi një bashkëpunim të ngushtë me të gjithë ministrat e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës dhe do të vijë koha kur ne do të vendosim që të aplikojmë në Këshillin e Evropës.

Do të thotë janë dy arsye kryesore pse vitin e kaluar nuk kemi aplikuar në Këshill të Evropës, dhe ka qenë aplikimi ynë në Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, që ka qenë një fitore e madhe dhe arsyeja e dytë është, dhe deputetët e dinë, pra të gjithë deputetët që kanë qenë të pranishëm në Këshill të Evropës, është që ka disa deputetë të vendeve të cilat e kanë njohur Republikën e Kosovës, por jo patjetër këta deputetë mund të votojnë pro anëtarësimit të Kosovës në Këshill të Evropës.

Unë do të jem në dispozicionin tuaj që të koordinohemi gjatë vitit 2013 dhe ne na mbetet se si ta ushtrojmë ndikimin tonë tek deputetët, se do të thotë votimi është në dy nivele, në nivel të ministrave të punëve të jashtme dhe në nivel të deputetëve, që ta arrijmë anëtarësimin tonë në Këshillin e Evropës.

Edhe një herë dua të ju uroj për këtë ngjarje shumë të rëndësishme, është një kaptinë e re dhe për ne na mbetet mbi të gjitha prioritet i dorës së parë se si këtë kaptinë të re ta shndërrojmë në një realitet konkret përmes anëtarësimit të plotë të Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur në Këshillin e Evropës.

KRYETARI: Faleminderit ministër! Do të thotë e kryem pikën e parë të rendit të ditës dhe vazhdojmë me pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë i kemi katër pyetje parlamentare. Po fillojmë me pyetjen e parë. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

Ministri s'është këtu. A doni ta bëni pyetjen? Jo! Faleminderit!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

Ministri është këtu, mund ta bëni pyetjen.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit kryetar!

Ministër, në takimin e fundit që ke qenë në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me shkeljet ligjore që po bëhen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ke thënë se do ta krijosh një komision për të verifikuar këto shkelje.

Shkelje të identifikuara dhe të prezantuara nga një grup ekspertësh, janë të shumta, sa që është dashur me u marrë masat e menjëhershme.

A e keni krijuar atë komision, ministër dhe nëse po, cilat janë të gjeturat?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Pjesëtarë të Kabinetit qeveritar,

Grupi prej shtatë specialistëve, mësimdhënës të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka paraqitur kërkesë me shkrim te ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, për inicimin e procedurës disiplinore për stafin menaxhues të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, me shkresën numër 05/5403 të datës 20 shtator të vitit 2012.

E njëjta çështje është ngritur edhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ku kam marrë pjesë.

Pas shqyrtimi të çështjes nga ana e Komisionit, të ngritur nga ana ime, është konkluduar se parashpresa nuk është e argumentuar dhe se në të vërtetë shumica e pretendimeve të

parashtruesve janë rezultat i interpretimeve të njëanshme të dispozitave ligjore në fuqi, respektivisht kolizionit të ingerencave menaxheriale dhe procedurale administrative në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për Shërbimin Civil, Ligjin e Punës dhe Ligjin e Shëndetësisë.

Rrjedhimisht ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil me procedurë të rregullt administrative e ka vlerësuar pozitivisht punën e menaxhmentit të QKUK në fund të vitit të kaluar.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: A ka pyetje shtesë? Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Nëse është ashtu zoti ministër, mua po më vjen mirë, por nuk po besoj se është ashtu, sepse edhe ne si deputetë sot që jemi këtu në këtë sallë, jemi dëshmitarë të shkeljeve të shumta që po bëhen në Qendrën Klinike Universitare.

Atëherë, ndoshta po u dashka ndonjë medalje ta marrë drejtori i Qendrës Klinike Universitare, edhe pse ka bërë shumë shkelje ligjore, të cilat edhe i kemi folur në këtë Kuvend, por edhe i kemi elaboruar nëpërmejt pyetjeve parlamentare këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull, po vazhdojmë me pyetjen e tretë të deputetit Halit Krasniqi, për zotin Kuçi.

A dëshironi ta bëni pyetjen, meqenëse s'është ministri këtu? Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Meqenëse është shtyrë kjo pyetje në dy seanca, do ta shfrytëzoj rastin që t'ia parashtoj pyetjen dhe ministrit, ose bashkëpunëtorëve të tij, ose ai vetë, ose në forma të ndryshme nëpërmjet stafit të administratës së Kuvendit, t'i përcillet, kështu që unë edhe do ta lexoj pyetjen.

Sikur i gjithë opinioni, sikur edhe unë, edhe ai ministri i nderuar, është i njoftuar për burgosje të qytetarëve me motive nga lufta e UÇK-së. Disa nga të arrestuarit dhe familjet e tyre, të shqetësuar nga pesha e akuzave, dëshirojnë të angazhojnë në ekipin e mbrojtjes edhe avokatë me shtetësi tjetër. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin për avokatinë e Republikës së Kosovës.

Pyetja ime është kjo. Meqenëse ky ligj e pamundëson dëshirën e të paraburgosurve dhe familjeve të tyre, sepse respektimi i këtij ligji kërkon kohë për t'i plotësuar të gjitha kushtet e parapara me këtë ligj, meqenëse akuzat janë shumë specifike dhe për kohë të veçantë dhe të papërsëritshme, pyetja ime për ministrin është: A mund të krijohen mundësi të ligjshme në përshtetimin e procedurave për angazhimin e mbrojtësve ngado që dëshirojnë dhe këdo që dëshirojnë të gjithë të akuzuarit me motive nga lufta e UÇK-së dhe shpenzimet për mbrojtjen e tyre t'i mbulojë Qeveria e Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja tjetër, po ashtu e zotit Krasniqi për ministrin Çeku.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Ju jeni të njoftuar për gjendjen e vështirë dhe me trajtimin e padrejtë që i është bërë stafit civil të ish-TMK-së me rastin e transformimit në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Nga 97 të punësuarit në stafin civil të TMK-së, kanë mbetur edhe 72 prej tyre, aktualisht sa kam unë të dhëna, të papunë dhe të pa sistemuar me status diskriminues në shoqërinë tonë, për të cilën kanë investuar angazhimin e tyre në luftën e UÇK-së, pjesa dërmuese kanë qenë të punësuar në një kohë të gjatë me të drejta barabarta me pjesën në uniformë dhe me detyrat e tyre sipas kontratave që i kanë pasur në TMK.

Pyetja ime për juve është- meqenëse janë qytetarë me kontribute në çlirimin e Kosovës në luftën e UÇK-së, rrjedhimisht janë kontribuues krijimi të këtij realiteti të sotëm që e kemi krijuar këtë Parlament, meqenëse kanë kontribute në ngritjen dhe konsolidimin e TMK-së si institucion i respektuar që ka qenë, meqenëse pjesa më e madhe e tyre kanë status social të familjeve të tyre, çka mund të bëni ju si ministër i FSK-së dhe ne të tjerët si institucione me obligime ndaj qytetarëve tanë dhe me përgjegjësi të caktuara dhe të ndara që i kemi? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Çeku e ka fjalën.

MINISTRI AGIM ÇEKU: Faleminderit!

I nderuar deputet,

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ndoshta këtë pyetje është dashur t'ia bëni ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, sepse në kuadër të kësaj ministrie vepron Zyra për TMK-n e cila ka për detyrë që të kujdeset për ish pjesëtarët e TMK-së, por sidoqoftë, unë do të përgjigjem.

Është e vërtetë se me marrëveshjen për formimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës, në strukturën e saj është precizuar që Trupat e Mbrojtjes së Kosovës do t'i kenë 3.000 pjesëtarë aktivë, 2 000 rezervë dhe deri 100 pjesëtarë shërbyes civilë në TMK dhe kjo edhe ka ndodhur, e kemi pasur, siç thatë edhe ju, numri është i saktë, 97 pjesëtarë shërbyes civilë brenda TMK-së.

Në transformimin e TMK-së, dy ligje që i ka nxjerrë ky Kuvend, Ligji për Shpërbërjen e TMK-së dhe Ligji për pensionimin e pjesëtarëve të TMK-së kjo kategori nuk është përfshirë.

Personalisht kam qenë jashtë institucioneve në atë kohë dhe nuk i di arsyet, por mendoj se është bërë një e padrejtë. Dhe këto janë dy të padrejta. E para është se të gjithë pjesëtarët e TMK-së kanë pasur të drejtë, një program të veçantë i riintegrimit të tyre në

shoqëri, por edhe kanë të drejtë edhe në pensionimin nga TMK-ja. Kjo kategori është përjashtuar nga dy këto çështje, nuk i di arsyt pse, por është bërë një e padrejtë.

Ne, si Ministri i kemi bërë disa përpjekje që t'i sistemojmë këta shërbyes civilë. 19 prej tyre janë shërbyes civilë brenda Ministrisë së FSK-së, kurse 48 janë të punësuar si operatorë ekonomikë që ofrojnë shërbime të ndryshme në FSK, qoftë në mirëmbajtje, qoftë përgatitje dhe ofrim të ushqimit, por kjo është vetëm një pjesë e punësimit.

Mendoj që për ta përmirësuar këtë të padrejtësi, sepse kanë qenë të punësuar me rregullore, duhet ndoshta të iniciohet një plotësim dhe ndryshim i Ligjit për pensionimin e pjesëtarëve të TMK-së.

Mendoj se edhe Zyra për TMK e ka evidencën e tyre dhe është duke u bërë përpjekje që t'i integrojë në shoqërinë tonë apo t'u gjejë punë, por statusin nuk e kanë të rregulluar njëjtë si pjesëtarët tjerë aktivë, që kanë qenë të TMK-së. Kështu që e vetmja zgjidhje është që ne ta vazhdojmë kujdesin për ta sa mundemi, por edhe të plotësohet e ndryshohet Ligji për pensionimin e TMK-së.

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zoti Krasniqi? Zotit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar ministër!

Edhe unë kam qenë i bindur se vetëm ne, bashkërisht me ju, nuk mund të bëjmë pa Ministrinë e Punës, por duke i njohur mundësitë për të akomoduar në ndonjë vend pune në stafin civil të SFK-së, ua kam drejtuar këtë pyetje.

Ndërsa, të interesuarit dhe të preokupuarit me këtë problem i kam sugjeruar që të bëjnë nisma dhe ato nisma bashkërisht me ta i kam marrë në komisionet respektive të Parlamentit të Kosovës, që të fillojmë ndryshim-plotësimi i Ligjit për materien të cilën e trajton kjo problematikë. Faleminderit edhe një herë!

KRYESUESI: Të faleminderit! Nuk ka më pyetje të tjera. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 20 dhjetor 2012

Në sallë janë 80 deputetë. Pyes, a ka ndokush vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Atëherë, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 20 dhjetor 2012.

Pika e katërt e rendit të ditës:

Ismet Beqiri: Desha të flas për rend dite.

KRYESUESI: Për rend dite, e ke pasur kohën. Po, atëherë urdhëro, Ismet.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Meqenëse nuk ishit këtu, unë e përmenda edhe në pjesën e deklarimeve, po e përsëris para fillimit, gjegjësisht gjatë miratimit të rendit të ditës, unë e kam një kërkesë, gjegjësisht një emocion në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së që të futet në rend dite sot çështja e ekzekutimit, gjegjësisht e mosekzekutimit ose moszbatimit të aktgjykimeve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtës së punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj.

Unë, i kam edhe aktgjykimet edhe në emër të Grupit, ky është mocion dhe Kuvendi për këtë çështje duhet të deklarohet. Dhe sigurisht, edhe tash po e them, nuk është asgjë sekrete e vetmja gjë që ne e kërkojmë edhe në fund mocioni do të jetë zbatimi i vendimeve të gjykatës të gjitha instancave. Pra, edhe kërkoj që të hidhet në votim mocioni ynë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri! Mendoj që nuk është urgjencë kjo, e ju mund ta bëni kërkesën me shkrim dhe mund ta dorëzoni dokumentacionin që ta kenë edhe deputetët, të dinë çfarë të debatojnë për këtë çështje dhe për seancën e ardhshme besoj se mund të bëhet.

(Ndërhyrje)

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transplantimin e organeve

KRYESUESI: Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar...

(Ndërhyrje)

Nuk jam kundër që të shqyrtohet, por mendoj se nuk është çështje e cila ka urgjencë.

(Ndërhyrje)

Po nuk është urgjencë sepse ti po kërkon debat për një çështje, Ismet. Ke të drejtë të kërkoesh, jo si kryetar, por në qoftë se do urgjencë, i ke 40 nënshkrime, të lutem.

Nuk është mocion ky!

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendi i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim. E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin.

(Ndërhyrje)

Ju e keni për obligim që ta hidhni në votim!

Nuk e kam obligim dhe nuk po e shkel dhe e di që nuk po shkel. Nuk është çdo çështje që e ngrit grupi parlamentar, e që është mocion, me të cilin duhet me u marrë krejt Parlamenti.

Shiko, unë së pari, si deputet do të lutja, sepse unë s'jam i informuar në detaje, do të lutesha që ta kam materialin dhe në qoftë se domi të zhvillojmë debat për një çështje, duhet të kemi informatë. Kjo vlen edhe për ministrat. Dhe të lutem, prite radhën, dorëzoje dokumentacionin me rregull.

Zoti ministër, e keni fjalën. Për këtë e ke Rregulloren. Vazhdo ministër!

(Ndërhyrje)

Lexoje nenin 42 të Rregullores, e pastaj mund ta ngresh këtë çështje. Zoti ministër vazhdon.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Në kuadër të pakos legjislative reformuese të Ministrisë së Shëndetësisë dhe sfidave të Raportit të Progresit të vitit 2011, Ministria e Shëndetësisë e ka finalizuar hartimin e Projektligjit për transplantimin e organeve, i cili sot është para jush për miratim.

Ky projektligj e ka një rëndësi të veçantë për sistemin shëndetësor të vendit, për qytetarët e Kosovës, duke i pasur parasysh nevojat e mëdha për shërbime specifike shëndetësore në lëmin e transplantimit të organeve.

Projektligji për transplantimin e organeve adreson nevojën për rregullimin e kësaj fushe në sistemin shëndetësor të vendit. Rregullimi i kësaj çështjeje është i domosdoshëm për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientëve, ngritjen e cilësisë së jetës së tyre, zvogëlimin e shkallës së invaliditetit dhe përmirësimin e aftësisë individuale për punë, në funksion të dobisë së përgjithshme shëndetësore, shoqërore dhe uljen e kostos së shërbimeve.

Kjo fushë ndërlidhet edhe me strategjinë sektoriale 2010/2014 ku objektiva e parë ka të bëjë me uljen e sëmundjeshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës, si dhe planin e veprimit për zbatim të strategjisë sektoriale ku fusha e parë prioritare ka të bëjë me përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve shëndetësore.

Po ashtu, dialogu për stabilizim dhe asociim ka rekomanduar adresimin e këtij problemi përmes Direktivës 2010/45 për standardet e kualitetit të sigurtisë në transplantimin e organeve njerëzore. Raporti i Progresit i vitit 2011 për Kosovën ka paraqitur si sfidë për

Sektorin e Shëndetësisë mosadaptimin e kornizës ligjore në fushën e transplantimit të organeve në ligjin bazik - Ligji për shëndetësi, numër 04/2004, si dhe në Ligjin e ri, të miratuar më 13 dhjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës, numër 04/L-125, parashihet që transplantimi i organeve të rregullohet me këtë ligj.

Aktualisht nevojat për transplantime janë adresuar nëpërmjet Udhëzimit Administrativ nr. 03/2010 për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike. Transplantimi bëhet në shtetet me të cilat vendi ynë ka marrëveshje bashkëpunimi. Transplantimi bëhet në shtetet e tjera, pasi që as sektori privat në Kosovë nuk ka mundësi ligjore që të zhvillojë kapacitete për t'i realizuar këto shërbime.

Kjo shoqërohet me shpenzimet e mëdha në Buxhetin e Kosovës, ku ndërmjet të tjerave vetëm për sigurimin e produkteve medicinale që përdoren në trajtimin e mbi 650 pacientëve me dializë, shpenzohen rreth 4 milionë euro në vit, që paraqet 25% të buxhetit të përgjithshëm të banave në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Objektivat e miratimit të këtij projektligji, përveç krijimit të një sistemi funksional, që nënkupton përgatitjen e kornizës ligjore, ngritjen e resurseve të specializuara njerëzore për ofrimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve shëndetësore, infrastrukturës fizike të përshtatshme dhe institucioneve adekuate për ruajtjen e organeve, në përputhje me standardet ndërkombëtare, adreson edhe çështjet, siç janë përmirësimi i shëndetit të pacientëve me gjendje shëndetësore, e cila kërkon transplantimin e organeve, krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në fushën e transplantimit të tyre nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, rregullimit të licencimit, organizimit të veprimtarisë dhe të monitorimit të institucioneve shëndetësore dhe shërbimeve shëndetësore në këtë fushë.

Duke pasur parasysh nevojat e mëdha të hartimit dhe të miratimit të këtij projektligji, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar dhe sot propozon para jush një projektligj përmbajtësor për një fushë tejet të ndjeshme të shëndetësisë. Gjatë elaborimit të këtij projektligji janë konsultuar ekspertët ndërkombëtarë dhe vendorë, zyrat profesionale vendore dhe ndërkombëtare dhe të gjitha grupet e tjera të interesit që kanë shprehur motivacion për ta dhënë kontributin e tyre.

Projektligji për transplantimin e organeve në 10 kapituj dhe në 67 nene rregullon në mënyrë të detajuar dhe përcakton qartë shërbimet themelore të përfshira në veprimtarinë e transplantimit të organeve, llojet e transplantimeve, kriteret dhe standardet që transplantimi të kryhet në pajtim të plotë me standardet më të avancuara mjekësore. Rregullon dhe përcakton se kush ka të drejtë të jetë donator dhe mënyrat e procedimit të këtyre veprimtarive, rregullon aktivitetet lidhur me organizimin, menaxhimin dhe monitorimin e proceseve të transplantimit. Me ligj përcaktohet krijimi i regjistrave zyrtarë për transplantim, përcaktohet në mënyrë të qartë procedura për marrjen, ruajtjen, deponimin, konservimin dhe distribuimin e organeve, rregullohet organizimi i këmbimit ndërkombëtar të organeve.

Projektligji i kushton rëndësi të veçantë monitorimit dhe inspektimit, llojeve dhe kualifikimeve të inspektorëve që do të jenë të angazhuar në inspektimin e shërbimeve për transplantimin e organeve. Janë të përcaktuara qartë edhe sanksionet administrative dhe sanksionet penale në rast të shkeljes së dispozitave ligjore të këtij ligji.

Në këtë projektligj, po ashtu është përcaktuar të themelohen edhe organet përkatëse që janë bartëse të zbatimit të tij, siç janë: Qendra shtetërore e transplantimeve e Kosovës, e cila organizon dhe e koordinon procesin e transplantimit të organeve, që themelohet në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë; Qendra e transplantimeve dhe laborator i për tipizim, si qendra që kryejnë transplantime të organeve apo të pjesëve të organeve, bëhet si njësi e veçantë, pra brenda tyre; Laborator i për tipizim brenda këtyre qendrave të transplantimeve; themelohet dhe funksionalizohet banka e organeve, e cila është strukturë shëndetësore, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, që i përgjigjet Qendrës shtetërore të transplantimeve.

Po ashtu, ky projektligj e themelon Komitetin e etikës mjekësore për transplantime, i cili i trajton çështjet e transplantimit të organeve dhe është strukturë që funksionon në përbërjen e Qendrës shtetërore të transplantimeve të Kosovës, së cilës edhe i përgjigjet.

Miratimi i Ligjit për transplantimin e organeve do të mundësojë zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme shëndetësore, financimin më të qëndrueshëm të programeve për dhurimin e organeve dhe transplantimin e tyre, hapësirën më të nevojshme për zhvillimin e transplantimit në sektorin privat, si dhe përpilimin e planeve adekuate, me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit në të gjitha hallkat e shoqërisë përkitazi me këtë çështje.

Prandaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta mbështetni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2012, e shqyrtoi në parim Projektligjin për transplantimin e organeve dhe vlerësoi se ai i plotëson kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores të Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me këtë projektligj rregullohet marrja e organeve, apo pjesëve të organeve nga personi i gjallë apo i vdekur për transplantim te personi tjetër me qëllim mjekimi.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah këtë projektligj dhe do ta votojmë në parim. Mirëpo, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji kemi vërejtur se nenet që flasin lidhur me të dhënat personale, të cilat janë mjaft atë ndjeshme, si të dhënat e marrësit, dhuruesit dhe shfrytëzimi i tyre, duhet të harmonizohen me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Konkretisht, duhet ta kemi një mendim nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në mënyrë që të mbrohet privatësia e kategorive të lartcekura. Pra, Grupi Parlamentar i PDK-së, në parim do ta votojë projektligjin dhe kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin FunkSIONAL, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Breca.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është i rëndësishëm, sepse me të rregullohet marrja e organeve apo pjesëve të organeve nga personi i gjallë apo i vdekur për transplantim te personi tjetër me qëllim mjekimi. Gjithashtu, është i rëndësishëm, sepse Raporti i Progresit i vitit 2011 për Kosovën e ka paraqitur si sfidë për Sektorin e Shëndetësisë mosadaptimin kornizës ligjore në fushën e transplantimit.

Ne si LDK i kemi disa vërejtje sa i përket këtij projektligji, të cilat do t'i paraqes:

Në nenin 1, nuk është mirë i definuar qëllimi i projektit dhe bëhet një përzgjedhje e qëllimit dhe fushës të cilën e rregullon ky projektligj. Gjithashtu, këtu përmenden edhe çështjet që nuk i rregullon ky projektligj, që është e panevojshme, sepse nëse fillohet të numërohen ato se çka nuk rregullon ky projektligj, atëherë duhet të përmenden shumë gjëra.

Në nenin 1, pika 1.24, nuk ka nevojë të përmenden 'auto-graftet', sepse ky projektligj e rregullon transplantimin e organeve, e jo të qelizave dhe të indeve.

Në nenin 3 duhet të shënohet edhe përkufizimi se çka është banka e organeve që përmendet shumë herë në këtë projektligj, si dhe një sqarim për Laboratorin për tipizim.

Në nenin 9 përmendet themelimi i Qendrës shtetërore të transplantimit të Kosovës, por asnjë detaj në lidhje me strukturat përbërëse të kësaj qendre.

Neni 11 nuk e definon qartë nëse vendi ynë ka apo do të ketë marrëveshje të ndërsjellë bashkëpunimi me persona juridikë jashtë vendit, apo me organizatat ndërkombëtare për shkëmbin të organeve me qëllim mjekimi.

Neni 25, pika 1 është i papërfunduar dhe krejtësisht i paqartë.

Në nenin 37, pika 1, përmendet fjala “mund”, që lë hapësirë dhe mundësi të interpretimeve të ndryshme. Edhe neni 41, pika 1, sikur neni 25, pika 1, është i papërfunduar dhe krejtësisht i paqartë dhe më tepër i ngjan një titulli.

Neni 52.1 duhet të përcaktojë saktësisht kohën se kur dhuruesi mund ta bëjë deklaratën me shkrim mbi tërheqjen e pëlqimit të dhënies së organit, sepse, nëse nuk bëhet kështu, atëherë mund të shkaktojë probleme serioze shëndetësore për marrësin e organeve dhe për personelin shëndetësor.

Në nenin 62, në disa paragrafë përmendet revokimi i licencës, por jo edhe kohëzgjatja e revokimit. Këtë po e them për arsye se në bazë të ligjit në fuqi, për licencimin e institucioneve, pas revokimit të licencës, personi fizik apo juridik mund menjëherë ditën tjetër të aplikojë për licencë.

Nenet 63, 64, 65 dhe 66 duhet të fshihen, sepse neni 62 i saktëson se cilat janë veprimet që do t'i kryejë Inspektorati Shëndetësor në lidhje me shkeljen e disa neneve, ndërsa veprimet që përmenden në nenet 63, 64, 65, 66 duhet t'u lihen organeve kompetente të gjyqësisë. Me gjithë këto vërejtje dhe vërejtje tjera që i kemi, ne do ta miratojmë në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë Projektligjin për transplantimin e organeve, me një vërejtje teknike, vërejtje esenciale që qendrat e transplantimit duhet të jenë më të centralizuara. Pra, kjo është vërejtja kryesore që lidhet me këtë projektligj, përndryshe sa u përket pjesëve tjera mendojmë se është në rregull dhe do ta përkrahim dhe besoj që në komision do të arrijmë që këto ndryshime t'i inkorporojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKK-së, zonja Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, sepse me të po rregullohet një fushëveprimtari shumë e rëndësishme. Kjo problematikë e mosekzistimit të kornizës ligjore për këtë veprimtari është paraqitur edhe në Raportin e Progresit të vitit 2011.

Rregullimi i kësaj çështjeje është i domosdoshëm për ruajtjen dhe për përmirësimin e shëndetit të pacientëve, zgjatjen dhe ngritjen e kualitetit të jetës, uljen e kostos të shërbimeve, zvogëlimin e shkallës së invaliditetit dhe përmirësimin e aftësisë individuale për punë, në funksion të dobisë së përgjithshme.

Ligji ka për qëllim të parandalojë dhe sanksionojë keqpërdorimin e organeve njerëzore, sidomos me aktivitetet komerciale. Me këtë projektligj do të rregullohen mënyrat dhe bazat ligjore se cilat janë kriteret dhe standardet për transplantimin e organeve.

Aktualisht në Kosovë për masat dhe problemet lidhur me transplantimin nuk është përshkuar saktësisht për shkak të mungesës së informatave për këtë fushë. Ka mungesë të informatave për koston që nevojitet për mirëmbajtjen e pajisjeve, koston totale të një personi me dializë, që do të përfshijë humbjen e të ardhurave nga mospuna, për përfshirjen e tij në skemën sociale, ndikimin e financimit në familje e të tjera.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta përkrahë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, zoti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

E përshëndesim procedimin e këtij projektligji nga Ministria e Shëndetësisë dhe njëherësh e përgëzojmë për punën që ka bërë për faktin se kemi qenë dhe jemi dëshmitarë se mungesa e bazës ligjore për transplantimin e organeve nënkupton shumë procese gjyqësore në Kosovë dhe shumë polemika dhe probleme në kohën e fundit, prandaj procedimi i këtij ligji do t'i rregullojë shumë çështje, për të cilat Kosova ka qenë e hendikepuar dhe kështu do të fusë atë në mesin e vendeve me një shëndetësi në zhvillim e sipër. Prandaj, Projektligji për transplantimin e organe pa dyshim paraqet një avancim në shëndetësinë kosovare.

Ne si Koalicion për Kosovë të Re në parim do ta përkrahim dhe kontributin dhe punën tonë kryesore do ta japim në Komisionin për Shëndetësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zonja Shinik!

MUFERA SINIK: Faleminderit nënkryetar!

Teşekkür ederim.

Organ nakli Yasa Tasarısını grup olarak incelemiş bulunmaktayız. Yasa Tasarısının iyi bir şekilde hazırlandığını da görmekteyiz. Bu Yasa Tasarısı sağlık açısından ve özellikle organ bekleyen bir çok kişiye yaşam kapısı olacaktır. Organ naklinin bu sıralama ve sıralamasının Sağlık Bakanlığı tarafından düzenlenmesi son derece önemlidir. Organ bağışlamak isteyenlere, organ bağış kartlarının düzenlenmesi ve kanunda da yer alması, yerinde bir karardır. Organ bağışları bekleyen hastalar için hayat dsir kampanyasını düzenleyenler, bu konuda halkımızın daha bilinçli ve duyarlı olmasını sağlayacaktır. Tüm bu katkıları sunarak , Yasa Tasarısının birinci okunuşunu, “6+” Parlamenter Grubu olarak kabul etmekteyiz ve ek katkılarımızı da fonksiyonal komisyonlara sunacağız. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Zonja Rexhepi! Nuk është e pranishme. Zoti ministër, e doni fjalën? Jo. Atëherë, në vazhdim, kërkohet deklarami me votim për miratimin në parim të Projektligjit për transplantimin e organeve. Kuorum kemi. Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë.

Për kanë votuar 59 deputetë, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për transplantimin e organeve.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës

Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Vehapi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit zoti kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2012, e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet propozimi i Qeverisë për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës të datës 12.10.2012.

A r s y e t i m

Qeveria, në bazë të nenit 17 të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës ka propozuar ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës, të miratuar më 12.10.2012 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës, i propozuar nga Qeveria, ka të bëjë vetëm me emërtimin e Universitetit të Prishtinës, "Hasan Prishtina".

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 12 dhjetor 2012, e shqyrtoi propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe me shumicë votash vendosi t'ia rekomandojë Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zonja Izmaqu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

XHEVAHIRE IZMAKU: Ju faleminderit, kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështesë këtë propozim dhe do të votojë për emërtimin e Universitetit të Prishtinës me emrin “Hasan Prishtina”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur për këtë çështje. Si duket, grupet nuk janë të interesuara të deklarohen. E votojmë propozimin e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës, të datës 12.10.2012. Në sallë janë 65 deputetë. Votojmë tash!

Për kanë votuar 41, kundër 1, abstenim 1. Konstatoj që Kuvendi e miratoi propozimin e Qeverisë së Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Universitetit Publik “Hasan Prishtina”, në Prishtinë. Pa kartelë dy, atëherë 43 vota kanë qenë për. Faleminderit!

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i propozim-Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar propozim-Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim.

E ftoj nënkryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Selimi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

BEHAR SELIMI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar strategjinë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta shqyrtojë dhe ta miratojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Është radha e grupeve parlamentare. Sërish është propozuar zoti Selimi, në emër të Grupit Parlamentar.

BEHAR SELIMI: Do të përpiqem të flas shkurt, meqë sapo fola. Si Grup Parlamentar, mendojmë se strategjia është një dokument i krahasueshëm me strategjitë e ngjashme të vendeve, të cilat janë në hall me korrupsionin. Mendojmë se u është dhënë vend dhe hapësirë e mjaftueshme të gjitha institucioneve me detyrat që duhet t'i realizojnë për ta parandaluar dhe luftuar korrupsionin. E vlerësojmë posaçërisht faktin se në këtë dokument, kësaj radhe, është futur plani i integritetit, të cilin do të duhej ta kishin të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe nëpërmjet të cilit do të identifikoheshin

të metat që i kanë sistemet, përkatësisht procedurat, të cilat lejojnë apo japin mundësi për korrupsion.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se institucionet në këtë vend janë krijuar shpejt dhe jemi të ndërgjegjshëm se ka pasur arsye për t'u ngutur për të krijuar institucione dhe procedura, të cilat jo gjithmonë i kanë mbuluar të gjitha hapësirat, të cilat mund ta tolerojnë korrupsionin. Prandaj, mendojmë se përderisa një kohë kemi pasur arsye që të ngutemi, tani është e domosdoshme që t'i hyjmë një reforme serioze të çdo institucioni, duke e hetuar, përkatësisht duke e skanuar integritetin edhe të personaliteteve që punojnë në institucionet e shtetit, pra e pa përjashtuar këtu asnjë institucion, dhe posaçërisht t'i skanojmë procedurat, rregullat, shprehitë, kulturat e organizatave buxhetore, të cilat edhe personalisht mendoj, por edhe si grup parlamentar, lejojnë që në disa raste të korruptohen.

Mendoj se shumica e njerëzve në botë janë të korruptueshëm, nëse sistemet e lejojnë një gjë të tillë. Prej natyrës njeriu është kudo, ka korrupsion gjithandej nëpër çdo shtet, pa i përjashtuar edhe shtetet më të zhvilluara. Nëse lejojmë rrethana dhe sisteme, të cilat e inkurajojnë apo e tolerojnë korrupsionin, parimisht shumica e njerëzve korruptohen. Prandaj, a duhet të fillojmë t'i rishikojmë apo t'i skanojmë, por shprehem me gjuhën e mjekëve, e besoj që nuk ma shohin për të madhe, t'i skanojmë të gjitha institucionet gjatë gjithë vitit për të parë se cilat janë ato të meta, të cilat po na mundësojnë korrupsionin, e pastaj po ashtu të kërkojmë angazhim konkret edhe të atyre që e luftojnë korrupsionin. Pra, unë jam që paraprakisht të punojmë më shumë në parandalimin e korrupsionit, sepse kur ndodh korrupsioni, pastaj është kot. Unë ju them sinqerisht se edhe melaqen po ta nxjerrim në krye të disa departamenteve të shtetit, do t'i plasim edhe skandale, jo me fajin e tij, por për arsye se procedurat e punës, rregullat e punës, sistemi që është krijuar, shprehia e punës, e mundëson këtë dhe, në anën tjetër, edhe sistemi i drejtësisë deri vonë ka qenë i pareformuar, por shpresojmë se me reformimin e tij dhe me legjislacionin e fortë penal-juridik, që është miratuar nga ne do të kemi sukses.

Pra, parakusht kryesor për të pasur sukses në këtë dokument është që dokumenti të zbatohet fjalë për fjalë dhe dëshirojmë të ju përkujtojmë se është fjala për strategjinë, të cilat Agjencia Kundër Korrupsionit ia ka dërguar Kuvendit dhe në atë dokument përfshihen përgjegjësitë e të gjitha institucioneve. Pra, nëse mendohet se është e Qeverisë, ndoshta edhe nuk është dashur fare të shkojë në Qeveri, meqë agjencia i jep llogari Kuvendit, por sidoqoftë aty ka detyra për të gjithë, duke na përfshirë edhe ne deputetët, që në të ardhmen ta shtojmë mbikëqyrjen në zbatimin e kësaj strategjie në çdo institucion.

Nëse jemi të vendosur dhe të përkushtuar dhe nëse së pari edhe ne kemi integritet, besoj do t'ia bëjmë një argat të mirë vendit, duke e mbikëqyrur zbatimin kësaj strategjie. Natyrisht, nuk e konsiderojmë dokument perfekt, por ky dokument i pasqyron kërkesat, nevojat dhe gjendjen e rëndë në vendin tonë në raport me korrupsionin, prandaj kërkohet angazhim i të gjithëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Mendoj se mora pak shtytje edhe prej parafolësit dhe mendoj se në substancë është që, nëse kjo që e tha parafolësi sa i përket strategjisë, se ajo nuk është e institucioneve të Kosovës, nuk është e Qeverisë, por është vetëm e një institucioni, që është Agjencia Kundër Korrupsionit, atëherë është një problem shumë i madh konceptual, sepse ky dokument do të duhej të ishte strategjia e Kosovës në luftën kundër korrupsionit, në të cilën do të duhej të ndërthureshin dhe të përfshiheshin të gjitha institucionet.

Këtu është edhe pika ku fillon diskutimi im në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse ne kemi vërejtje substanciale në strukturën e dokumentit. Struktura e dokumentit nuk parasheh se si do të organizohet dhe si do të funksionojnë institucionet, të cilat do ta kenë për detyrë luftën kundër korrupsionit; cilat janë ndryshimet substanciale që do të duheshin të bëheshin në aspektin legjislativ, në aspektin organizativ, në aspektin funksional për të mundur luftën kundër korrupsionit. A duhet të ndryshohet ndonjë ligj, a duhet të shuhet ndonjë agjenci, a duhet të krijohet ndonjë agjenci e re, sepse ju e dini se në praktikën e përditshme dhe në diskutimet publike, sa i përket luftës kundër korrupsionit, ka shumë debate dhe diskutim. Debatet kryesore dalin te institucionet, të cilat merren me luftën kundër korrupsionit.

Nëse pyetni te Agjencia Kundër Korrupsionit, ata ankohen se Prokuroria nuk po i heton rastet e tyre dhe po i kualifikon rastet që ata i bëjnë si raste të pastudiuara mirë dhe të pandërruara mirë. Nëse pyetni në Prokurori, ajo thotë se Agjencia nuk e ka bërë punën. Nëse pyetni në Polici, ajo thotë se Prokuroria dhe Agjencia nuk po e bëjnë punën e vet, prandaj këtu e kemi një problem substancial. Kjo është dashur të jetë strategjia e institucioneve të Kosovës për luftën kundër korrupsionit të të gjitha institucioneve, e cila, meqë ka ardhur nëpërmjet Zyrës së Kryeministrit, si organ ekzekutiv, e ka edhe qëllimin t'i mbledhë dhe t'i riformulojë të gjitha këto kërkesa dhe nevoja.

Çështja substanciale tjetër që diskutohet, në debatet që i kemi pasur me drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në Komisionin për Legjislacion, shprehimisht i është kërkuar ta japë një vlerësim se cila është puna e Agjencisë Kundër Korrupsionit, a duhet të ekzistojë kjo agjenci, si duhet të formohet dhe çka duhet të ndodhë, e përgjigjja e tij ka qenë se Agjencia Kundër Korrupsionit shpesh është keqkuptuar dhe si e tillë ndoshta nuk do të duhej të ekzistonte fare. Duhej të ishte një institut, i cili merret me deklarime dhe kontrollin pasurisë, por jo me luftën kundër korrupsionit, sepse edhe me hetimin ndoshta të rasteve të konfliktit të interesit, por me luftën kundër korrupsionit janë organet specifike, siç janë Prokuroria, Policia dhe gjykatat, që e ndajnë drejtësinë në fund. Dhe, ky problem nuk është adresuar në këtë strategji.

Problem tjetër substancial është mospërputhja ndërmjet objektivave, programeve, masave politike dhe projekteve të veçanta. Edhe ky është një problem shumë i madh, i cili është vërejtur në këtë strategji. Problem tjetër, i cili është vërejtur dhe i cili është i pakalueshëm në aspektin financiar, janë vërejtjet kryesore substanciale që i ka bërë Grupi Parlamentar i

Lidhjes Demokratike, jo vetëm këtë herë, por edhe herën e parë kur ka ardhur strategjia dhe është kthyer nga Kuvendi si e parealizuar dhe si strategji e cila nuk parasheh zgjidhjet e nevojshme dhe të domosdoshme për ta luftuar korrupsionin në Kosovë. Na ka ardhur i njëjti dokument, i cili nuk i parasheh as mjetet financiare me të cilat do të duhet të luftohet korrupsioni.

Prandaj, nëse e marrim dhe e rikapitulojmë me disa fjalë strategjinë që e kemi këtu, kemi mundësi të qasjes uniforme të luftës kundër korrupsionit; mundësi të identifikimit të institucioneve, të cilat duhet ta luftojnë korrupsionin; a duhet të jetë një subjekt i qartë, i cili do të duhet ta luftojë korrupsionin Agjencia Kundër Korrupsionit, Prokuroria, apo Policia, apo mbetet e njëjtë siç është sot.

Mundësinë e identifikimit të qartë të objektivave dhe për kthimin e këtyre të objektivave në politika, në masa, në programe, në projekte dhe në veprime të veçanta. Mundësinë e burimeve financiare për realizimin e kësaj strategjie dhe në fund problemi, kryesor del se strategjia nuk është një projekt i të gjitha institucioneve të Kosovës, por është një projekt vetëm i një agjencie, që në këtë rast është edhe në kundërshtim me rekomandimet që i ka dhënë Komisioni Evropian, i cili ka rekomanduar që institucionet e Kosovës duhet ta hartojnë dhe aprovojnë strategjinë e angazhimit të përbashkët të të gjitha institucioneve për luftën kundër korrupsionit.

Dhe, në këtë rast, ky është një problem shumë i madh dhe si e tillë çfarë është në këtë gjendje, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike nuk mund ta përkrahë, do të votoj kundër dhe kërkon nga të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës që ta votojnë kundër, t'ia kthejnë Qeverisë, t'i japin kohë që Qeveria ta shohë angazhimin e të gjitha institucioneve relevante për luftën kundër korrupsionit, t'i identifikojë dhe t'i garantojë burimet financiare dhe në fund të garantojë se kjo strategji ka objektiva, programe, masa, politika dhe veprime konkrete të matshme dhe të arritshme, sepse këtu duhet të kemi edhe disa elemente.

Si maten këto objektiva dhe si arrihen këto objektiva dhe, nëse kjo arrihet të realizohet, normalisht që në një moment tjetër Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, nëse përfshihen vërejtjet që janë identifikuar, ne normalisht do ta përkrahim, sepse jemi për luftën kundër korrupsionit por në formën çfarë është sot nuk mund ta përkrahim dhe kërkojmë që Qeveria ta tërheqë si sponsoruese. Sipas letrave që i kam këtu, kryeministri Hashim Thaçi është sponsorizues i strategjisë, ndërsaq problemet janë substanciale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi! Zoti Selimi ka kërkuar replikë.

BEHAR SELIMI: Më tepër sqarim për atë që e thashë. Por, sidoqoftë është fjala për një dokument strategjik, të cilin, me ligj, Agjencia Kundër Korrupsionit e ka obligim ta bëjë, ta kalojë nëpërmjet Qeverisë dhe të vijë në Kuvend. Në këtë dokument ka detyra për të gjitha institucionet e shtetit. Në momentin që e aprovon ky Kuvend, atëherë është dokument për të gjitha institucionet.

E dyta, asnjë dokument strategjik nuk ka objektiva specifike, se nuk ka kuptim. Dokumenti ose është strategjik, ose është plan operativ. Prandaj, institucionet konkrete obligohen me dokument që t'i bëjnë strategjitë dhe planet e tyre. Vetëm desha të sqaroj.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe zoti Gashi dëshiron të sqarojë.

ARBEN GASHI: Ta kemi të qartë një pikturë, e cila po na prezantohet këtu. Unë mendoj dhe pas diskutimeve që i kemi bërë edhe në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kemi arritur në konkluzionin që dokumenti duhet të jetë i hartuar nga të gjitha institucionet relevante që merren me luftën kundër korrupsionit, të jenë të përfshira në proces. Besoj që edhe Behari e di si hartohen objektivat, hartohen me teknikën SMAR, që thotë: specifik, i matshëm, i arritshëm në kohë dhe i realizueshëm. Kjo është mënyra qysh hartohet një objektiv dhe pastaj ky objektiv shndërrohet në politikë, në masë, në veprim, në aksion dhe, në fund, edhe në projekt specifik.

Prandaj, mendoj se kemi lajthitje në objektin e strategjisë. Strategjia mund të aprovohet, Agjencia Kundër Korrupsionit mund ta aprovojë vetë dhe ta zbatojë vetë strategjinë e brendshme të veprimit, por nëse një dokument arrin në Kuvend, i nënshkruar nga Kryeministri i vendit, ky është një dokument i cili vjen nga Qeveria dhe në të cilin do të duhej të ishin të përfshirë të paktën edhe rekomandimet e Komisionit Evropian; që të jenë të përfshira të gjitha institucionet, ose siç quhen “stakeholders”, palët me interes në luftën kundër korrupsionit. Ato ta shohin veten dhe veprimet e veta në këtë strategji. Ato këtu nuk shihen, prandaj ne nuk mund ta përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Në prill të vitit 2012 ne e diskutuam Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2012-2016, për të cilën strategji u thanë shumë vërejtje përmbajtësore, sigurisht nga ana e opozitës, dhe e njëjta nuk kaloi. Pra, ishin 39 vota kundër, 19 për dhe 6 abstenime.

Të paktën ne si subjekt politik kemi pritur një qasje shumë më serioze gjatë përpilimit të sërishëm të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit. E, në vend që pas atij mosvotimi të analizohen vërejtjet e Kuvendit, por edhe të shoqërisë civile, ne po na sillet një strategji e njëjtë, madje pa asnjë pikë e presje të ndryshuar. Dhe, kjo është një tallje me Kuvendin dhe me qytetarët. Pra, po na sillet edhe një herë një strategji, e cila tregon se si nuk luftohet korrupsioni dhe se Agjencia Kundër Korrupsionit ose është e ndikuar nga pushteti dhe përpilon strategji të tilla, ose është e paaftë të përpilojë strategji kundër korrupsionit, e unë mendoj se është ajo e para.

Unë dua të sjell në vëmendjen tuaj faktin që ne e kishim një Strategji dhe Plan të Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2009-2011, strategji e cila nuk e prodhoi asnjë rezultat pozitiv. Pra, Agjencia Kundër Korrupsionit gjatë përpilimit të kësaj strategjie nuk

ka bërë ndonjë hulumtim apo ndonjë studim të raporteve, të cilat e tregojnë natyrën, shkaqet dhe shkallën e nivelit të korrupsionit në Kosovë.

Gjithashtu, nuk është bërë ndonjë analizë e thuktë mbi moszbatueshmërinë e strategjisë kundër korrupsionit 2009-2011 mbi bazën e së cilës, të paktën, do të hartohej një strategji më e mirë.

Problemi tjetër qëndron në faktin që kjo strategji është hartuar pa një qasje gjithëpërfshirëse, pra nga një grup i ngushtë njerëzish, në të cilin kanë qenë të përjashtuar ekspertë të pavarur të kësaj fushe, subjektet opozitare dhe shoqëria civile. Pra, kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Qeverisë, kur dihet tashmë që kjo Qeveri nuk është e interesuar ta luftojë korrupsionin, pasi për shkallën e korrupsionit është shkaktare edhe përgjegjëse vetë ajo.

Gjithashtu, më duhet të them se nëse i analizojmë objektivat e kësaj strategjie, shohim që në shumë raste nuk janë aspak të qarta dhe specifike, madje në shumë raste janë edhe në kundërshtim me njëra-tjetrën. Pra, më tepër përdoren disa fraza moralizuese, për shembull “rritja e efikasitetit në bashkëpunim ndërsektorial dhe ndërinstitutional”, ose “përmirësimi i transparencës”, ose “niveli i rritjes së efikasitetit të zbatimit të ligjit”, ose “ulja e mëtejme e korrupsionit brenda agjencive”. Pra, këto objektiva janë shumë të përgjithshme dhe aspak konkrete dhe joserioze.

Tjetër që e bën këtë dokument joserioz është edhe kostoja buxhetore, pra ashtu siç u përmend edhe nga përfaqësuesi i LDK-së. Në këtë strategji nuk ekziston fare kostoja buxhetore për implementimin dhe realizimin e saj. Prandaj, të gjitha këto e bëjnë këtë një strategji shumë sipërfaqësore dhe për keqardhje.

Agjencia Kundër Korrupsionit është dashur që të bëjë presion ndaj Qeverisë që ta kompletojë pakon ligjore antikorrupsion, pasi edhe po të kishte një strategji të përpiluar mirë, pa kompletimin e kësaj pakoje ligjore do të ishte e kotë.

Gjithashtu, kjo agjenci është dashur që ta kundërshtojë Projektligjin për zgjerimin e kompetencave për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, i cili projektligj e amnistion pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme.

Krejt në fund, me apo pa këtë strategji, korrupsioni në Kosovë ka lëshuar rëniet nga niveli lokal e deri te ai qendror dhe ne nuk kemi parë ndonjë rezultat në luftën kundër korrupsionit, pavarësisht shifrave që përmenden dhe ajo çka qytetarët presin është që kjo agjenci, në bashkëpunim me institucionet tjera, të na sjellin rezultate konkrete nëpërmjet denoncimit të aferave korruptive nga niveli lokal e deri te majat më të larta të shtetit.

Pra, këtë strategji, si të tillë, ne si subjekt nuk do ta votojmë, pasi mbështetja jonë për këtë strategji do të ishte në fakt pajtim me gjendjen e tanishme dhe hiqje dorë nga luftimi i korrupsionit. Dhe, kërkojmë nga gjithë deputetët që të mos e votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Strategjia e kaluar ka qenë prej vitit 2009-2011 dhe tashmë e kemi dokumentin e ri, që quhet strategjia kundër korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2013-2017.

Këtu elementi i parë që bie në sy është fakti se viti 2012 ka humbur diku. Tash, a mban përgjegjësi ndokush se gjatë vitit 2012 ne s'paskemi pasur fare as strategji për ta luftuar korrupsionin, e le më veprime të tjera të koordinuara dhe të miratuara.

Është e vërtetë se Kuvendi i Kosovës e ka kthyer mbrapsht draft-strategjinë kundër korrupsionit vitin e kaluar. Kjo ka ndodhur më 19 prill 2012.

Por, strategjia e re është dërguar në Qeveri tek më 18 tetor 2012, dhe është aprovuar nga Qeveria një muaj më vonë, përkatësisht më 21 nëntor 2012. Janë dashur plot 6 muaj derisa drafti i ri është paraqitur në mbledhjen e Qeverisë.

Pra, Agjencisë Kundër Korrupsionit i janë dashur 5 muaj, kurse Qeverisë i është dashur edhe një muaj shtesë dhe gjatë këtyre 6 muajve vonesë, kjo duhet të theksohet - ka 6 muaj vonesë prej momentit kur Kuvendi e ka kthyer derisa është përfunduar strategjia në kuptimin e miratimit të Qeverisë, Kosova ka marrë kritika nga Komisioni Evropian për mungesë të saj. E për shkak të këtyre 6 muajve vonesë, Kosova nuk ka arritur ta përmbushë njërin prej kërkesave afatshkurtra të Komisionit Evropian për ta marrë datën e fillimit të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Tash, kush është përgjegjës në këtë? Besoj se të gjithë e dimë, e nuk ka nevojë për më shumë komente.

Sidoqoftë, në dokumentin që e kemi përpara vlen të theksohet se një çështje që del këtu si sfida numër një gjatë viteve 2009-2011 është bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional. Kjo është në faqen 17. Pra, Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Qeveria na thonë se sfida kryesore ose sfida numër një për strategjinë e korrupsionit në periudhën e kaluar ka qenë mungesa apo vështirësitë që institucionet të bashkëpunojnë dhe të koordinohen ndërmjet veti.

A është mirë dhe pse udhëheqësit tjerë të institucioneve të Qeverisë nuk janë këtu që të na sqarojnë pse kanë pasur vështirësi të madhe të bashkëpunojnë dhe të koordinohen ndërmjet veti për 3 vjet me radhë.

Më tutje, në faqen 18, te konkluzionet dhe rekomandimet e Kapitullit të parë, në pikën e parë thuhet shprehimisht. “Një numër i konsiderueshëm i veprimeve të përfshira në Planin e Veprimit nuk janë zbatuar nga institucionet përgjegjëse. Në këtë drejtim do të kërkohet një planifikim më i mirë i veprimit, në mënyrë që ato të implementohen në kohën e duhur dhe në mënyrë cilësore”.

Zonja dhe zotërinj nga Agjencia Kundër Korrupsionit, por edhe nga Qeveria, ju është dashur që pas këtij konkludimi ta bashkëngjitni një shtojcë më detaje se cili institucion nuk e ka zbatuar atë që është kërkuar në strategjinë 2009-2011; cili dhe cilat institucione nuk e kanë bërë punën e vet në luftën kundër korrupsionit; pse nuk i kanë bërë ato; cilat

kanë qenë pengesat apo i ka ndaluar dikush? Apo, ta themi më mirë - cilat kanë qenë ndëshkimet që këto institucione të papërgjegjshme kanë ndërmarrë për shkak se nuk i kanë përmbushur veprimet e veta në luftën kundër korrupsionit? Sa zyrtarë kanë dal para Komisionit Disiplinor për këtë punë? Sa zyrtarë janë larguar nga vendi i punës për shkak se nuk e kanë luftuar korrupsionin dhe e kanë pasur detyrë me strategjinë dhe Planin e Veprimit 2009-2011?

Më tutje, në faqen 21 thuhet se duhet të adresohet niveli i ulët i besimit në institucionet publike, sepse dështimi për ta trajtuar këtë sfidë i vë në rrezik të gjitha përpjekjet për të siguruar njohje të plotë ndërkombëtare dhe legjitimitet të brendshëm. Këtu Agjencia Kundër Korrupsionit, me aprovimin e Qeverisë, na i thotë dy elemente.

Së pari, konstaton se besimi në institucione është i ulët.

Së dyti, na thotë se Kosova nuk mund të merr njohje të plotë ndërkombëtare pa e luftuar korrupsionin. Dhe, kjo do ta rriste besimin e institucioneve.

Realisht, nuk kam koment më shumë për këtë konstatim, ose për këto konstatime.

Në faqen 24, te Kapitulli V, objektivat specifike për sektorët prioritarë. Sa i përket sektorit publik, ndër të tjera, thuhet se emërimet politike që po i bën Qeveria në agjencitë e ndryshme rregullatore, bordet e ndërmarrjeve publike e të ngjashme paraqesin rrezik. Aty thuhet se duke zbatuar vetëm kriteret politike në emërimet e një kategorie të tillë të personelit vazhdon të ngrihen dyshimet e nepotizmit dhe klientelizmit. Pra, emëruesi i përbashkët i kësaj pike është: emërime politike, nepotizëm, klientelizëm dhe të gjitha këto nën kompetencën e Qeverisë.

Ndërkaq bindja ime është se në këtë strategji jashtëzakonisht pak i është kushtuar vëmendje nivelit komunal. Ka vetëm dy paragrafë të vegjël rreth nivelit komunal me 3-4 fjali, të cilat na shtyjnë të besojmë dhe vlerësojmë se AKK-ja dhe Qeveria e kanë vënë prioritet luftimin e korrupsionit në nivel tjetër, por jo në nivel të komunave, e për çdo ditë e më shumë po raportohet për një rritje të madhe të korrupsionit në nivelin lokal, që po ashtu duhet të jetë e adresuar nga strategjia dhe Plani i Veprimit.

Tek administrata qendrore, në faqen 26, gishti më së shumti drejtohet tek arsimi, shëndetësia dhe planifikimi hapësinor. Në këto fusha, thuhet në strategji, janë të nevojshme përpjekje më të mëdha për adresimin e duhur të problemit. Tani, asnjëri prej ministrave nuk janë këtu, po pse këto fusha qenkan më të korruptuara sipas strategjisë që e kemi sot në Kuvend, të cilën e ka aprovuar Qeveria? Këta tre ministra është dashur që të na shpjegojnë sot, të na sqarojnë neve dhe qytetarëve, pse fushat e tyre konsiderohen se janë më të përhapurat sa i përket korrupsionit.

Te zbatimi i ligjit, Prokuroria dhe gjyqësia, në faqen 27 - besoj se me të drejtë Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Qeveria kërkojnë adresimin e korrupsionit brenda Gjyqësorit, Prokurorisë dhe Policisë, sikur që edhe kërkojnë forcimin e kontrollit të brendshëm dhe të mekanizmave disiplinorë. Por, për këtë, po ashtu duhet të kërkojen veprime konkrete me

afate të përcaktuara kohore dhe me adresim të përgjegjesisë individuale dhe menaxheriale në lidhje me faktin se pse këta mekanizma nuk janë forcuar deri më tash. Kush janë përgjegjësit për këto?

Për të vazhduar kah fundi i strategjisë, në Kapitullin VII, te monitorimi dhe zbatimi - Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Qeveria si aprovuese e këtij dokumenti propozojnë krijimin e një trupi koordinues të përbërë nga krerët e institucioneve kyçe kundër korrupsionit.

Tani, prapë po them këtë, sepse Qeveria nuk është këtu - ata do të duhej të na sqarojnë nëse ky trup koordinues është ndonjë mekanizëm alternativ ndaj atij Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, që e ka themeluar presidentja e Kosovës, zonja Jahjaga? Cili do të jetë roli i këtij trupi koordinues në raport me Këshillin Kombëtar, që e ka presidentja Jahjaga? Pse do të duhej të themelojmë kaq shumë trupa koordinuese për ta luftuar korrupsionin, derisa me vite nuk kemi pasur? Çka duhet të koordinojmë më shumë, ose të koordinojnë krerët e institucioneve që ta luftojnë korrupsionin më shumë në trupin koordinues sesa në Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit, që e udhëheq Presidentja.

Apo, më tutje, krejt në fund, ku thuhet se duhet të bëhen publikimet e artikujve dhe kolumneve të hapura mbi masat kundër korrupsionit. Shiheni çudinë! Kuvendi i Kosovës sot e miraton strategjinë, ku ndërmjet tjerash u kërkohet njerëzve dhe zyrtarëve shtetërorë të shkruajnë artikuj dhe kolumne. Vërtet s'ka nevojë për koment! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zoti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pa dyshim që strategjia e luftimit të korrupsionit në Kosovë është ndër fushat dhe elementet më të rëndësishme, e cila njëherësh duhet të jetë ndër prioritetet më të para të radhitura ashtu në ranglistë sa i përket integritetit dhe zhvillimit të Kosovës, në përgjithësi.

Si prioritet i Kosovës, që mbetet integriteti në strukturat euroatlantike dhe ato evropiane, korrupsioni është një fushë, e cila duhet të jetë shumë më e rëndësishme, shumë më prioritare dhe vitale për Kosovën, për faktin se korrupsioni ka përfshirë çdo sferë të jetës, është bërë si oksigjeni për qytetarët e Kosovës, për të cilin mund të them, jo vetëm në institucione publike e private, por fatkeqësisht po gjen hapësirë aplikimi edhe te disa qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët për të arritur deri te synimi i tyre janë të gatshëm t'u përgjigjen kërkesave për korrupsion, apo vetë e nxisin korrupsionin për realizimin e qëllimeve të tyre.

Strategjia e luftimit të korrupsionit pa dyshim që duhet të përfshijë shumë sektorë. Në anën tjetër, një ndër mangësitë kryesore ka qenë edhe mosndëshkimi i faktorëve apo elementeve që janë marrë me korrupsion, apo që kanë nxitur rritjen e korrupsionit.

Ne jemi dëshmitarë që nga paslufta e deri tash, gati 14 vjet, nuk kemi parë ndonjë masë të ndëshkimit serioz e rigoroz të shumë zyrtarëve të lartë publikë, por edhe politikë, qoftë nga qeveritë e kaluara, qoftë nga postet e ndryshme publike. Si shembull konkret e kemi rastin e fundit në rajon në Republikën e Kroacisë, ku ish-kryeministri ndëshkohet me 10 vjet burg dhe kthimin e të gjitha atyre mjeteve, të cilat dyshohet që i ka keqpërdorur. Ndërsa ne në Kosovë kemi korrupsion shumë më të lartë se Kroacia, më tepër se shumë vende të tjera në rajon, por nuk e kemi gatishmërinë e luftimit të korrupsionit. Korrupsionin e kemi në çdo institucion publik, në shëndetësi, në ekonomi, në arsim. Por, institucioni kyç, i cili është përgjegjës për luftimin e korrupsionit, e nuk është përmendur në këtë strategji, është gjyqësia. Pa dyshim, që vetë Gjyqësori është i korruptuar, qoftë disa nga gjykatësit, nuk po them të gjithë; qoftë prokurorët dhe avokatët, të cilët bashkëpunojnë në mënyrë të mirëfilltë, e si rezultat përfundimtar është pastrimi i atyre që kanë qenë të involvuar në këtë proces.

Prandaj, strategjia për luftimin e korrupsionit kërkon një gatishmëri dhe mobilizim të të gjitha strukturave në nivelin tonë.

Vetë Agjencia Kundër Korrupsionit shihet se e ka një gatishmëri dhe vullnet për luftimin e korrupsionit, por, me çdo respekt për të, ai institucion nuk ka potenciale, nuk i ka kapacitetet e mjaftueshme që ta luftojë këtë dukuri, e cila po e përsëris se është bërë si oksigjen, pa të cilin nuk po mund të jetohej në Kosovë. E them me keqardhje, jemi në ranglistën e vendeve më të korruptuara në rajon dhe në nivel botëror. Prandaj, duhet një mobilizim gjithëpërfshirës, duke filluar nga vetë institucioni, i cili është i thirrur ta luftojë këtë korrupsion nga Gjyqësori, e pastaj në të gjitha fushat që kjo dukuri njëherë e përgjithmonë, nëse nuk mund të zhdukët në tërësi, së paku të zvogëlohet dhe të arrijë në nivelin e vendeve të rajonit.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, zonja Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” podržava strategiju i akcioni plan protiv korupcije za narednih 5. godina.

Korupcija se javlja u svim razvijenim i manje razvijenim zemljama. Ovakva strategija je jedan od načina borbe protiv njoj.

U strategiji koja stoji ispred nas vidimo da su tačno tergetirana na sedam sektora, na koje će se posebno obratiti pažnja. Sektoru su vrlo osetljivi na korupciju, i smatramo da će planirane aktivnosti u strategiji uspeti da ostvare svoj cilj.

Poslanici Parlamentarne grupe “6+” glasaće se za strategiju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Strategjia kundër korrupsionit 2013-2017 është një dokument, në të cilin LDK-ja ka shumë vërejtje.

Është dokument, i cili i ka teoritë e pakoordinuara brenda tij, por ajo që është më shqetësuese është mungesa e përcaktimit të institucioneve, mekanizmave e instrumenteve për ta luftuar me të vërtetë korrupsionin.

Si pjesë e kësaj strategjie, qysh në fillim është vlerësimi i Strategjisë 2009-2011. Por, çka mund të themi ne sot, në vitin 2013, për këtë periudhë? A ka korrupsion sot? Askush në këtë sallë nuk mund të thotë 'jo'. Po çfarë ka ndodhur me të korruptuarit? Ata e kanë zgjeruar rrjetin, i kanë sofistikuar metodat dhe kanë fituar në përvojë.

Nga vlerësimi i Strategjisë 2009-2011 thuhet se 24% e veprimeve janë realizuar, 26% nuk u realizuan, kurse 50% e veprimeve, të cilat kanë qenë të planifikuara në periudhën 2009-2011, janë në realizim e sipër.

Këto shifra tregojnë më së miri se si Qeveria Thaçi dhe institucionet e saj që i ka në kontroll po e luftojnë korrupsionin.

Unë dua të ndalem pak vetëm te Kapitulli V, ku flitet për objektivat specifike për sektorët prioritarë, objektiva këto të dëshirueshme, por komplet të paarrtshme.

Kur jemi te sektori politik, në Strategji thuhet se Ligji për financimin e partive politike është ende në procedurë, gjë që nuk është e vërtetë dhe edhe një herë e vërteton atë që u thanë në fillim nga përfaqësuesit e LDK-së se Strategjia nuk është ndryshuar, por ka ardhur po i njëjti draft, të cilin e kemi kthyer vitin e kaluar.

Këtu e kemi një objektiv shumë të mirë, meqë thuhet se duhet të bëhet zvogëlimi i hendekut ndërmjet deklarimit të origjinës së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Unë nuk e di asnjë rast, në të cilin Agjencia Kundër Korrupsionit ose Prokuroria e ka dikë nën hetime, i cili ka shpërputhje të madhe, ka diskrepancë ndërmjet pasurisë që e posedon dhe origjinës së saj. Njerëzit mjafton që të rrinë urtë, e të mos bëjnë skandale dhe ata mund të pasurohen me korrupsion në pafundësi, e askush nga këto institucione nuk do t'i ngucë.

Kur jemi te administrata qendrore, edhe këtu e kemi një objektiv shumë interesant. Thuhet që duhet ta kemi një administratë publike profesionale, jopolitike. Shtrohet pyetja: Si do të arrihet kjo? Ne e dimë se si janë punësuar njerëzit në Administratën Publike që nga viti 2007. Ata janë punësuar me posedimin e librezës së PDK-së dhe e dimë po ashtu se sa profesionale është kjo administratë. E si do të arrihet ky objektiv, a do të bëhet kjo duke i larguar të gjithë këta njerëz joprofesionistë që janë punësuar në baza partiake nga puna? Unë dyshoj se do të ndodhë një gjë e tillë.

Kur jemi te zbatimi i ligjit, Prokuroria, Gjyqësori, më ka bërë përshtypje objektivi që flet për rritjen e profesionalizmit, pavarësisë dhe integritetit të institucioneve të zbatimit të ligjit, siç janë Prokuroria dhe gjykatat.

Pavarësia është e paarrtshme deri tani. Përderisa vendi ynë udhëhiqet nga njerëz të korruptuar, ne nuk mund ta kemi një Gjyqsor dhe një Prokurori të pavarur.

Kur jemi te parandalimi dhe luftimi i korrupsionit, te prokurimi publik dhe shpenzimi efikas i parasë publike, edhe këtu duhet të flitet se prokurimi publik është strumbullari i korrupsionit, e nuk ka hapa konkretë dhe nuk ka metoda që parashihen në strategji se si do të luftohet kjo. Dhe kjo është shumë shqetësuese.

Kur jem te sektori privat, një ndër objektivat thuhet të bëhet promovimi dhe rritja e përpjekjeve të përbashkëta kundër korrupsionit ndërmjet sektorit privat, atij publik dhe shoqërisë civile.

Nëse dikush nga ju ka biseduar me kompanitë private, ato të cilat çdo ditë thonë se japin 10 deri 20% për çdo tender publik, dhe ajo që u thoni është se pse ju nuk dilni publikisht t'i publikoni emrat e personave që marrin ose kërkojnë nga ju 10 ose 20%. Ata ju tregojnë se në momentin kur ata do ta bëjnë një gjë të tillë, së pari duhet t'ia vënë drynin biznesit të tyre, sepse asnjëherë, ama asnjëherë në jetë, ne nuk mund të fitojmë tender nga institucionet publike.

Deputetë të nderuar,

Korrupsioni në Kosovë është në sistem dhe njerëzit e korruptuar nuk mund ta luftojnë korrupsionin. Andaj, me këtë Qeveri, ky nuk është asgjë tjetër, vetëm se një dokument shumë i kotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Ata që mendojnë se duhet të kemi strategji kundër korrupsionit, besojnë që ne të gjithë këtu sot jemi dakorduar tashmë për botëkuptimin, parimet dhe qëllimet e luftës kundër korrupsionit.

Unë nuk mendoj se është kështu. Jam i bindur që ne kemi botëkuptime të ndryshme, parime të ndryshme dhe qëllime të ndryshme sa i përket luftës kundër korrupsionit.

Prandaj, nuk është e rastësishme që në këtë strategji, që e kemi para vetes, shprehjet kryesore janë: rritja, zvogëlimi, përmirësimi, forcimi e të tjera. A thua se drejtimi dhe kahja janë në rregull, veç se shpejtësia duhet ndryshuar.

Nuk mendoj që luftimi i korrupsionit është çështje e shpejtësisë joadekuate, por e orientimit të gabuar. Pra, edhe nëse hedh hapa të duhur, edhe nëse këtë e bën me shpejtësinë e duhur, që të gjitha këto janë në drejtimin e gabuar.

Prandaj, para se të diskutojmë për çfarëdo strategjie, ne duhet ta kuptojmë që konceptualisht e trajtojmë ndryshe luftën kundër korrupsionit.

Dhe, pikërisht ky dallim konceptual bën që ne të diskutojmë për opinione të ndryshme në këtë seancë, ndërkohë që nuk pajtohemi as për faktet.

Në Kosovë kemi privatizim me zbatim efikas dhe pa ligj për privatizimin dhe kemi sundim të ligjit me ligje përgjithësisht të mira në letër, por që nuk zbatohen në praktikë.

Dhe, njëkohësisht e kemi stabilitetin afatshkurtër politik, i cili bën që në rrjetin e gjyqësisë të kapen eventualisht peshqit e vegjël të korrupsionit, por kurrësi peshkaqenët e mëdhenj.

Kësisoj, sundimi i ligjit në Kosovë vjen në shprehje vetëm nëse paraprakisht vërtetohet dhe garantohet që ai nuk e cenon as privatizimin e egër neoliberal, e as stabilitetin afatshkurtër politik.

Ky sundim i ligjit nuk është sundim i ligjit, por sundim me ligjin, që do të thotë se kemi sundimtarë të ligjit.

Nëse sundimi i ligjit zbatohet vetëm atëherë kur garantohet se nuk do të cenohet as privatizimi i egër neoliberal, e as stabiliteti afatshkurtër politik, nuk kemi të bëjmë më me sundim të ligjit.

Për ta ilustruar këtë, vetëm vërejeni në faqe 23, tek objektivat e shprehura në rrafshin horizontal, thuhet: “Promovimi i kulturës së praktikave të mira dhe parimit të tolerancës zero për korrupsion në lidhje me privatizimin”, mirëpo këtu privatizimi është korrupsion. Nuk mund të flasim për praktika të mira përderisa privatizimi zbatohet pa pasur ligj për privatizimin, që do të thotë se privatizimi është ilegal dhe praktikat e zbatimit të një privatizimi ilegal janë krime.

Si mund të flasim për praktika të mira në lidhje me privatizimin, kur këto praktika të mira zbatohen duke mos pasur ligj për privatizimin dhe pikërisht këto praktika të mira në fakt janë aspekti kriminal i privatizimit ilegal. Por, edhe një herë po them që nuk është çështje strategjie kjo, është çështje botëkuptimi, e vlerave, parimeve dhe qëllimeve që i kemi aq të ndryshme këtu.

Besoj që të gjithë e keni parë një intervistë të zotit Soren Jesen-Petersen, ish-kryeadministrator i UNMIK-ut, për emisionin “Jeta në Kosovë”, para më shumë se një viti, kur pati deklaruar tash që ishte në një lloj pensioni, meqenëse nuk kishte as një ofiq zyrtar, se çdo herë kur kanë provuar ta arrestojmë dikë për krime të rënda në Kosovë prej këtyre peshkaqenëve të mëdhenj, ai tha se nuk mund ta merrni me mend se kush i ka thirrur në telefon një ditë përpara. Nuk mund të ketë sundim të ligjit atëherë kur ka këso intervenimesh në emër të stabilitetit afatshkurtër politik, me ç’rast është e qartë se kështu menaxhohet kriza në Kosovë si një lloj emërtimi tjetër për stabilitetin afatshkurtër politik. Menaxhimi i krizës që e mirëmban krizën nuk e lë të shpërthejë atë dhe, mbi të gjitha, nuk kujdeset pra as për drejtësinë, as për demokracinë, as për zhvillimin ekonomik, por vetëm për rendin e gjërave që duhet të mbetet po ky, eventualisht me një përmirësim

margjinal, i cili sërish është në funksion të konfirmimit të rendit të gjërave, e jo të ndryshimit të kësaj situate.

Unë pajtohem shumë me deputeten Bajrami, e cila tha se korrupsioni është sistem. Është një autor holandez, i cili e ka shkruar një libër për shtetet, si puna e vendit tonë, në të cilin thotë që atje nuk është sistemi i korruptuar, por korrupsioni është sistem. Edhe unë pajtohem me këtë rast për shkak se dua të them që korrupsioni nuk është kulturë, por është sistem, vjen prej lart dhe zbret poshtë. Nuk ka të bëjë me popullsinë që të mendohet se korrupsioni na qenka në kulturën e popullit tonë. Andaj gjërat janë kështu siç janë dhe s'kemi se çfarë të bëjmë. Është e kundërta, korrupsioni pra nuk është kulturë, por korrupsioni është sistem, i është imponuar popullit tonë dhe është fajtor për varfërinë, për papunësinë dhe për mungesën e perspektivës për popullin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që në frymën e asaj që ky dokument patjetër duhet sot të jetë i aprovuar nga Kuvendi, mundësisht t'i jap disa argumente, të cilat mendoj që janë në frymën e kësaj që unë mendoj.

E para, ju e dini që ka qenë një debat vitin që shkoi, i cili ka rezultuar me mosaprovimin e këtij dokumenti, ose të strategjisë antikorrupsion dhe vetëm merreni e konsultojeni procesverbalin dhe do ta shikoni që i gjithë debati ka qenë politik, madje nuk ka pasur as një të vetmin propozim konkret, i cili do të kërkonte shtimin e ndonjë mase konkrete praktike, ose të ndonjë veprimi, i cili do ta pasuronte strategjinë, e cila është një dokument i punuar, jo vetëm nga Agjencia Kundër Korrupsionit, por edhe nga shumë institucione të tjera politike e jopolitike.

Është e vërtetë që ne këtu kemi dallime politike, kemi bindje politike. Debatin ynë mund të shkojë edhe për rregullimin shoqëror të vendit, mund të shkojë edhe për ndryshimin e Kushtetutës, mund të shkojë edhe te mënyra sesi e perceptojmë ekonominë e vendit e tjera. Por, dokumenti antikorrupsion nuk është asgjë tjetër vetëm se një përmbledhje e disa masave, veprimeve, e politikave, të cilat synojnë koordinimin e të gjitha institucioneve të vendit në luftimin e korrupsionit. Prandaj, edhe debati duhet të ishte më praktik dhe të synojë përmirësimin cilësor të ndonjë veprimi ose politike që duhet të inkorporohej në këtë dokument, i cili është dashur të jetë i aprovuar edhe atëherë kur opozita nuk e ka bërë këtë.

Më lejoni të ju them që edhe brenda debatit në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, atëherë kur nuk është aprovuar, sepse është refuzuar nga opozita, ka pasur dallime dhe pasur kërkesa të tilla se nuk ka mjaft veprime në këtë dokument për ta luftuar korrupsionin dhe ka qenë një bindje se duhet t'i lëmë pavarësi institucionit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, që ajo t'i ketë duart më të lira në luftimin e korrupsionit.

Këtu u tha se ky dokument nuk është gjithëpërfshirës. Më lejoni të ju them që ju e dini, edhe nëse nuk i besoni asaj që është shkruar këtu, që dokumenti i përmirësuar ose i shtuar

me veprimet që nuk kanë qenë, është bërë pikërisht në bashkëpunim të të gjitha institucioneve, edhe të Qeverisë, me koordinimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, me organizatat e shoqërisë civile dhe me përfaqësues të Komisionit Evropian. E ju e dini që Komisioni Evropian është institucioni i cili e përcjell progresin tonë në të gjitha fushat dhe po ashtu i bën raportet për çështjet për të cilat ne po diskutojmë sot, përfundimisht në antikorrupsion ose në luftimin e korrupsionit.

Ju e dini po ashtu se edhe në dokumentin e studimit të fizibilitetit është kërkuar që në mënyrën sa më të shpejtë, ose në kohën sa më të shpejtë të aprovohet strategjia kundër korrupsionit.

Unë kërkoj që sot deputetët ta aprovjnë pa hezitim këtë dokument, e të mos vijmë në situatën kur prapë në Raportin e Progresit, ose në dokumentet tjera të institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare të kemi vërejtje se ne nuk e kemi aprovuar këtë dokument.

Mbetet që dokumenti të jetë më i gjallë, pra të plotësohet. Kuvendi, përveç asaj që kemi detyrë në përmirësimin e legjislacionit, që është në favor të pengimit të kësaj dukurie, ka edhe një varg aktivitete tjera, që ne do t'i kemi për çdo ditë si detyrë për t'i kryer, si edhe institucionet tjera. Ajo që kërkohet nga ne është t'ia japim dritën jeshile këtij dokumenti, ta kemi strategjinë dhe të kërkojmë edhe herëve tjera, në mënyra tjera si deputetë, jo vetëm duke i përmirësuar ligjet, por edhe veprimet tjera nga institucionet tjera që janë në varësi të Kuvendi, në mënyrë që të ketë më shumë veprime dhe aktivitete në luftimin e kësaj dukurie, e cila është pikë mjaft e zezë për imazhin e vendit tonë. Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit zoti kryetar i Kuvendit!

Po të duam të jemi esenciale, nëse jem përfaqësues të zgjedhur, korrupsioni më i madh është institucional dhe po ndodh sot këtu, sepse është një Kuvend që po bisedon, e nuk e kemi asnjë përgjegjësi qeveritar.

Ky është korrupsioni më i lartë, korrupsioni institucional; i dyti është korrupsioni politik, që është kategori që i sundon shoqëritë jodemokratike. E ne bëjmë një diskutim edhe në Kuvend të natyrës: “Kush është fajtor - gjithkush e di, prandaj nuk po e them”. E ky është dominanti i diskursit për temat e forta, të cilat i dëgjova katër a pesë herë sot. Pra, korrupsion i të folurit është mënyra kur thuhet: “Gjithkush prej nesh e di kush ka faj, prandaj nuk po e them”. Këtë e thonë zakonisht deputetët këtu në Kuvend.

E treta, kërkesa “Do ta bëjmë këtë se po e ndreqim imazhin jashtë”. Ky është të folurit edhe më i korruptuar. Nuk ndreq kurrfarë imazhi jashtë nëse dikush të thotë është normë ta bësh një dokument dhe ti e kalon atë dokument, bile e kalon shumë të keq. Përkundrazi, e prish imazhin, sepse tregon që nuk di të ndërtosh as normë. Aq më tepër kur dokumenti pretendon t'i ketë nja pesë vjet jetë, që dashtë Zoti, nëse ka ndryshime pas

pesë vjetëve, as përfaqësuesit, as ekzekutivët, shumica nuk do të jenë këtu besoj, se është normale kështu në një shoqëri demokratike.

Korrupsioni për kah natyra nuk është se këtu, edhe në shoqëri, kuptohet si vjedhje në xhep, ose në banesë. Nuk është. Pra, moszbatimi i ligjit është i rrezikshëm më së shumti, më së larti në piramidë, e nëse ekziston një vend super i korruptuar, ose shumë i korruptuar, ose mesatarisht, gjithmonë masa është lart. Sa më poshtë, e tha dikush, më duket zoti Kurti, nuk është kulturë, nuk mund t'i thuhet asnjë populli, edhe këtij të Kosovës assesit, se për kah natyra është i korruptuar. Jo! S'ka shans! Asnjë popull nuk është i korruptuar për kah natyra, ose për kah kultura, që po i themi.

Dhe, unë nuk dua të vazhdoj më tutje. Dokumentin e kam lexuar. Dokumenti është i keq. Është i keq për natyrën që e ka. Unë e di që është dokument që nuk specifikon shumëçka, se duhet të ketë standarde e norma, por normat janë të ndërtuara keq, teksti është i shkruar gabimisht. Ju një herë po thoni që e ka bërë agjencia. Një njeri, një deputet këtu, që e respektoj, tha se e ka bërë agjencia; një tjetër tha 'jo, e ka bërë agjencia, por e ka miratuar Qeveria'. Pra, është dokument i Qeverisë. I treti po thotë që e kanë miratuar Qeveria, Agjencia, BE-ja, UE-ja, e në fund është ky.

Është mirë të flasim kështu, se nuk është e përgjegjshme. Le të thuhet, unë e di, krejt ligjet i shkruan Qeveria, dikush i shkruan, por në momentin kur ajo bëhet sponsor i tij - është ligji i saj, sikur këtë dokument, nuk e di kush e ka shkruar, se shumë e paskan shkruar, nëse e miraton Kuvendi - është dokument i Kuvendit, dhe nuk kemi të drejtë të ankojemi pastaj.

Për t'u bërë konkret, se nuk dua të flas më gjatë, sepse nuk e konsideroj që duhet të flitet gjatë për dokumentin, që me kryeneçësi, kushdo që ta ketë bërë, ta kthen pas gjashtë muajsh pa e prishur. Vetë gjesti është korrupsion, sepse ai është kthyer. Konkretisht, shumë konkretisht, se aq sa flitet konkretisht. Thashë, i korruptuar më i fortë është ai që ka pushtet më shumë. Kjo është abece.

Unë, pasi po duam të flasim konkretisht, i kam dy fjalë. Nëse ky dokument thotë që 1, 2, 3 veprimtari janë shumë të korruptuara, pse nuk kërkohet përgjegjësi ndaj përgjegjësit ekzekutiv të atyre veprimtarive.

Dhe, më tutje, ne i kemi dy ministri të dy resorëve që në kohën e fundit, edhe në këto banka është folur për to, por edhe në opinion flitet për çdo ditë, që është Ministria e Brendshme, dhe atë pjesën, që unë e quaj korrupsion politik, Ministria e Mbrojtjes. Ata dy ministra e thonë në Kuvend dhe e thonë në publik, zotërinj, çdo të dytën ditë: "Ne nuk japim dorëheqje me asnjë kusht, as nuk hiqemi, sepse fatin e kemi në dorë të Hashim Thaçit", që është një artikullim jokorrekt, mos pyet, por edhe politikisht pak qesharak. Atëherë, o ata janë pengje të Hashim Thaçit, o Hashim Thaçi është peng i tyre. Përndryshe, ky diskurs publik para Kuvendit dhe para njerëzve, të thuhet nga një njeri që e ka një funksion shoqëror, të thotë 'unë nuk mund të jap dorëheqje, le të bëhet nami, sepse këtë punë e kam lënë në dorë të Hashim Thaçit'. Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Meqenëse unë e përmenda që dokumenti është punuar dhe është rishikuar pas atij momenti kur është refuzuar në Kuvend nga disa institucione, këtë e keni këtu dhe janë institucionet, të cilat kanë marrë pjesë.

Dëshiroj vetëm të shtoj: Ky dokument nuk është as Kushtetutë, nuk është as Kod Penal, nuk është as Ligji për konfiskimin e pasurisë, është një dokument i cili është marrë nga përvojat më të mira të vendeve të tjera, të cilat kanë përvojë në luftimin e korrupsionit dhe mund t'i pyetni edhe anëtarët e partive, të cilat kanë marrë pjesë, edhe nga Lidhja Demokratike shumë anëtarë, edhe sa kemi qenë në pushtet, se dokumenti nuk ndryshon nga versioni i cili ka qenë më herët, zyrtarët, të cilët kanë marrë pjesë në përgatitjen e strategjisë edhe më herët.

Pra, është një proces i kopjuar ose i ndikuar nga shumë vende, të cilat bëjnë aktivitete në fushën e integriteteve evropiane dhe si model është marrë nga këto vende, bashkë me përvojat e vendeve të regjionit, dhe u është adaptuar nevojave të Kosovës.

Mendoj që është koha kur të gjithë bashkë duhet të punojmë në frymën e këtyre orientimeve dhe në frymën e atyre zotimeve që i kemi marrë para BE-së që ta luftojmë korrupsionin të gjithë bashkërisht.

Dhe, nëse është për etiketime se çka është korrupsion - korrupsion është edhe nëse përdoret këtu foltorja për t'i etiketuar njerëzit e ndryshëm, zyrtarët e ndryshëm, edhe nuk çohen provat, nëse kemi, atje ku është vendi, në drejtësi, për ta treguar një korrupsion ose një rast të krimit, nëse e kemi. Faleminderit!

KRYETARI: A do kundër replikë? Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Shikoni! Unë u bëra shumë konkret, por konkretësia është më e vështira në këtë shoqëri. Këtu është problemi. Se nuk do konkretisht kurrkush të veprojë gjë, as të bëjë gjë.

Dhe, tash unë dëgjoj shpjegime morale, që të gjithë kanë punuar e nuk kanë punua. Po edhe të gjithë nëse kanë punuar, e kanë prodhuar një tekst të keq. Keq e kanë bërë. Kjo nuk më zbraps në pikëpamjet që i kam rreth kësaj pune.

Edhe e dyta, ne jemi shoqëri e ekzagjerimit, e kjo po na shkatërron, faktikisht po na bënë joveprues, sepse ose lavdëron pa kufij, ose përmbys në pa kufij. E vërteta nuk preket kurrësi. Si drejt t'i iket së vërtetës. E vërteta është konkretja, realja. Edhe dokumentet që pretendojnë të jenë të kualifikimeve ndërkombëtare, nëse nuk kanë lidhje me realen e një shoqërie, janë fiksione, janë utopi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Mendoj që nuk ka gjë më qesharake dhe tentim më i pakuptimtë se kur dalin persona, të cilët mundohen në njëfarë mënyre ta mbrojnë atë që në Kosovë po quhet luftë kundër korrupsionit, edhe pozicionin e institucioneve politike, veçanërisht të atyre të Ekzekutivit, pra të Qeverisë, karshi këtij problemi.

Pra, e kemi në njërën anë që secili raport që vjen nga jashtë dhe perceptimet e brendshme, por edhe secili ligjërim që bëhet për sa i përket kësaj çështjeje për Kosovën vlerëson se shkalla e korrupsionit, jo vetëm që është e lartë, por shkon vazhdimisht duke u rritur, ndërkohë që i kemi pastaj përfaqësuesit e Qeverisë, edhe deputetët e koalicionit qeverisës, veçanërisht të PDK-së, që thonë që megjithatë është punuar shumë në këtë drejtim.

Pra, në njërën anë e kemi një korrupsion që paraqitet goxha si absolut dhe, në anën tjetër, e kemi një tentim për të thënë që Kosova në fakt i ka punët shumë mirë në këtë drejtim.

Prandaj, unë po e quaj qesharake këtë përpjekje për shkak se nuk është askund në përputhje me atë që shihet dhe me atë që e dinë njerëzit, e që e përfetojnë për çdo ditë.

Unë mendoj që debati rreth korrupsionit në Kosovë, veçanërisht në kuluarët ekzekutive është disi i korruptuar dhe i përçudnuar, për shkak se e kemi parë se ekziston njëfarë tendence që të themelohen grupe, forume të ndryshme ndërministrorë, e pastaj edhe më të larta qoftë, nga Presidentja, qoftë nga Qeveria, e kështu me radhë, për një luftë kundër korrupsionit me task-forca përcjellëse me Agjencinë Kundër Korrupsionit. Ndërkohë që të gjitha këto shërbejnë pastaj vetëm sa për ta krijuar një iluzion se kinse po bëhet diçka në luftën kundër korrupsionit dhe, në anën tjetër, sa për ta krijuar një hapësirë ku korrupsioni nuk do të krijohet fare.

Dhe në këtë drejtim konsideroj që, natyrisht, është i rëndësishëm debati politik për korrupsionin për shkak se debati për korrupsionin është politik.

Në anën tjetër, nuk është hera e parë që po e dëgjojmë, pra shpeshherë e dëgjojmë edhe në Kuvend, por edhe në komisionet përkatëse të Kuvendit që të mos bëjmë politikë, të mos diskutojmë politikisht, por të diskutojmë në një aspekt tjetër. Tash unë nuk e di cili është ai aspekti tjetër. Për shkak se Kuvendi në një republikë është organ legjislativ, i cili po ashtu është forumi më i lartë politik, ku paraqiten pikëpamjet e ndryshme politike të grupeve të caktuara të partive politike, apo të subjekteve tjera politike karshi çështjeve të caktuara, dhe vendimet janë të Kuvendit, përveç që merren me shumicë votash, por edhe vendimet e grupeve parlamentare duhet të jenë politike në kuptimin që bazohen në konceptin dhe programin politik që ato paraqesin.

Pra, nuk ka kurrfarë kuptimi në njërën anë të tejçmohet pluralizmi politik demokratik dhe, në anën tjetër, të kërkohet që të mos vihet në funksion pikërisht në atë instancë të pushtetit, ku do të duhej të vinte më së shumti në funksion, e që është Kuvendi.

Pra, mendoj që nuk është e udhës, nuk është e saktë dhe nuk është e pranueshme nga deputetët të kërkohet që kur flasin për çështje të caktuara në Kuvend të mos flasin politikisht, për shkak se mënyra e vetme se si ne mund të flasim është politikisht. Ne këtu teknikë nuk jemi asnjëri. Pra, edhe po që se kemi përgatitje profesionale, këtu nuk jemi zgjedhur për shkak të përgatitjeve personale, por për ta përfaqësuar një program politik. Dhe, në këtë kuptim, debati rreth korrupsionit pra është politik dhe duhet të jetë politik.

Mendoj se duke dëgjuar nga ato që u thanë dhe duke u ndërlidhur me disa prej parafolësve, është e qartë që këtu kemi një mospajtim të thellë në definimin e korrupsionit. Pra, u pa edhe nga deputetët e ndryshëm që folën, të gjithë e shprehën atë se çfarë mendojnë ata që është korrupsion dhe si po luftohet ai dhe u pa që në fakt definimi i korrupsionit është lë shumë për të dëshiruar.

Unë nuk po tentoj të bëj kurrfarë definimi të korrupsionit, por vetëm kisha dashur t'i paraqes disa elemente që unë mendoj që po ndodhin sa i përket këtij koncepti, që quhet korrupsion në Kosovë.

Pra, në ligjërimit publik rreth korrupsionit - me korrupsion kryesisht është nënkuptuar keqpërdorimi i fondeve publike, pra keqpërdorimi i parave publike dhe, në anën tjetër, marrja e mitos, që i bie edhe si rrjedhojë e këtij keqpërdorimi të parave publike. Pra, këto janë konsideruar si korrupsion.

Mendoj që kjo është pjesë e asaj që quhet korrupsion, mirëpo korruptimi dhe mënyra, praktika e korruptuar e të udhëhequrit me një post publik, nuk mund të kufizohet vetëm në këtë, për shkak se lë shumë gjëra të tjera pastaj që janë po ashtu të rëndësishme jashtë kësaj dhe rrjedhimisht meqenëse i lë jashtë definimit, i lë edhe jashtë luftës kundër korrupsionit.

Pra, unë e kisha shtruar një pyetje këtu: Çka të bëjmë me ato vendime, të cilat merren nga një përfaqësues i një institucioni publik, qoftë i kryeministrit, i ministrave të dikastereve të caktuara, apo i një institucioni tjetër, të cilët jo domosdoshmërisht rezultojnë në përfitim personal financiar për atë person, por që rezultojnë në dëmtim të vetëdijshëm të interesit të Kosovës. A është ky korrupsion, apo jo? Se unë mendoj që ky është korrupsion dhe për këtë duhet të kemi mekanizëm si ta luftojmë. Pra, nuk bënë të lejohet që ministrat, kryeministri apo udhëheqësit tjerë institucionalë t'i kenë duart e lira që të marrin vendime, duke e ditur se janë në dëm të interesit të Kosovës dhe duke i ikur pastaj dënimit për shkak se nuk mund të dëshmohet drejtpërdrejt përfitimi financiar që mund ta ketë ai person nga ky vendim i gabuar. Pra, ky është korrupsion edhe nëse nuk mund të konkretizohet se është ndërruar apo ka kaluar një pjesë e financave të kontratës apo të vendimit në duart edhe në xhepat e ministrit a të kryeministrit.

Dhe, në këtë drejtim konsideroj që është e domosdoshme që të kujdesemi sa herë t'i miratojmë ligjet, e veçanërisht ligjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me këtë çështje, apo me këtë mundësi, të kujdesemi që këtë praktikë ta sanksionojmë me ligj. Pra, vetëm për sa ta ilustruar atë që dua të them. Në Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve publike, që është kaluar në këtë Kuvend në vitin 2011, shprehimisht thuhet që administratorët për

“Trepçën” nuk mund të ndëshkohen, po qe se vendimet e tyre, që i ka marrë për “Trepçën”, rezultojnë në dëm të saj. Pra, kjo nënkupton që ata janë të lirë të marrin çfarëdo vendimesh dhe pavarësisht nëse këto e dëmtojnë një ndërmarrje të caktuar, në këtë rast “Trepçën”, që është shumë e rëndësishme, nuk mund t’i ndjekim ligjërisht ata për këtë vendim të tillë për shkak se, siç thuhet aty në ligj, ata mund ta marrin një vendim të tillë për shkak se nuk mund t’i kenë të gjitha informatat, pra ta dinë saktë nëse vendimi i tyre do të rezultojë si i mirë apo i keq për ndërmarrjen. Dhe, unë mendoj se kjo është praktikë e korruptuar për shkak se ia lë pastaj derën hapur çfarëdo vendimi për çfarëdo interesi që të merret në Kosovë dhe për Kosovën.

Çështja e datë është pastaj, që ndodh shpesh ndoshta edhe me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku për çdo ditë e më shumë po shohim që ekziston një lloj tendence e përfaqësimit të interesave të ngushta partikulare, jo domosdoshmërisht personale, të një subjekti ekonomik apo të një sektori të caktuar ekonomik dhe këtë pa e menduar as dy herë, nëse interesi i Kosovës do të jetë i plotësuar me këto deklarime të tyre dhe me këto votime të tyre.

E, unë mendoj që kjo është po ashtu praktikë e korruptuar e të bërit politikë për shkak se ne këtu jemi që ta mbrojmë dhe ta avancojmë interesin e përgjithshëm, e jo interesin partikular të një grupi të caktuar, apo një ndërmarrjeje të caktuar.

Dhe, për fund desha ta ngre një çështje tjetër që lidhet me këtë, pra ta tërheq vëmendjen te një grup ose organizatë, siç quhet - globale e parlamentarëve kundër korrupsionit, e cila ekziston në botë më duket tash e tetë vjet. Ky është një rrjet i parlamentarëve që i mbledh përfaqësuesit e vendeve të ndryshme në konferencat periodike, në të cilat diskutohen dhe këmbehen praktikat më të mira të luftës kundër korrupsionit. Pra, është në njëfarë mënyre një tendencë për t’i fuqizuar kuvendet e vendeve në luftën kundër korrupsionit dhe në të gjitha ato që u folën deri këtu.

E di që ka ekzistuar një iniciativë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës që të themelohet grupi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i përbërë nga të gjitha subjektet politike, që do të jenë përfaqësues të Kosovës, apo pjesë nga Kosova të këtij rrjeti të kësaj organizate ndërkombëtare, dhe kjo tendencë ka hasur në një ngërç për shkak të injorimit që po i bëjnë këtij grupi deputetët nga koalicioni qeverisës, veçanërisht nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

E, unë mendoj dhe po e bëj publikisht një thirrje që ky grup nga Kuvendi i Republikës së Kosovës domosdoshmërisht të themelohet me apo pa praninë e deputetëve nga koalicioni qeverisës. Nuk kam asgjë kundër që koalicioni qeverisës të jetë pjesë e këtij grupi, mirëpo nëse këta nuk duan që të jenë pjesë e këtij grupi për arsye të ndryshme, e unë mendoj që arsyeja kryesore është për shkak se vërtet nuk janë të interesuar të bëjnë asgjë në luftën kundër korrupsionit, atëherë ky grup të themelohet me ata deputetë të cilët janë të interesuar dhe do të kenë vullnet të marrin pjesë në këtë grup, për shkak se ky këmbim i informatave, i praktikave dhe përvojave të vendeve të tjera mendoj se do t’i ndihmonte Kosovës, e veçanërisht Kuvendit të Kosovës, që të bëhet më i fuqishëm në këtë luftë me korrupsionin. Faleminderit!

KRYETARI: A po shkojmë në pauzë, apo kemi edhe shtatë deputetë. Të gjithë janë të Lidhjes Demokratike, të lajmëruar. A shkojmë në pauzë a e kryejmë? Mirë. Deputetja Rita Hajzeraj Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Po më vjen keq dhe nuk e di a është etike kur flasim për një temë jashtëzakonisht të rëndësishme, të mos jetë asnjë anëtar i Kabinetit Qeveritar, këtu.

Konsideroj që lufta ndaj korrupsionit duhet të kalojë nga sfera e retorikës në atë të veprimeve konkrete. Kjo do të ishte mënyra më e mirë, që Kosova ta përmirësojë legjitimitetin e saj të brendshëm dhe atë ndërkombëtar, ta etablojë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe të jetë e krahasueshme me shtetet e tjera perëndimore. Duke i përkrahur të gjitha ato fakte të cilat deputetët apo kolegët e mi i thanë më herët, dua t'i shtoj edhe disa nga mangësitë apo dobësitë, që i përmban kjo strategji antikorrupsion e që është mungesa e studimeve, hulumtimeve dhe raporteve, që tregojnë karakteristikat, natyrën dhe shkaqet e korrupsionit në Kosovë.

Mungesa e përfshirjes së institucioneve adekuate të cilat kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit e që nuk janë të përfshira në procesin e hartimit të këtij dokumenti, mungesa e seriozitetit në përcaktimin kohor të masave antikorrupsion dhe kostos financiare të tyre, mospërmblidhja e mjaftueshme e objektivave dhe masave vepruese kundër korrupsionit.

Dhe, krejt në fund, kemi mjaft ligje, kemi dy strategji që janë bërë 2004-2007 dhe 2009-2011, e kemi Këshillin Kombëtar i cili është themeluar nga presidentja, po ashtu e kemi edhe Agjencinë Antikorrupsion. Pra, kemi mjaft institucione të cilat merren me luftimin e kësaj dukurie e që do të duhej të na merrnin lakmi të gjitha shtetet tjera.

Por, a po funksionojnë këto mekanizma, është pyetja kryesore? Dhe, unë konsideroj, që këta mekanizma deri më tani nuk kanë funksionuar dhe nuk po funksionojnë.

Problemi është sepse Prokuroria, rendi juridik, gjykatat janë mbërthyer nga nepotizmi politik i pushtetit dhe në një vend ku rendi juridik është në kolaps total, nuk mund të pritët zbatimi i strategjive antikorrupsion. Kështu që edhe këtë herë kjo strategji e mangët nuk premtonte rezultate konkrete, është teori, përshkrim teorik, por në funksion të qëllimit nuk është.

Kosovës i duhet një strategji konkrete me hapa konkret, por jo një demagogji, e cila do të thotë po i përcjell edhe demagogjitë tjera paraprahe.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Eqrem Kryeziu e ka fjalën.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot nuk do t'ju mërzis t'ju marr leje ta përshëndes Qeverinë se s'ka asnjë këtu, kështu që po ju kursejmë nga ajo punë.

Nga ana tjetër më lejoni të them për këtë pikë, njëfarë, ndoshta është e vërtetë, se kur brenda përsëritet vazhdimisht, ajo shndërrohet në një komedi. Nuk jam krejt i sigurt a është e vërtetë, por ka edhe opsione të tilla. Kështu që si u tha edhe nga shumë parafolës këtu, ajo që vihet shpeshherë në rend të ditës, çështja e korrupsionit, në fakt ne po bëjmë komedi me vetë problemin. Kjo është e para.

E dyta, siç tha Mjeda: “Vdekja mendova që më vjen kurdo, që më gjen kjo s’mendova jo”. Edhe unë ta them të drejtën, tash sigurisht si pak më naiv jam unë në karshi me njerëzit që kanë përvojë të madhe, por në atë naivitetin tim s’kam mund ta marr me mend që Evropa do të na thotë: “Hej burra, mos e vidhni shtëpinë tuaj!”.

Unë e përjetoj si një goditje fatale faktin se Evropa thotë: “mos e vidhni shtëpinë tuaj”. Natyrisht, nga Evropa ne kemi shumë gjëra për të mësuar. Madje, as nuk jam as unë me këtë moshë, aq i vetëdijshëm sa gjëra kemi për të mësuar prej tyre, nga përvoja e gjatë e jetës demokratike, por kjo me thënë: “mos e vidhni shtëpinë tuaj”, me të vërtetë këtë nuk kam mundur ta marr asnjëherë me mend.

Tani, madje shikoni çka na vjen nga Evropa, çfarë formulimi, pothuaj zyrtar: “Nuk ka, tha, vullnet politik për ta luftuar korrupsionin”, që do të thotë se këto kualitete që janë në skenën kosovare, përfshirë edhe mua zoti kryetar, nuk është se po akuzoj unë njerëz kështu tamam me “syret” e me të dhëna, këto kualitete të këtilla çfarë janë në skenën kosovare, veç pak duhet njëfarë vullneti, se janë në gjendje ta bëjnë këtë. Edhe ky po më duket formulim shumë denigrues. Është fjala për mungesën e moralit politik për të luftuar korrupsionin, jo vullnetit politik.

Edhe unë gjithmonë e kam kënaqësinë të pajtohem me, kështu që me të vërtetë unë po kërkoj falje, se kjo po duket se na po flasim madje, edhe unë, me këto vite që i kam, sa për të bërë punën e pond pilotit, që i lau duart e tha: “E pat, edhe këtë, e kryem këtë punë”

Unë e kam kënaqësinë të pajtohem gjithmonë me profesreshën Bajrami edhe më la përshtypje fjalimi i saj sot, mirëpo unë po dua ta ngushëlloj me një alternativë tjetër, që të mos t’i marrë krejt gjërat ashtu tragjike. Kjo nuk do të thotë se unë do të kem të drejtë, po është liria ime t’ju jap njëfarë lloj ngushëllimi, edhe pse natyrisht s’kam qare pa u pajtuar me atë që po thoni ju. Edhe kjo i ka ndodhur perandorit Tiberius, kjo çka po dua të them si njëfarë lloj mesazhi ngushëllues. Kur shkon në Aleksandri me sketrin perandorak, me eskortë e me krejt shkurren e vet, në një rrugicë në diell, se atje nxehtë bëhet në Egjipt, ne e dimë këtë punë, e shoh një njeri pothuaj lakuriq, por jo lakuriq krejt, sepse mizat e kanë mbuluar në puçrrat që i ka në trupin e tij. Pra, lakuriq ai është, por jo nga mizat se janë duke u ushqyer me puçrrat që ka në trup. Edhe tash Tiberius, perandori i vet u mëshirua dhe vajti me sketrin e tij që t’ia tremb mizat, eskorta që ishte me të, ishte gati të bënte një himn planetar për mëshirën e perandorit mbi këtë të gjorë, sa ishte gati, se ata kanë qenë Romë, ma, Roma antike kanë qenë mjeshtër në këto shprehje, sa ishin gati ata për të bërë formulimet më të mira, po dëgjon po e shan ai i sëmuri, po e shan perandorin. Këta u stepën. Tha, ç’u bë, tha po në vend se të më bësh mirë, po më bën keq, - tha, sepse po m’i

tremb mizat që janë ngopur me gjakun tim e do të vijnë mizat e tjera që kanë me më sosë krejt”.

Kështu që në këtë aspekt, ndoshta mundet me qenë, përderisa nuk ka një moral politik, ndoshta edhe mund të jetë problem. Unë po kërkoj falje, se ju mora kohën, por sidoqoftë edhe juve ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Unë u lajmërova me vonesë, po për rend, faleminderit që m’u dha fjala për të dhe s’e kisha ndërmend të flas, se ç’është e vërteta, të nderuar deputetë, siç po e shihni jam edhe i ftohur. Dhe, jam jo vetëm i ftohur biologjikisht, po seç e kam edhe një ftohje me këtë qasjen tonë ndaj problemeve të tilla të mëdha siç është korrupsioni.

Më duket disi kjo lufta jonë kundër korrupsionit, si lufta e protagonistëve të letërsisë spanjolle me mullinjtë e erës. Ne po bisedojmë për strategjitë. Kishim strategji edhe përpara dhe moto ishte: “zero tolerancë korrupsionit”. Vjen qeveria tjetër, strategjia tjetër: “zero tolerancë korrupsionit”. Dhe, na zgjaten zerot dhe korrupsioni zgjatet po ashtu, me shumë zero e me një njësh, dysh, tresh, katër, pesë, gjashtë, përpara dhe bëhen miliona e miliona, të cilët të gjithë e dimë se keqpërdoren, vidhen dhe vidhen në sy të tanë, në dëshmi tonë dhe ne luftojmë kundër korrupsionit, themi: “zero tolerancë kundër korrupsionit, strategji kundër korrupsionit” dhe kështu me radhë.

S’mund të mos ndjehet njeriu keq. Ta çon mallin kjo të asaj që thoshte Çerçili, sa herë dua të mos kryhet një punë, e bëj një grup punues. Në njëfarë mënyrë këto strategjitë tona ta kujtojnë këtë farë soji të grupeve punuese që në vend se t’i rregullojnë çështjet, i trashin ato.

E të gjithë e dimë se korrupsioni është këmbëkryq në shoqërinë tonë të re dhe është në të gjitha porët, në të gjitha nivelet, në të gjitha format e saj dhe është brutal, është politik. A s’janë politike ato lojëra që janë bërë ta zëmë me zgjedhjet e me tjera? Është korrupsion dhe forma më e vrazhdë e korrupsionit, është ekonomik, është investiv, është financiar, është institucional, është edhe moral dhe është gjithkund.

Mungon vetëm lufta e drejtë, mungon tabloja reale. Dhe, mendoj këtu do të duhej vënë gisht, se është arsye për të ngritur të gjithë zërin kundër saj është edhe ajo që dëgjuam kohëve të fundit dhe s’është hera e parë.

Sot, këtu u fol për Rezolutën për Kosovën, por zonja e zotërinj, nuk bisedohen çështje të tilla në “Hajt pak”. Unë mendoj që duhet të jenë temë e veçantë në të ardhmen në këtë Kuvend, sepse edhe përkundër një avancimi në mekanizmat evropian të Kosovës, në të vërtetë raporti edhe në Asamblenë Parlamentare fillonte me konstatimin: “Kosova është në një gjendje të zymtë”, dhe e dini çka do të thotë kjo? Dhe, dy nga problemet kryesore, që u nënvizuan atje, ishin aktet e pakuptueshme, absurde të rrënimit të varrezave, për të cilat ne do të duhej ta ngrinin zërin vetë edhe më fuqishëm. Dhe, korrupsioni si shprehje

e qeverisjes sonë dhe e organizimit tonë në shoqëri, në Kosovën e re, të lirë, sovranë, demokratike e të tjera, për të cilën është derdhur aq shumë gjak, janë bërë aq shumë privacione.

Dhe, gabimi në qasjen tonë është edhe këtu evident dhe kjo më nxiti që ta marr fjalën. E përsërisim vazhdimisht atë sikur është kjo është çështje e ndarë vetëm e prokurorisë, “kush ka fakte, le të lajmërojë atje” dhe me kaq përfundon puna. Jo, zotërinj, ky është vetëm një dimension dhe ai duhet të funksionojë, madje edhe pa alarmimin tonë. Është detyrë institucionale e organeve të drejtësisë dhe ata duhet ta bëjnë punën e tyre.

E jona është që të mos lejojmë që ata të pengohen në punën e tyre. Po, ne kemi nevojë edhe për nivele të tjera të përgjegjësisë, përgjegjësia penale nuk e përjashton përgjegjësinë politike. Dhe, përgjegjësia politike te ne nuk funksionon, ose funksionon në mënyrë selektive. A ju ka ndodhur të dëgjoni fakte, që ta zëmë, ndonjë zyrtar të shkarkohet automatikisht, zyrtar shembullor me figurë të dëshmuar morale, njerëz nga më të mirët që kemi pasur edhe si ekspertë edhe si ndërtim intelektual e politik, e tjera, pse doli në media, se Asambleja Komunale paska marrë një vendim që qenka kontestuar nga dikush, kurse, në raste tjera dëgjojmë skandal pas skandali dhe nuk lëviz askush. Ç’është kjo?

Po është edhe perceptimi tjetër që e gjeni edhe këtu, edhe në shoqëri. Njëherë, kur po bisedonim për korrupsionin, përmendeshin dhuratat dhe theksohej ajo që është e vërtetë dhe nuk e dëgjova të theksohet. Korrupsioni, zotërinj, te ne është tenderët, tenderomania. Atje po plaçkitet Kosova. Po hahet shteti i Kosovës i verdhë, ende pa u bërë dhe nuk ndodh kjo askund dhe s’ka reagim të duhur, përkundrazi ka një opinion, sipas të cilit-çka, është normale, 10-përqindëshi, 20-përqindëshi, ndodh gjithkund, kurse ne dëgjojmë se ky 20-përqindëshi është rritur diku-diku në 50 e 60%, kështu më thoshte një zyrtar i një Ministrie, këto ditë.

Kush ka të drejtë të hajë shtetin e Kosovës në këtë mënyrë dhe kush ka të drejtë të fashit luftën kundër kësaj të keqeje, tamam kanceroze, tash?

Për më tepër është krijuar një opinion edhe te qytetarët, sipas të cilëve, ai zyrtar që nuk është i zoti për të vjedhur, për të zhvatur, ai nuk është i aftë, ai është qyqar, kurse ai që keqpërdor, pasurohet shpejt, ai është dikush.

Zonja e zotërinj, në këtë mënyrë nuk bëhet shteti. Ne flasim për shtetin shumë, po çka po i lëmë shtetit? Çka po u lëmë brezave të ardhshëm? A s’janë korruptive edhe këto çka po bëhet me pasuritë e Kosovës?

Prandaj, unë mendoj që ne na duhet së pari një perceptim i drejtë për këtë sëmundje, për këtë sindrom, tamam kanceroz për të ardhmen e Kosovës. Por, na duhet një strategji për strategjinë e vërtetë. Dhe, ajo strategji duhet të kthehet në program kombëtar për të luftuar këtë të keqe, duhet të kthehet në një prioritet të këtij tempulli të demokracisë.

Dhe në këtë kuptim për mua janë shumë të drejta, të mirëseardhura çdo angazhim i përbashkët, se e keqja është e përbashkët. Të gjithë kanë përzier nga pak me “Fatën”, qysh thoshte populli, prandaj edhe të gjithë duhet të marrim përgjegjësinë dhe ta luftojmë këtë të keqe bashkë, ndryshe ne do të dështojmë bashkërisht.

Nuk mund të lejojmë atë, që e thoshte Nonda Bulka: “Dënohet si hajn bariu që për hall të familjes ka mund ta marrë një qengj, por nuk dënohet ai që e merr një tufë me dele me gjithë bariun, bashkë”. E është koha, që lufta në radhë të parë të përqendrohet te përgjegjësit kryesorë që jo vetëm vetë keqpërdorin, por edhe ndikojnë që të krijohen këto perceptime, pa ndryshimin e të cilave nuk mund të shërojmë Kosovën nga kjo e keqe e madhe.

Ju faleminderit, zoti kryetar, faleminderit kolegë deputetë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti, Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Më në fund, jam paraqitur, sigurisht ndër të parët, nuk e di arsyen pse më është shtyrë deri më tash rendi, por sidokudo.

I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra të Kabinetit Qeveritar, të cilët nuk jeni në këtë sallë, e sipas mendimit tim, është dashur të jeni prezent këtu, sepse jemi duke diskutuar për një çështje shumë të rëndësishme, që është strategjia kundër korrupsionit në Kosovë e për të cilën disa prej tyre edhe kanë dhënë mjaft kontribut.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ndonëse Komisioni për Legjislacion i ka paraqitur Kuvendit rekomandimin për shqyrtimin dhe miratimin e strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për vitin 2013-2017, më duhet të theksoj se disa prej anëtarëve të Komisionit kemi qenë kundër një rekomandimi të tillë, ndër të tjera, për dy arsye. Dhe atë, arsyeja e parë është kostoja financiare për këtë strategji.

Nga dokumentacioni i paraqitur para nesh, nuk mund të krijohet asnjë pasqyrë e përafërt, se sa do t’i kushtojë shtetit kosovar implementimi praktik i këtij plani të veprimit, kështu që nuk është e qartë se a do të përfitojë apo do të shpenzojë më shumë shoqëria kosovare nga kjo strategji?

Arsyeja e dytë janë dy strategjitë e mëparshme kundër korrupsionit dhe atë, strategjia për vitet 2004-2007 dhe strategjia për periudhën 2009-2011, për të cilat ende nuk është bërë ndonjë vlerësim real se cilat kanë qenë rezultatet konkrete të tyre, a kanë pasur ndonjë efekt, të paktën minimal në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, apo thjesht janë hartuar, aprovuar dhe zbatuar vetëm, siç thotë populli “sa për sy e faqe”, apo edhe më keq, janë sajuar për t’i hedhur hi syve jo vetëm popullit, por edhe institucioneve ndërkombëtare, se kinse qeveria dhe mekanizmat e saj janë duke luftuar korrupsionin.

Duke pasur parasysh perceptimin mbi korrupsionin, pastaj korrupsionin real, por edhe rangimin sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit, për vitin 2012 të Organizatës

Transparency International, sipas të cilit Kosova gjendet në mesin e shteteve me nivel të lartë të korrupsionit, duke u renditur në vendin 105, në rang me shtetet si Gambia, Mali, Armenia, Bolivia, Meksika dhe shumë larg shteteve të rajonit si: Kroacia, e cila renditet në vendin e 62-të, Maqedonia në vendin 69. Mendoj se mirë dhe me kujdes duhet shqyrtuar hartimin dhe aprovimin e strategjive të tilla, duke u fokusuar në çështje primare se a athua strategjitë dhe planet e veprimit janë mekanizma adekuat që ndihmojnë në zgjedhjen e problemit të korrupsionit dhe luftës së suksesshme ndaj tij në rrethanat ekzistuese të shoqërisë sonë, apo ndoshta më mirë është të ndërrohet ky mekanizëm dhe të drejtohem kah organet kompetente për luftimin e krimit në përgjithësi dhe korrupsionit në veçanti, siç janë: policia, prokuroria dhe gjykatat.

Duke pasur parasysh dështimin e strategjive të mëparshme, personalisht jam kundër këtij mekanizmi, që në të kaluarën është treguar joefikas sepse:

Nën 1, është e pakuptimtë që në kohën kur aprovohen, zbatohen dhe shpenzohen me të madhe për këto strategji, vjen deri te rritja enorme e dukurisë së korrupsionit në Kosovë;

Nën 2, në një mënyrë vëllimi i madh dhe dinamika e korrupsionit në Kosovë, në disa vite të fundit do të thotë që efekti praktik i strategjive kundër korrupsionit, është tejet i vogël, apo lirisht mund të thuhet efekti i tyre është barazi me zero.

Nga kjo që u theksua më lartë mund të arrihet deri te vlerësimi tjetër se sikurse këto strategji po sajohen për vetveten e jo për të luftuar korrupsionin. Pra, është krijuar përshtypja se po aprovohen vetëm sa për t'u kryer disa veprime koti nga zyrtarët e niveleve të ndryshme dhe aktorët që implementojnë të njëjtat.

Thjesht, është krijuar bindja se këto strategji nuk po hartohen për të parandaluar dhe ndëshkuar të korruptuarit dhe se këto strategji nuk po kanë kurrfarë pike takuese me korrupsionin dhe të korruptuarit, por po paraqesin dokumente zyrtare që po mbesin si shkresa boshe në sirtarë të Qeverisë dhe të agjencive të saj dhe me të cilat Qeveria e Kosovës po arsyetohet si para qytetarëve të Kosovës, ashtu edhe para faktorit ndërkombëtar se kinse po i kryen dhe përmbush detyrat e veta në luftë kundër korrupsionit, në kohën kur korrupsioni është ulur këmbëkryq, akomoduar dhe ka gjetur strehim të rehatshëm, pikërisht në vetë Qeverinë dhe ministrinë e saj, kurse shembulli më i freskët është afera e 1,4 milionë eurove e pasaportave në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës.

Për të argumentuar vlerësimet e mësipërme për strategjinë kundër korrupsionit, unë do t'i veçoja dhe analizoja disa konstatime që janë hartuar në raportin lidhur me strategjinë e fundit 2009-2011. Kështu, në këtë raport, ndër të tjera, haset edhe ky pasus, citoj: "Sipas raportimit për periudhën tetor - dhjetor 2010, rishikimi i planit të veprimit kundër korrupsionit 2009 - 11, ka treguar një total prej 130 veprimeve, kurse institucionet përgjegjëse gjatë kësaj periudhe raportuese nuk kanë raportuar për 66 veprime, apo 50% të tyre."

Ky pasus tregon për joseriozitetin jo vetëm të institucioneve përgjegjëse lidhur me raportimin e veprimeve, por edhe për rëndësinë e vogël të strategjisë në përgjithësi. Kështu, vetvetiu shtrohet pyetja: Po, edhe sikur të raportoheshin të gjitha veprimet e planifikuara, cili është efekti praktik i tyre? Çka përfiton shoqëria kosovare nga këto raportime? A mos po bëhet më e mbrojtur nga korrupsioni apo jo?

Fatkeqësisht, bazuar në rezultatet e strategjive të mëparshme, përgjigja është jo, sepse përvojat e dhjetëvjeçarit të fundit kanë qenë të hidhura, andaj është krijuar përshtypja se me strategji kotë, me fjalë boshe dhe me deklarime të tipit zero tolerancë ndaj korrupsionit, nuk luftohet kjo dukuri, e cila është në ekspansion të vazhdueshëm në Kosovë.

Andaj, kërkoj angazhimin konkret të policisë, prokurorisë dhe të sistemit gjyqësor në zbulimin, hetimin dhe ndëshkimin e të korrumpuarve, në radhë të parë në organet e larta shtetërore, si në Qeveri, Kuvend, Presidencë e pastaj të vazhdojë në nivele tjera më të ulëta, sepse, një fjalë e urtë popullore thotë: “Peshku kalbet në krye, e jo në bisht”, e po ashtu edhe korrupsioni në Kosovë, në vëllim dhe përmasa më të mëdha gjendet në organet e larta shtetërore e më pastaj shtrihet edhe në nivele më të ulëta dhe lokale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Unë kam folur një herë, kryetar, unë kam kërkuar replikë dhe, atëherë nuk ma dhatë fjalën, kështu që veç desha t’ia sqaroj deputetit Zenun Pajaziti, se s’qenka këtu, se tha që dokumenti, është një dokument i cili ka marrë bazën nga praktikat ndërkombëtare, këtu problemi kryesor është që ky dokument nuk përputhet me realitetin e Kosovës dhe ka problem me logjikën institucionale. Dikush thotë që e ka hartuar Agjencia Kundër Korrupsionit, e ka sjellë këtu, dikush tjetër thotë që e ka hartuar Qeveria në bashkëpunim me të gjitha institucionet tjera, e një deputet tjetër i shumicës thotë që e kanë hartuar krejt institucionet ndërkombëtare bashkërisht me institucionet e Kosovës edhe e kanë prurë këtu.

E vërteta është, që ky dokument në mënyrën qysh është hartuar dhe institucionet që janë përfshirë në këtë sistem, janë gabimisht të ndërtuara dhe ky dokument nuk mund të funksionojë. Nuk mund të funksionojë, sepse nuk janë të përfshira tri institucionet kryesore: prokuroria, policia, gjykatat dhe vetë agjencia, në fund. Ky është një problem konceptual, këtë e thashë edhe në fillim, se kemi problem konceptual, problem strukturor, problem financiar dhe problem zbatues me këtë strategji.

Prandaj, kjo strategji, kjo ishte për zotin Pajaziti, është e përealizueshme dhe është një strategji e cila nuk mund të përkrahet nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, policia, prokuroria dhe gjyqësia gjithnjë e kanë obligim për t’u marrë me detyrat që i kanë edhe me Kushtetutë, edhe me ligje. Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është e tepërt prapë të thuhet që të diskutosh për një dokument të rëndësishëm, i cili është në kuadër të katër kushteve afatshkurtra që Këshilli i Ministrave të BE-së i ka bërë Kosovës në dhjetor të vitit të kaluar dhe dokument i cili në vete duhet të përmbajë strategjinë për një problem serioz që Kosova e ka në të gjitha raportet, së paku në komunikim me Komisionin Evropian janë të nënvizuara si kushte thelbësore edhe për liberalizim të vizave edhe për nënshkrim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Dokumenti është i vonuar, një dokument i vonuar ka shkaktuar luftë të vonuar dhe një luftë e vonuar kundër këtyre problemeve ka shkaktuar drejtësi të vonuar, sepse Kosova e ka kusht të qartë që për procese të integritetit duhet domosdoshmërisht shkakton rezultate të prekshme në luftë kundër korrupsionit, krimeve dhe të gjitha llojeve të krimeve dhe natyrisht, korrupsioni mbetet problem shqetësues.

Nga ky dokument, i cili fillimisht u miratua më 11 janar të vitit të kaluar, tash gati janë 13 muaj që përkundër kërkesës së Kuvendit, Qeveria nuk ka ndërhyrë për t'i plotësuar kërkesat që Kuvendi i ka rekomanduar vitin e kaluar.

Në janar të vitit 2012 i është thënë Qeverisë që dokumenti është i pamjaftueshëm për të shkaktuar rezultate të pritura në Kosovë dhe i pamjaftueshëm si dokument, i cili në vete ka edhe planin e veprimit dhe nëse lexoni e shihni që partner kryesor është Agjencia Kundër Korrupsionit, por Zyra e Kryeministrit dhe shoqëria civile e përmendën 100 herë në çdo pjesë të këtij dokumenti.

Injorimi i kërkesës së Kuvendit, detyrimisht do të duhej ne ta konfirmojmë kërkesën që ky dokument t'i plotësojë, sepse në fund të fundit agjencia është organ i Kuvendit, agjencinë e ka zgjedhur Kuvendi, agjencia i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës, këtij organi. Agjencia është e obliguar që partnerët e saj t'i ulë në tavolinë, t'i dëgjojë kërkesat e Kuvendit dhe të marrë veprim, sepse ne e dimë që nuk kompetenca ekzekutive. Kompetencat e agjencisë janë të limituara, ndërsa Qeveria është organi i vetëm ekzekutiv, që ka ndërtuar disa task-forca departamente për t'u marrë me këtë problem, por rezultatet nuk e i kemi ende në tavolinë.

Gjithçka që ka për t'u vlerësua edhe më 12 shkurt për liberalizim të vizave edhe në mars, për nënshkrimin e marrëveshjes të MSA-së, do të kërkojnë rezultatet konkrete. Nuk jam i tharë për t'u bërë shkaktar i vonësve të mëtutjeshme, por ky dokument duhet t'i kthehet Qeverisë dhe agjencia të marrë obligim që t' i përfshijë kërkesat e deputetëve dhe të Kuvendit në përgjithësi, në mënyrë që të plotësohet dhe të bëhet dokument i qartë, në mënyrë që vërtet ky proces dhe roli i Kuvendit në të ardhmen të jetë më i madh.

Këtu nuk përmendet askund dialogu për sundimin e ligjit, është mekanizëm i ri i Kosovës dhe i Komisionit Evropian, mekanizëm i cili në vete ka dy komisionarë të rëndësishëm, mekanizëm që nga Kosova janë të gjitha institucionet e përfaqësuara dhe është i përfaqësuar edhe vetë Kuvendi. Ky ka rol në këtë strategji, së paku duhet të ketë rol në

këtë strategji, në mënyrë që procesi si i tillë, të ketë qartësi më të madhe dhe roli i institucioneve të jetë i qartësuar.

Në fund, unë mendoj që ne duhet të rekomandojmë, si deputetë, meqë u përmend edhe nga deputeti Ymeri, ... si një iniciativë globale e parlamentarëve duhet të themelohet në Kuvend të Kosovës. Ai udhëhiqet nga partia opozitare, po në të cilën marrin pjesë të gjithë deputetët që kanë vullnet ta luftojnë korrupsionin. Samiti i këtij viti që po mbahet në janar në Filipine, neve na ka lënë anash për shkak që iniciativa e filluar nuk është finalizuar, por Kuvendi duhet të jetë pjesë e të gjitha mekanizmave ndërkombëtare, që e çojnë misionin një hap përpara në luftë kundër të gjitha llojeve të krimit dhe të korrupsionit që sot është shqetësimi kryesor për Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Para se t'ia jap fjalën deputetes Vjosa Osmani, unë dua t'i them veç një trikatër fjalë.

Agjencia Antikorrupsion, ajo që edhe nga ligji, por edhe nga praktika e deritashme po të shikohet, më tepër e ka një rol mediatik, se sa një rol ekzekutiv. Dhe, sigurisht që ne duhet të kërkojmë një dokument sa më përmbajtësor dhe sa më të zbatueshëm.

Por, unë mendoj që nuk është problemi i mos luftës ndaj korrupsionit, i cili është i shtrirë në të gjitha nivelet e pushtetit, prej nivelit më të ultë deri në nivelin më të lartë, pastaj në shëndetësi dhe në arsim, pothuajse në të gjitha shkallët edhe të arsimit, se për shëndetësinë të mos flasim, do të thotë, është një shtrirje, jo vetëm vertikale, por ka një shtrirje të vështirë, të rëndë edhe horizontale.

Megjithatë, këtu u dëgjuan fjalë përsëri, që ne me këtë dokument ta autorizojmë policinë kriminale, prokurorinë dhe gjyqësorin. Ne kemi Kushtetutën, i kemi ligjet, i kemi kodet penale dhe nëse këto tri institucionet më përgjegjëse, për ta luftuar korrupsionin, pastaj dhe krimin e organizuar dhe kontrabandën, sigurisht që sado e mirë dhe e bukur të jetë një strategji, është shumë vështirë për t'i luftuar këto dukuri.

Prandaj, mendoj që debati në të ardhmen duhet të zhvillohet në drejtim të funksionalizimit të institucioneve, që kanë përgjegjësi ligjore dhe kushtetuese për ta luftuar korrupsionin si një fenomen tepër i dëmshëm për shoqërinë tonë. Prandaj, po ma merr mendje që shumë po merren me strategjinë antikorrupsion, e cila edhe një herë po them, më tepër ka rol mediatik dhe për t'i nxitur institucionet që janë përgjegjëse për t'u marrë me këto dukuri, se sa një dokument që vërtet e lufton korrupsionin.

Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt, që të mos i përsëris ato që thanë, do të flas nga aspekti procedural më shumë.

Ju të gjithë e dini që është krijuar një tendencë jo e mirë, që dokumentet që Kuvendi ia kthen Qeverisë prapa, të kthehen prapë në Kuvend me përmbajtjen po të njëjtë.

Sot, u konfirmua edhe nga deputetët e partisë në pushtet që ky dokument është i njëjtë me atë që na është sjellë më herët. Mund të ketë ndryshime kozmetike, por në esencë është i njëjtë.

Dhe, Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian ka njoftuar ministren për Integritet Evropian, po ashtu edhe zotin Zhbogar, që do të jetë jashtëzakonisht vështirë një dokument i tillë, po flas këtu për këtë strategji të miratohet në Kuvend, në qoftë se nuk merren parasysh vërejtjet që deputetët i kanë dhënë në seancën e prillit të vitit 2012.

Ne e kemi parë nga dokumenti që po e shqyrtojmë, që asnjë nga këto vërejtje nuk janë marrë parasysh. Po e përmend atë që ka qenë esenciale, sidomos për LDK-n, kur i patëm paraqitur vërejtjet tona në 2012-shin.

Sfidat që paraqiten në dokument, problemet kryesore në luftën kundër korrupsionit, nuk përkojnë me objektivat e strategjisë. Objektiva numër një, shembull e kësaj strategjie është vetëdijesimi i qytetarëve dhe ngritja e besimit tek qytetarët, se kinse problemi kryesor na qenkan qytetarët e jo institucionet, që janë të zhytura në korrupsion.

Përderisa institucionet e tilla, sidomos ato që i përgjigjen Kuvendit e injorojnë çdo kërkesë të Kuvendit, çdo vërejtje të deputetëve, që është dhënë në seancën e kaluar, që ka qenë arsyeja kryesore pse nuk është miratuar, unë mendoj që thjesht për shkaqe parimore, në qoftë se s'kemi asnjë arsye tjetër, deputetët që kanë votuar kundër herën e kaluar, duhet të votojnë prapë kundër, sepse ky dokument nuk është ndryshuar dhe ky vërtet është një ofendim ndaj këtij institucioni.

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Kabineti Qeveritar,

Unë e kam pas parasysh që edhe herën e parë kur është debatuar, mungesa e tyre ka qenë po e njëjta edhe sot tregohet këtu, sepse do ta pasqyrojmë më së miri edhe në diskutimin tim, por e thanë edhe kolegët tjerë dhe të gjithë deputetët, se cili është vullneti politik dhe cili është synimi i kësaj Qeverie, për të luftuar korrupsionin, por edhe pjesën që do ta theksoj unë, krimin e organizuar.

Trajtimi i luftimit të korrupsionit në këtë lloj strategjie, që na është paraqitur për miratim jo vetëm që lë shumë për të dëshiruar, por në një formë mund të jetë edhe pengesë në luftimin e kësaj dukurie, e cila është bërë pengesa kryesore për sundimin e ligjit, stagnimin e zhvillimit ekonomik dhe deri te funksionimi i institucioneve publike.

Korrupsioni tani nuk është vetëm fenomen, të thuhet si korrupsion, por është i lidhur ngushtë me krimin e organizuar dhe kjo tregon më së miri pasurimin e disa personave si zyrtarë të lartë publikë, po ashtu edhe familjarë të tyre, që e gjithë kjo pasuri nuk është fituar ndryshe, përveç me aktivitete kriminale.

Si mund të përkrahet kjo strategji, kur nuk ka as më të voglin vullnet për ta zbatuar atë?

E para, sektorët që janë të thirrur të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, bëhen temë çdo ditë si institucione të korruptuara dhe me lloj-lloj afëra dhe vazhdojnë po të njëjtit njerëz të na shesin moral dhe atë shpeshherë në emër të luftës, por jo rrallëherë edhe në emër të gjakut të dëshmorëve.

Sot, tërë Kosovën e mbulojnë vetëm pesë prokurorë nga Prokuroria Speciale e Kosovës, të cilët janë të vetmit, apo që e kanë të vetmen kompetencë ekskluzive në luftimin e krimit të organizuar. Në faqen 24 të kësaj strategjie, në vend se të qitet si synim rritja e numrit të prokurorëve, aty thuhet përmirësimi i kapaciteteve administrative dhe teknike për luftimin e korrupsionit.

Te lidhja që bëhet mes të strategjisë dhe institucioneve që i përmenda, ministra që çdo ditë dalin me skandale të mëdha financiare, kryetarë të komunave, që dënohen për krim të organizuar, zhvatje e shantazhe dhe të cilët jo që nuk paraqiten para drejtësisë, por edhe mundohen ta pengojnë drejtësinë, deputetë që pasuria është marramendëse dhe arsyet e fitimit të saj janë shumë banale. Në polici, nepotizëm, vjedhje të dhomave të dëshmive, policë që udhëheqin kazino dhe lojëra të fatit e deri te, në mënyrë publike, pjesë e krimit të organizuar.

Prandaj, kjo strategji, jo vetëm që duhet të kthehet, por të theksohet decidivisht me detyra konkrete, luftimi i kësaj dukurie negative.

Unë po i them edhe kolegut Pajaziti, se logjika e Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk është vetëm fjalimet politike, sepse ne këtu flasim politikisht dhe bëjmë politikë. Por dallimi është se ne nuk dëshirojmë që t'i politizojmë institucionet e pavarura, siç janë: prokuroria, gjyqësia, policia, shërbimi i inteligjencës, e tutje. Ky është dallimi, që neve sot na bën, prandaj, edhe për atë arsye këtu jemi të thirrur me votën e qytetarëve, që të flasim politikisht.

Unë po e përfundoj në vazhden e fjalëve të urta popullore: “Korrupsioni është si plehër”, atë duhet ta largojmë çdo ditë, ose përndryshe ajo erë do të na kundërmojë, ose njerëzit të cilët e kanë edhe e zbatojnë atë.. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po, Eqremi tha: “mos m’i tremb mizat”. Zenun, urdhëro, për replikë.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është mirë që të kemi mundësi që sa më shumë të bëjmë debat për zbatimin e ligjit në Kosovë dhe për luftimin e korrupsionit, si brengë e gjithë shoqërisë tonë, në të gjitha fushat, në forma të ndryshme dhe është mirë që bisedohet edhe në Parlament.

Po, mendoj që sot duhet të jemi më të fokusuar se e kemi një dokument, i cili duhet të aprovohet, është nxjerrë para nesh për t’u aprovuar ose jo, një dokument i cili ka për

synim t'i koordinojë të gjitha aktivitetet e shoqërisë sonë edhe institucioneve në këtë drejtim.

Nëse është krejt e pasaktë, nëse themi që nuk është ndryshuar dokumenti esencialisht, por ka ndryshime, është po ashtu e pasaktë, bile më shumë se e pasaktë, nëse flitet e nuk lexohet dokumenti. Shikoni, në planin e veprimit, në shtyllën e parafundit dhe i keni veprimet për organet e drejtësisë, Arben, edhe për policinë edhe për institucionet e drejtësisë, Po ta jap mundësinë edhe për replikë.

Kemi një varg aktivitete në plan të veprimit, që janë të bazuara në këtë strategji, për t'i zbatuar këto institucione. Hajde ta marrim përgjegjësinë bashkërisht, që si Kuvend të kërkojmë llogari për zbatimin e këtyre veprimeve! Hajde të marrim përgjegjësi si deputetë, të shtojmë veprime këtu konkrete!

Më lejoni, m'i tregoni ju cilat janë ato kërkesa me shkrim, që i keni pasur për t'i shtuar në këtë strategji, në mënyrë që dokumenti ynë të jetë edhe të mos e kemi edhe si vërejtje nga Komisioni Evropian.

Unë i kuptoj kolegët deputetë, që në mënyrë parimore nuk pajtohen, në princip me këtë punë, për mënyrën krejt se si duhet qasur kësaj lufte, por ne të tjerët, që kemi qenë pjesë e këtij veprimi, këtij angazhimi për disa vjet, mendoj që duhet t'i marrim përgjegjësitë tona dhe të ecim më tutje, t'ju hapim rrugë institucioneve për zbatimin e politikave në luftën kundër korrupsionit.

KRYETARI: Replikë e pate Arben. U kryen replikat. Do të thotë, debati është përfunduar. Të pranishëm janë 79 deputetë.

Jemi në procedurën e votimit. Fjalën e ka nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar, Meqë ishte një diskutim, që unë e konsideroj me përmbajtje edhe bile, kisha thënë në kuptimin politik, mjaft neutral, duke u përpjekur ta shohë fenomenin.

Por, megjithatë kemi pasur disa propozime, nuk është mirë të kalohet shpejtë mbi ato propozime. A ka mundësi Komisioni për Integritet, Komisioni i Ligjeve, të rimerren me këtë tekst në ditët e ardhshme dhe të mos ngutemi ta kalojmë këtë tekst? Nëse ka mundësi e unë e di, që ka mundësi, me propozimet që kanë dalë sot në Kuvend, që të plotësohet, të bëhet jo vetëm më i aplikueshëm, por edhe më i pranueshëm për normat ose standardet, për të cilat po e bëjmë.

Kjo mund të bëhet. Unë mendoj që kjo mund të bëhet, sepse nuk e kemi sot ditën e fundit, ose ditën e kiametit. Nëse do të vlerësohet në gjysmën e frorit, në rregull, po deri te gjysma e frorit, ky Kuvend do të punojë dhe ky tekst mund të vijë më i plotësuar që të votohet.

Ky është mendimi im, përndryshe, krejt diskutimi na shkon i kotë. Faleminderit!

KRYETARI: Zenun, e ke kërkuar fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Po, mendoj që pas këtij debati, pas kësaj mënyre se si u zhvillua debati, mendoj që duhet të konsultohen edhe procedurat, ju i dini më mirë, po duhet t'i jepet një shans që të inkorporohen këto që janë si vërejtje ose si propozime, në mënyrë që sa më shpejtë këtë dokument ta kemi të aprovuar.

Pra, unë pajtohem plotësisht me zotin Hamiti. Mendoj edhe si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, edhe t'u japim mundësi edhe komisioneve, që sa më shpejtë ta trajtojnë edhe njëherë.

KRYETARI: Cili është mendimi i Komisionit FunkSIONAL? Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Kryetar,

Pas shumë vuajtjeve dhe kërkesave, më në fund po ma jep fjalën, por problemi është te konsultimi me palë të interesit. Në këtë rast thatë ju, që duhet konsultuar dhe të shihen edhe projektet edhe masat dhe veprimet, të cilat i marrin palët me interes. Në këtë rast palët me interes janë Policia e Kosovës, janë prokuroritë e Kosovës, speciale e të rregullta, janë gjykatat e Kosovës, është task-forca kundër korrupsionit. Krejt këto elemente duhet involvuar, prandaj, zgjidhja do të ishte, që ta kthejmë në Qeveri, që të involvohen të gjitha këto struktura dhe t'i jepet mundësia që sa më shpejtë të kthehet.

Nëse e merr vetë Kuvendi në pronësi, hapet një fushë krejt tjetër dhe nuk mundet të kryhet puna shpejtë, kështu që, zgjidhjen e këtyre problemeve duhet ta bëjë Qeveria. Prandaj, unë mendoj që duhet t'i kërkohet, t'i kthehet Qeverisë dhe Qeveria në kohën sa më të shpejtë t'i konsultojë palët me interes, t'i japë vërejtjet, t'i marrë edhe vërejtjet e Kuvendit dhe të ofrojë një plan dhe strategji efikase, e cila duhet të jetë e zbatueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk e dëgjove hiç nënkryetarin e Kuvendit nga partia jote. Deputeti Behar Selimi e ka fjalën.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë po e përsëris, këtë dokument s'e ka shkruar Qeveria, prandaj s'kemi çka ia kthejmë Qeverisë. Ky dokument ka kaluar nëpër Qeveri dhe ka ardhur te ne.

Megjithatë, meqë dosja deputetë e thanë shprehimisht, se disa veprime apo edhe objektiva nuk janë përfshirë në dokument, veprime dhe objektiva të cilat janë përmend në debatin e kaluar, edhe unë do të isha akorduar që deri në seancën e radhës, Komisioni FunkSIONAL që është Komisioni për Legjislacion, në konsultim edhe me komisionet tjera, sidomos për Integritet Evropian edhe për Politikë të Jashtme, nuk prishë punë, i shtojmë edhe këto aksione, këto veprime, të cilat mungojnë, e përpunojmë nëse ka nevojë edhe gjuhën teknikisht edhe në aspektin juridik dhe politik, meqë është dokument politik ç'është e vërteta dhe vijmë këtu dhe e votojmë me shumicë. Kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, të mbetet kështu siç tha nënkryetari i Komisionit FunkSIONAL. Deri në seancën e radhës komisionet le të punojnë dhe le ta shikojnë edhe debatin që është zhvilluar dhe mbi bazën e debatit, le të na e sjellin dokumentin në seancën e radhës për miratim.

Dhe, tani po e mbyllim këtu për pauzë. E vazhdojmë seancën në orën 15:00!

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes pasdite)

KRYETARI: Po fillojmë. Në sallë i kemi 61 deputetë. Është pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media e ka shqyrtuar nominimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit ad hoc, deputetin Behar Selimi, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë zgjedhjen e 2 anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media me votim të fshehtë.

Për 1 anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radha e komunitetit shumicë shqiptar propozohen kandidatët, si në vijim:

- Luljeta Vuniqi dhe
- Safete Rugova.

Kuvendi prej 2 kandidatëve e zgjedh një anëtar të Këshillit të KPM-së. Pra, nga këta 2, njëri prej tyre votohet.

Nën 2, për një anëtar të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit serb propozohen kandidatët, si në vijim:

- Milosav Saviq dhe
- Vesna Jovanoviq.

Prej 2 kandidatëve, Kuvendi e zgjedh njërin nga këta anëtarë të propozuar.

A r s y e t i m:

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, pas intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, i propozon Kuvendit emërimin e 2 anëtarëve të Këshillit.

Anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të nenit 13 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Mandati i anëtarëve të KPM-së caktohet me short: 2 anëtarë me mandat dyvjeçar; 3 anëtarë me mandat trevjeçar dhe 2 anëtarë me mandat katërvjeçar.

Shorti për mandatin e anëtarëve të KPM-së është bërë pas zgjedhjes së 5 anëtarëve të KPM-së, më 30 gusht 2012.

Pas tërheqjes së shortit për mandatin e anëtarëve të KPM-së kanë mbetur dy pozita për mandat trevjeçar. Andaj, mandati i 2 anëtarëve është trevjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj se i keni informacionet e duhura se çfarë kërkohet. Atëherë, i ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga 1 anëtar për Komisionin votues.

Partia Demokratike, kë e propozon? Behar?

BEHAR SELIMI: E propozojmë Nijazi Idrizin.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike? Deputeti, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit kryetar!

Ne e propozojmë Sali Morinën, e nëse më lejon e kam edhe një propozim - të shkojmë me një votim, t'i kryejmë të dy votimet njëkohësisht. Mendoj se nuk prish kurrgjë punë, propozohet edhe për pikën tjetër dhe mund t'i votojmë të dyja.

KRYETARI: Mirë. Propozoni anëtarët e komisionit dhe pastaj vazhdojmë. Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje", Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Kryetar, ne e propozojmë Albana Gashin.

KRYETARI: Aleanca? Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Kymete Bajraktari, për anëtare të komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re? Deputetja Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Ne e propozojmë Jeton Svircën.

KRYETARI: Faleminderit! SLS, nuk është. Grupi “6+?”. Mirë, Fikrim Damka.

Atëherë, do të votojmë përnjëherë edhe për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës e ka shqyrtuar nominimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit ad hoc, deputeten Xhevahire Izmaku, që ta arsyetojë rekomandimin para deputetëve të Kuvendit.

Xhevahirja mungon. A ka zëvendës? Deputeti Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Natyrisht se nuk jam zëvendës i Xhevahires, por unë propozoj që këto dy pika megjithatë të mos votohen së bashku. I vetmi fakt pse e bëj këtë, pasi po e shoh se gjysma e sallës është e zbrazët, e ndoshta do të vijnë edhe tjerët, kështu që Bordin e RTK-së ta votojmë veçmas.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Urdhëro, Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit! Në bazë të nenit 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në mbledhjen e mbajtur më 19 dhe 20.12.2012, pas shqyrtimit të biografive dhe të intervistimit të të gjithë kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, vendosi që Kuvendit t’i paraqesë këtë rekomandim:

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e 4 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehtë.

Për tri pozita për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar propozohen për votim 6 kandidatë, si në vijim:

- Besa Bytyqi;
- Blerta Zeqiri;
- Faton Mehmetaj;
- Ibrahim Kadriu;
- Murat Musliu dhe
- Mustafë ë Halili.

Kuvendi bën përzgjedhjen e 3 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga 6 të propozuar.

Për një pozitë të anëtarit të Bordit nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë, propozohen për votim 2 kandidatë, si në vijim:

- Elif Tokmak dhe
- Mehdiülki Cibo.

Kuvendi bën përzgjedhjen e 1 anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga dy të propozuar.

KRYETARI: Faleminderit! Ju lutem, sa janë të pranishëm? Faleminderit! Atëherë, konsideroj se janë plotësuar kushtet që anëtarët e komisionit t'i zënë vendet e tyre.

Të pranishëm janë 68 deputetë.

(Ndërhyrje)

Po, i votojmë njëkohësisht të dy listat, edhe për Komisionin e Pavarur të Mediave, edhe për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës.

SLS-ja, 1 anëtar të Komisionit?

Atëherë, Milivoje Stojanoviq është anëtar i Komisionit.

Komisioni është komplet dhe mund të fillojmë votimin.

Adem Grabovci, Afërditë Berisha-Shaqiri; Afrim Hoti; Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi; Agim Kuleta, Ahmet Isufi; Albana Fetoshi, Albana Gashi; Albin Kurti, Albulena Haxhiu; Ali Sadriu, Albert Kinolli; Alma Lama, Anton Çuni; Arben Gashi, Ardian Gjini; Armend Zemaj, Aurora Bakalli; Azem Syla, Bahri Thaçi; Arsim Bajrami, Bahri Muharremi; Berat Buzhala, Behar Selimi; Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu; Biserka Kostiq, Blerim Shala; Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani; Danush Ademi; Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi; Duda Balje; Elmi Reçica; Emilija Rexhepi; Enis Kervan; Nait Hasani, Eqrem Kryeziu; Etem Arifi, Fadil Demaku; Fatmir Xhelili; Jeton Svirca; Flora Brovina, Florin Krasniqi; Ganimete Musliu, Glauk Konjufca; Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi; Haki Demolli, Halit Krasniqi; Hamza Balje, Hydajet Hyseni; Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi; Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi; Idriz Vehapi; Imri Ahmeti; Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi; Jasmina Zhivkoviç; Jelena Bontiq; Justina Pula; Kymete Bajraktari; Latif Gashi; Liburn Aliu; Lirije Kajtazi...

(Ndërprerje e incizimit)

...Lumnije Morina, Lutfi Haziri; Lutfi Zharku, Fikrim Damka; Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu; Mufera Shinik, Muhamet Mustafa; Mursel Haljilji, Myzejene Selmani; Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyqi, Sasha Millosavljeviç, Petar Miletqi, Rada Trajkoviq, Rame Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadergjonaj, Sale Berisha-

Shala, Sali Asllanaj, Salih Morina, Salije Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviq, Sretan Ivanoviq, Teuta Haxhiu; Teuta Sahatqija; Time Kadrijaj; Ukë Rugova; Vesimir Saviq; Vesna Mikiq; Visar Ymeri...

(Ndërprerje e incizimit)

...Vjollca Krasniqi; Vjollca Osmani; Valbona Dibra; Xhavit Halaiti; Xhevahire Izmak; Xhevdet Naziraj dhe Zenun Pajaziti.

Jo, unë i kam ftuar.

NIJAZI IDRIZI: Të nderuar deputetë, atëherë fillojmë me numërimin e votave të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media:

Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, e pavlefshme, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Miroslav Saviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Vesna Jovanoviq, e pavlefshme, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, e pavlefshme, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna, Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Miroslav Saviq, Luljeta Vuniqi, Miroslav Saviq, e pavlefshme, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, e pavlefshme, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Miroslav Saviq, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Miroslav Saviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Miroslav Saviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Luljeta Vuniqi, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Luljeta Vuniqi, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, e pavlefshme, Luljeta Vuniqi, Miroslav Saviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Luljeta Vuniqi, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Safete Rugova, Vesna Jovanoviq, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Miroslav Saviq, Luljeta Vuniqi, Vesna Jovanoviq, Safete Rugova, Safete Rugova.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Për Komisionin, ju njoftoj se në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, Kuvendi duhet t'i zgjedhë dy anëtarë me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë me votim të fshehtë, si në vijim. Kjo kërkohet kështu me ligj. Nëse kandidatët kanë marrë më shumë se gjysmën e votave të deputetëve që kanë votuar zgjidhen, nëse jo përsëritet.

Nijazi Idrizi e shpall rezultatin e votimit për Komisionin e Pavarur të Medieve.

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar,
Të nderuar deputetë,
Komisioni votues për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media e ka nxjerrë këtë raport.

Në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendimin e Kuvendit më 24 janar 2013, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, Nijazi Idrizi, PDK; Salih Morina, LDK; Albana Gashi, "Vetëvendosje"; Kymete Bajrami, AAK; Jeton Svirca, AKR; Milivoje Stojanoviq, SLS dhe Fikrim Damka, Grupi "6+".

Komisioni votues pas procedurës së votimit fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, në mbledhjen plenare të mbajtur sot, më 24 janar 2013, konstaton: Në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë, të pavlefshme i kemi 6 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë janë si në vijim:

- Luljeta Vuniqi ka fituar 35 vota,
- Safete Rugova ka fituar 37 vota,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komunitetit serb janë, si në vijim:

- Mirolsav Saviq ka fituar 9 vota,
- Vesna Jovanoviq ka fituar 54 vota,

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të neni 51 të Rregullores së Kuvendit konstatohet se Vesna Jovanoviq ka fituar, është përzgjedhur.

Ndërsa për kandidatët të tjerë, votimi duhet të përsëritet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shkojmë me Bordin e Radiotelevizionit.

(Ndërprerje e incizimit)

SALIH ASLLANAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po fillojmë me numërimin e votave për Bordin e RTK-së. Albana, a mund të fillojmë?

Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Elif Tokmak, Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Murat Musliu, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Mehdiülkë Cibo, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Ibrahim Kadriu, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Blerta Zeqiri, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak, Ibrahim Kadriu, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Mustafë Halili, Besa Bytyqi, Murat Musliu, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Murat Musliu, Mustafë Halili, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Murat Musliu, Elif Tokmak, Blerta Zeqiri, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mehdiülkë Cibo, Murat Musliu, Elif Tokmak, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zefiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Murat Musliu, Mehdiülkë Cibo, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Murat Musliu, Elif Tokmak, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo, Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Faton

Mehmetaj, Mehdiülk1 Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Murat Musliu, Mehdiülk1 Cibo, Besa Bytyqi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia!

Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülk1 Cibo, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülk1 Cibo, Blerta Zeqiri, Ibrahim Kadriu, Mehdiülk1 Cibo, Faton Mehmetaj, Mehdiülk1 Cibo, Faton Mehmetaj, Mehdiülk1 Cibo, Blerta Zeqiri, Mehdiülk1 Cibo, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülk1 Cibo, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Mehdiülk1 Cibo, Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülk1 Cibo, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülk1 Cibo, Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülk1 Cibo.

(Ndërprerje e incizimit)

NIJAZI IDRIZI: nderuari kryetar,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj të jua lexoj raportin e të njëjtit Komision, i cili është hartuar në bazë të njëjtës bazë ligjore, nga i cili ne kemi konstatuar se në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë, të pavlefshme nuk ka pasur, ndërsa votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komuniteteve shumicë shqiptare janë, si në vijim:

- Besa Bytyqi 59,
- Blerta Zeqiri 38,
- Faton Mehmeti 41,
- Ibrahim Kadriu 17,
- Murat Musliu 23 dhe
- Mustafë Halili 29 vota.

Ndërsa votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komuniteteve tjera joshumicë janë, si në vijim:

- Elif Tokmak ka fituar 35 vota,
- Mehdiülk1 Cibo ka fituar 38 vota,

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit 04/L-46 të Radiotelevizionit të Kosovës dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Besa Bytyqi është kandidatja që ka fituar në këtë proces, ndërsa për të gjithë kandidatët tjerë votimi përsëritet. Faleminderit!

(Reagime)

Në bazë të rezultateve që i kam këtu, janë 41 votues që kanë votuar për Faton Mehmetajn. Atëherë rezultati mund të verifikohet.

KRYETARI: Ju lutem, numëroji edhe një herë. Me 44 shkon. Përsëritet numërimi edhe një herë, dhe mos u ngut shumë. Numërimi edhe një herë, tani këqyrim për votim më vonë.

(Reagime)

NIJAZI IDRIZI: Ata po kërkojnë rinumërim edhe një herë.

KRYETARI: Ju lutem shkojmë në rinumërim për saktësi. Shkojmë në rinumërim dhe rinumërimi e tregon saktë dhe qartë rezultatin e votimit. Dëgjoni! E keni anëtarin e Komisionit këtu. Nuk është tendencioz. Edhe te ne këtu, që e kemi bërë numërimin, është 44. Po, 44 është. Megjithatë, ata kanë thënë 41. E rinumërojmë edhe njëherë rezultatin e votimit!

NIJAZI IDRIZI: Atëherë, për shkak të korrektësisë, po e fillojmë edhe një herë numërimin e votave për Bordin e RTK-së.

Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkı Cibo...

KRYETARI: Deputetët tjerë nuk përzihen në votim. Ju lutem, e kemi Komisionin. Këtu janë fletët.

(Dëgjohet debat nga salla)

Arben, 85 votues janë. Nëse dalin më shumë se 85, ke të drejtë të flasësh. Mos i paragjyko gjërat, të lutem!

NIJAZI IDRIZI: ...Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkı Cibo...

KRYETARI: Më ngadalë!

NIJAZI IDRIZI: ...Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Elif Tokmak; Blerta Zeqiri, Mehdiülkı Cibo; Faton Mehmetaj, Mehdiülkı Cibo; Blerta Zeqiri, Ibrahim Kadriu, Mehdiülkı Cibo; Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Murat Musliu, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mehdiülkı Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu; Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu; Faton Mehmetaj, Mehdiülkı Cibo;

Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Murat Musliu, Elif Tokmak; Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak; Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Murat Musliu, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak; Murat Musliu, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Murat Musliu, Elif Tokmak; Blerta Zeqiri, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Murat Musliu, Elif Tokmak; Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Murat Musliu, Mustafë Halili; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Murat Musliu, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Mustafë Halili; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Ibrahim Kadriu, Mehdiülkë Cibo; Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak; Blerta Zeqiri, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Ibrahim Kadriu, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu; Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Faton Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Murat Musliu, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo; Murat Musliu; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Mehdiülkë Cibo; Faton Mehmetaj, Ibrahim Kadriu, Mustafë Halili, Elif Tokmak; Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Blerta Zeqiri, Faton Mehmetaj, Mehdiülkë Cibo; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Murat Musliu, Elif Tokmak; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Elif Tokmak; Blerta Zeqiri, Mustafë Halili; Besa Bytyqi, Faton Mehmetaj, Mustafë Halili, Elif Tokmak.

(Ndërprerje e incizimit)

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar,
Të nderuar deputetë,

Në fakt, rinumërimi i votave e nxori në pah edhe gabimin e bërë nga Komisioni. Edhe Fatonin e kemi njeriun që ka kaluar. Ai i ka 44 vota. Pra, Faton Mehmetaj dhe Besa Bytyqi. Ndërsa për kandidatët tjerë, rivotimi duhet të përsëritet në një proces tjetër.

KRYETARI: Ju lutem. Jepi votat në përgjithësi për secilin kandidat edhe njëherë.

NIJAZI IDRIZI: Atëherë, rezultati është si vijon:

Besa Bytyqi 59 vota,
Blerta Zeqiri 39 vota,
Faton Mehmeti 44,
Ibrahim Kadriu 17,
Murat Musliu 23 dhe
Mustafë Halili 31.

Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, rezultati i votimit për Bordin e Radiotelevizionit është kështu:

Besa Bytyqi i ka fituar 59 vota,
Blerta Zeqiri i ka fituar 39 vota,
Faton Mehmetaj ka fituar 44 vota,
Ibrahim Kadriu i ka fituar 17 vota,
Murat Musliu i ka fituar 23 vota dhe
Mustafë Halili i ka fituar 31 vota.

Ky është rezultati. Pra, shkojnë kandidatja Besa Bytyqi dhe Faton Mehmetaj. Pastaj Elif Tokmak ka fituar 36 vota dhe Mehdiülki Cibo ka fituar 38 vota.

Do të thotë, votimi përsëritet për një kandidat shqiptar për Bordin e Radiotelevizionit dhe për kandidatin e komunitetit turk. Kështu që tani... Urdhëro!

(Ndërhyrje, Sabri Hamiti: Sqaro, tash dy kanë kaluar. Te shqiptarët zgjidhet vetëm edhe një. Duhet të ketë konkurrencë. Dy kandidatët me më së shumti vota...)

Po, dy kandidatët me më së shumti vota janë: Blerta Zeqiri dhe Mustafë Halili.

Këta shkojnë edhe një herë. Por tani kemi 49 deputetë, e nuk kemi kuorum. E vazhdojmë nesër në orën 10:00.

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, bjeri ziles për të ardhur deputetët në seancë.

(Ndërprerje e incizimit)

Ne e vazhdojmë nesër seancën, e për vlefshmërinë ose jo vendos seanca.

(Vazhdimi i mbledhjes plenare më 25.1.2013)
(Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete,
Zotërinj deputetë,
Ju lus t'i zini vendet tuaja dhe të fillojmë me vazhdimin e seancës së ndërprerë dje.

Siç e dini, gjatë votimit të djeshëm nuk është votuar e tërë lista. Në drejtim të kryetarit kanë ardhur propozime të ndryshme, domethënë ka pasur propozime që të përsëritet votimi, të vazhdohet votimi dhe realisht është çështje e seancës si do të vendosë: ta përsëritim votimin, ta vazhdojmë votimin aty ku ka mbetur, sepse interpretim juridik të saktë, në këtë rast, Rregullorja nuk jep për këto çështje dhe unë nuk jam në gjendje të vendos sipas përshkrimeve në Rregullore. Mendoj që të aplikohen vendimet e Rregullores për institucionet e larta, siç është zgjedhja e Presidentit e të tjera, është muhabet i gjatë.

Prandaj, kisha kërkuar që grupet parlamentare të deklarohen lidhur me vazhdimin e seancës dhe si të procedojmë, domethënë ta vendosim bashkërisht me votim të përbashkët; a do ta përsëritim krejt votimin apo do të vazhdojmë ta konsiderojmë pjesën e mbetur dje, domethënë dy të deklaruar, por në rrethana kur në sallë s'ka pasur kuorum dhe dy të pazgjedhur. Faleminderit!

Në emër të PDK-së është paraqitur Adem Grabovci, me kartelën e Latif Gashit.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, nënkryetar!
Grupi Parlamentar ka mbajtur takim dhe e ka bërë një analizë të votimit të djeshëm. Kemi ardhur në përfundim se është e domosdoshme që ky votim të përsëritet në tërësi, por meqë ende ka paqartësi, si po thuhet edhe këtu nga ju, që me të drejtë e theksoni atë, ne si grup parlamentar kërkojmë që seanca të shtyhet për javën e ardhshme, derisa Administrata t'i sqarojë të gjitha problemet që ka ndodhur gjatë votimit të djeshëm.

Unë kërkoj nga gjithë kolegët që ta marrin procesverbalin e votimit të djeshëm. Mendoj që është një element i mjaftueshëm për ta përsëritur këtë votim dhe konstatohet se kudo dhe kushdo ka të drejtë të na e anulojë votimin e djeshëm si të parregullt.

Prandaj, për të mos bërë ndonjë gabim, unë kisha kërkuar mirëkuptim nga të gjithë kolegët që ta shtyjmë seancën dhe të sqarohet çështja e këtij votimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Me sa ju kuptova, ju i keni dy kërkesa. Një kërkesë që të shtyhet seanca dhe një kërkesë që votimi i djeshëm të shpallet i pavlefshëm. A është kështu?

Regjia, zotit Grabovci fjalën.

ADEM GRABOVCI: Unë kërkoj që Sekretarisë, Administratës së Parlamentit t'i jepet kohë t'i sqarojë të gjitha procedurat e djeshme dhe në seancën e radhës të na japë një informatë të saktë se si duhet të procedojmë, edhe pse ne si grup parlamentar jemi të bindur se ka shkelje të rënda që e hedhin poshtë si të parregullt votimin e djeshëm.

KRYESUESI: Atëherë, unë dua të sqaroj: Administrata nuk e ka këtë kompetencë. Ky është vendim që duhet ta marrim ne, e jo Administrata, e kërkesa tjetër është diçka e natyrës krejt tjetër.

Zot Gjini e ka kërkuar fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E kam kërkuar fjalën sepse mendova që do të flasin edhe shefat tjerë të grupeve. Sidoqoftë, unë po flas në emër të grupit. I kemi dy çështje, çështja e shtyrjes së seancës është diçka mund të diskutohet ndërmjet deputetëve dhe shefave të grupeve. Mirëpo, po duket se me të vërtetë kemi nevojë për sqarim për atë që ka ndodhur dje. Ajo mënyra se si ne e kuptojmë atë që ka ndodhur është se Kuvendi i ka hedhur votat në kuti.

Ne jemi në të njëjtën seancë, ajo nuk ka përfunduar. Meqenëse ne e kemi mundësinë edhe ligjore, edhe në bazë të Rregullores së Punës, që seanca të zgjasë më shumë se një ditë, do të thotë se nuk ka përfunduar midis votimit, që do të thotë jemi në të njëjtën seancë.

Çështja tjetër është se kuorumin e bëjnë votat në kuti. Nëse në kutinë e votimit ka pasur më shumë se 60 fletëvotime, ka pasur kuorum. Kuorumi nuk përcaktohet me numrin e deputetëve në sallë pasi të jetë kryer votimi.

Mirëpo, nëse grupet parlamentare mendojnë se ende kemi dilemë, ne nuk do të shkaktojmë diçka, që do të dilte jashtë kornizave të këtij Kuvendi. Por, mendoj se po hyjmë në rrugë, të cilat nuk janë të nevojshme për Kuvendin. Një votim ka ndodhur, votat në kuti janë hedhur, procedurat e votimit janë tepër të qarta. Ata që zgjidhen në votim janë të zgjedhur, ndërsa për të tjerët që nuk janë zgjedhur mund të përsëritet votimi. Kështu kemi votuar gjithmonë.

Sidoqoftë, qëndrimi i Aleancës është që nëse duam ta shtyjmë seancën sot, nëse grupet parlamentare pajtohen, një gjë të tillë mund ta bëjmë. Mirëpo, për çështje të votimit po duket që kemi hyrë në një rrugë, e cila nuk na është dashur fare në Kuvendin e Kosovës. Ne mendojmë se votimet që kanë ndodhur me më tepër se 60 vota në kuti duhet të jenë të vlefshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, në emër të LDK-së, apo personalisht. Partitë le të deklarohen, drejtuesit e grupeve, ose në emër të grupeve një herë, pastaj individualisht, ke të drejtë edhe për atë. Zoti Hamiti, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues i mbledhjes, zoti Haliti,

Ne vazhdojmë aty ky kemi mbetur mbrëmë me logjikën tonë. Ne kemi thënë që edhe mbrëmë nuk është dashur të ndërpritet mbledhja, sepse kemi hyrë në një procedurë të

votimit. Pa marrë parasysh që çdo procedurë votimi kur ka më shumë kandidatë dhe mundësi që të votohet disa herë i ka etapat e veta, ne kemi konsideruar që ka qenë shumë më në rregull të vazhdohet me këtë votim që mbrëmë.

Natyrisht, kryesuesi i mbledhjes, kryetari i Kuvendit, Krasniqi, nuk ka pasur mundësi ta vazhdojë pikën e rendit të ditës, se ne jemi në mes një pike të rendit të ditës të votimit për shkak se kanë munguar shumica e deputetëve në Kuvend. Pra, mbledhja është shtyrë, në të vërtetë është ndërprerë për të vazhduar sot, meqë nuk ka pasur deputetë - kuorum - për të votuar. Edhe një herë po them: nuk ka arsye të shtyhet, sepse mbledhja është në mes. Nuk është kryer krejt asgjë. Kështu që sot çka të shtyjme? Një gjysmë pike të rendit të ditës, apo çka? Ne sot jemi në proces të votimeve dhe unë mendoj që mbledhja nuk duhet të shtyhet. Të gjithë deputetët janë këtu, prandaj nuk ka arsye. Kjo është punë që bëhet teknikisht. Unë konsideroj, dhe këtu pajtohem me Gjinin, që çdo shtyrje dhe çdo interpretim mbi interpretim vetëm do të krijojë konfuzion dhe nuk do të sqarojë ama bash asgjë.

Kështu që unë mendoj që ne të vazhdojmë aty ku jemi. Të vazhdojmë tutje, sepse nuk ka arsye që të shtyhet mbledhja. Nuk prodhon kurrfarë qartësie. Qartësitë janë ato që kanë qenë.

KRYESUESI: Jo, unë desha vetëm të sqaroj ose ta përsëris atë që e kërkoi edhe kryetari i Grupit Parlamentar. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së e kishte kërkesën që votimi të shtyhet për interpretim sipas Rregullores dhe Kushtetutës dhe kërkesa tjetër që të shtyhet seanca, të mos mbahet sot, por javën e ardhshme, për shkak të angazhimeve partiake.

Të dyja grupet parlamentare, edhe AAK-ja, edhe LDK-ja, u deklaruar që jeni për ta vazhduar votimin në pjesën ku kemi mbetur. Dhe çështja e shtyrjes së seancës është një çështje tjetër, për të cilën duhet të marrim vendim të përbashkët.

Zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Mendoj që së pari duhet ta kemi të qartë një gjë. Nuk mund të kërkohet çfarëdo shtyrje e seancës, apo çka do tjetër në mes të një rendi të ditës ndryshimi i tij, anulimi i tij, e kështu me radhë. Pra, kjo nuk duhet të lejohet, me gjithë dëshirën e disave për ta bërë një gjë të tillë.

Kërkesa për ta shtyrë seancën nuk është e sotme. Ne e kemi pasur këtë edhe të mërkurën në mbledhjen e Kryesisë, e as Kryesia nuk e ka pranuar këtë shtyrje të seancës në tërësi. Edhe tash nuk mendoj që Kuvendi duhet ta lejojë një gjë të tillë, për shkak se, siç u tha këtu edhe nga parafolësit, jemi në mes të një procesi të votimit, i cili nuk mundi të vazhdojë dje për shkak të papërgjegjësisë së deputetëve të pozitës, në këtë rast, e veçanërisht të Grupit Parlamentar PDK-së, të cilët nuk rrinin në sallë. Pra, ta kemi të qartë këtë që dje nuk ka mundur të përfundojë kjo seancë për shkak se nuk kanë ardhur

deputetë e pozitës dhe sot të njëjtut po kërkojnë të shtyhet një javë tjetër. Pra, agjendën e Kuvendit nuk mund t'ia përshtatim agjendës partiake, e cilado qoftë ajo parti.

Çështja tjetër që ka të bëjë me zgjedhjen e djeshme, se u dëgjua këtu nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, që këta mendojnë që ka parregullsi, kurrfarë parregullsie nuk ka pasur. Domethënë, dje votimi ka shkuar deri në momentin sa ka mundur të vazhdojë sipas rregullave. Kuorumi ka qenë në sallë, deputetët kanë votuar, 85 sish, domethënë edhe për Bordin e Komisionit të Pavarur për Media, edhe për atë të RTK-së, dhe prej kësaj kanë dalë dy kandidatë për Bordin e RTK-së, të cilët i fituan votat e mjaftueshme dhe u morën vesh që procesin e votimit ta vazhdojnë. Ne insistojmë që ky proces i votimit të vazhdohet sot aty ku ka mbetur dje, e jo as të shtyhet, e as të anulohet.

Dhe një çështje tjetër që lidhet me këtë është që mbrëmë e keni parë që Bordin e RTK-së, ata anëtarë që tashmë janë të zgjedhur, e kanë marrë një vendim dhe e kanë lëshuar një komunikatë për zgjedhjen e drejtorit. Ne konsiderojmë që kjo zgjedhje e drejtorit është jolegjitime dhe e papranueshme për shkak se në momentin kur votohej këtu për Bordin e RTK-së, pra për kompletimin e tij me të gjithë anëtarët e nevojshëm, anëtarët tjerë mbledhen shpejt e shpejt, marrin vendim dhe e zgjedhin Mentor Shalën drejtor të RTK-së. Kjo zgjedhje e tij ne konsiderojmë që është absolutisht e papranueshme për shkak se është dashur që ai të zgjidhet në kushtet kur bordi tashmë është i kompletuar, e jo të bëhet kështu një kontrabandim i llojit të veçantë, siç po e shohim këtu. Veçanërisht kur kemi fjalë edhe për personin për të cilin po flitet, i cili është i dyshuar tashmë për afera të mëdha të korrupsionit brenda RTK-së, të cilin tash Bordin e zgjodhi si drejtor të përgjithshëm për t'ia mundësua që t'i fshehë këto gjurmë të korrupsionit, për të cilat po përflitet. Pra, është absolutisht i papranueshëm ky vendim i Bordit dhe mendoj që Kuvendi duhet ta ketë mundësinë që të kërkojë anulimin e këtij drejtori derisa të kompletohet Bordin dhe drejtori i ri të rizgjidhet pastaj në një proces të rregullt.

Pra, për ta përmbledhur atë që e thashë: Votimi për anëtarë të Bordit të RTK-së duhet të vazhdojë sot, aty ku ka mbetur, dhe Kuvendi duhet të marrë masa karshi kësaj zgjedhjeje jolegjitime edhe të fshehtë të drejtorit të përgjithshëm të RTK-së.

KRYESUESI: Sa i përket drejtorit, kjo mendoj se nuk është çështje jona, dhe nuk e kemi hapur diskutimin për këtë. Mund të thoni ju çfarë të doni, nuk ka ndonjë problem. Në emër të Koalicionit Kosova e Re, kryetarja zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Duke marrë parasysh kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe duke marrë parasysh se votimi dje u ndërpre, në rast se kërkohet shtyrje, do të isha e mendimit që procesi të nisë prej fillimit. Në rast se nuk doni ta shtyni, atëherë edhe sot të startohet prej fillimit në votimin e këtyre bordeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Miletic, në emër të SLS-së.

PETAR MILETIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Mi ćemo podržati predlog Poslaničke grupe PDK-a, i jeste došlo je do konfuzije šta u stvari odlažemo. Dakle problem je nastao u tome što su dva glasanja spojena u jednu tačku dnevnog reda, i glasalo se istovremeno. Dakle mi smatramo da glasanje o juče treba da bude anulirano, da se krene od početka i da se nastavi sledeće nedelje.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar përsëri zoti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Haliti!

Je deputet i vjetër këtu, që katër legjislacione. Ti e di që në momentin kur kryesuesi e kryeson mbledhjen, ai e interpreton Rregulloren. Çdo gjë çka është thënë është e regjistruar dhe nuk ka nevojë ne të bëjmë variante të interpretimeve për interesa që tashmë po duken që janë të qarta politike. Se për shembull, ne e kemi rastin që një grup, sa kam parë unë, ka fituar kandidati, është zgjedhur, e veç nëse ju pengon pse ka marrë shumë vota - ky është problem tjetër. Pra, arsyetime nuk ka. Arsyetimet janë politike, nuk janë procedurale. Unë mendoj që Kuvendi s'ka as kohë, as nevojë, që të mbërthehet për interesa politike, por duhet të vazhdojë ta kryejë punën si Kuvend i Republikës. Mbledhje është ndërprerë, sepse nuk kanë qenë 61 deputetë në sallë. Nuk ka pasur kurrfarë arsye tjetër, ose kontestimi tjetër. Kështu që me fjalët e fundit: "Vazhdojmë nesër në orën 10:00, sepse mungojnë deputetët, nuk janë 61", ka thanë kryesuesi në momentin kur është ndërprerë mbrëmë mbledhja, dhe nuk kemi çka e interpretojmë.

KRYESUESI: Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë po e përsëris edhe një herë kërkesën time për shtyrje të seancës për javën e ardhshme.

KRYESUESI: Zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Janë tri gjëra që u thanë.

E para është që gjatë seancës Rregullorja interpretohet nga kryetari apo kryesuesi, cilido.

Çështja e dytë, procesi i votimit është i pandashëm, unik - kur të hysh në procesin e votimit. Dje unë e kam shtruar një çështje, të cilën kryetari i Kuvendit nuk e ka nxjerrë në votim, e është dashur ta bëjë këtë. Unë kam thënë se votimi i njëkohshëm për dy pikat e rendit të ditës, për zgjedhjen e dy organeve, është shkelje e Rregullores. Ajo çështje dje nuk është nxjerrë, është dashur të votohet veç e veç. Fillimisht është dashur të votohet për anëtarët e Bordit, dhe pastaj të procedohet me votimin e dytë. Pra, ajo nuk është bërë dhe është shkelje e Rregullores, sepse nuk lejohet improvizim - me një proces të votimit njëkohësisht të votohen për dy institucione. Mendoj që dje është dashur të hidhet në votim propozimi im dhe të shkohet veç e veç për secilën pikë.

KRYESUESI: Kryetarët e grupeve parlamentare janë deklaruar, tani po paraqiten edhe deputetë. Nëse doni, meqë janë edhe tre të paraqitur, keni të drejtë të flitni. Zoti Gashi e ka kërkuar fjalën.

ARBEN GASHI: Unë vetëm sa i përket votimit të njëkohshëm. Mendoj se me një analogji të thjeshtë që mund ta bëjmë, në këtë logjikë do të ishin edhe votimet kur janë mbajtur përherë në Kosovë për zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore do të ishin të pavlefshme, sepse votuesi i ka pasur dy fleta në dorë. Kështu që kjo nuk ka kurrfarë lloj logjike, kurrfarë lloj analogjie. Ne jemi të njëjtit deputetë, që vendosim se kush do të jetë në ato borde dhe ne kemi marrë vendim, i cili është propozuar dhe është përkrahur edhe nga Kuvendi. Është votuar në seancë. Besoj se këtu nuk asnjë gjë për ta shpallur si antikushetuese, sepse ne jemi të njëjtit deputetë. Për arsye kohe, kemi votuar me dy fleta, gjë që është normale, kanë qenë dy kuti, gjithçka ka shkuar në rregull. Nuk ka pasur asnjë lloj kontestimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Unë i kisha dy çështje për t'i shtruar, por ngaqë njëren e konsumoi profesori Arsim, do të propozoja që të fokusohemi brenda Rregullores, të cilën mund ta interpretoni ju dhe e dinë të gjithë deputetët, vetëm kërkesën e kryetarit të grupit parlamentar, sepse siç e dini dhe siç e dinë të gjithë deputetët, ne nuk e kemi pasur në agjendë javore për ditën e sotme këtë mbledhje dhe në agjendë javore kemi mbledhje të tjera, në përgatitje të kongresit, që nuk mbahet çdo vit. Mbahet një herë në katër vjet dhe natyrisht se është një kërkesë e arsyeshme.

Unë kam diçka edhe për rregullsi. E kam një procesverbal me lëndime të shumta, por nuk dua të lëshohem sot në këtë diskutim. E lëmë për mbledhjen e ardhshme. Këta deputetë jemi, këta kandidatë i kemi, këtë procedurë e kemi dhe vendosim se si do ta trajtojmë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gjini, edhe një herë në emër të grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Tani po flas në emrin tim. Mendoj se ajo që e tha deputeti Arsim Bajrami mund të kualifikohet si një formë e mocionit procedural për atë që ka ndodhur gjatë votimit, edhe pse unë personalisht mendoj se është e mundshme të ndodhë një gjë e tillë dhe nuk e shoh si shkelje të Rregullores, prapëseprapë është mocion procedural dhe ju si udhëheqës i seancës duhet ta merrni një qëndrim në lidhje me këtë mocion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zotëri kryesues.

Dje ishim në një proces, i cili u ndërpre për shkak se shumica e deputetëve shkuan dhe ne morëm qëndrim që sot të fillojmë në orën dhjetë. Nga ora dhjetë jemi këtu për ta vazhduar seancën, e unë nuk po kuptoj pse gjithë ky diskutim. Ne duhet at vazhdojmë seancën aty ku kemi ngelur, sipas Rregullores, dhe të kryejmë punë.

Nuk po kuptoj pse na duhet tash të harxhojmë një orë për ta shtyrë një punë, për të cilën jemi marrë vesh dhe të vijmë dhe ta kryejmë sot!

Prandaj, mendoj se në këtë mënyrë po e bëjmë punën joproduktive dhe unë kërkoj që ta vazhdojmë mbledhjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Por, ne duhet t'i saktësojmë gjërat, e në qoftë se ka mocion për shkelje të Rregullores, atëherë ky është një problem më vete. Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Vetëm të ndërlidhem me këto që u thanë, se jam dakord me atë që e tha zoti Gashi, që ne kemi vendosur dhe t'i bëjmë dy procese zgjedhore në të njëjtën kohë, por nuk i kemi përzier ato dy procese zgjedhore. Proceset janë të ndara shumë qartë. Kanë qenë dy fletëvotime të ndryshme, nuk i kemi futur në garë kandidatët për Bordin e RTK-së me ata për Bordin e Komisionit të Pavarur për Media. Pra, këto janë procese të ndara, të cilat kanë ndodhur në të njëjtën kohë dhe analogjia, që e përdori zoti Gashi, është shumë e qartë.

Edhe një çështje tjetër, se këtu po kontestohet nga Grupi Parlamentar i PDK-së - po ashtu dua ta qartësoj edhe një herë. Këta dhe e kanë pasur madje edhe anëtarin në komision, i cili ka ndenjur këtu deri në fund të procesit. Pra, nuk është që PDK-ja nuk ka qenë e pranishme dhe që ky votim është bërë pa praninë e tyre. Nuk kanë qenë shumica e deputetëve për arsye të ndryshme, që nuk po dua t'i diskutoj. Po, si subjekt politik kanë qenë këtu, e kanë propozuar vetë si grup parlamentar zotin Nijazi Idrizi që të jetë anëtar i komisionit dhe ai ka marrë pjesë në punët e komisionit deri në fund kur u vendos që seanca të shtyhet për sot, për shkak të mungesës së kuoromit. Këtë ta kemi të qartë.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYESUESI: Zoti Asllanaj e ka kërkuar fjalën...

SALIH ASLLANAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj që për hiçgjë jemi duke bërë të themi lojëra politike të nivelit të ultë, të cilat ju kisha lutur, ju kryesues, t'i tejkaloni këto, sepse realisht...

KRYESUESI: Unë të kisha lutur, merre fjalën për çka t'u dha!

SALI ASLLANAJ: Po, po, në rregull, mu për atë jam duke e marrë fjalën, prandaj ju kisha lutur që ta menaxhoni mbledhjen, në mënyrë që interpretuesi i fundit, siç tha zoti Hamiti, të jeni ju. Dhe, në asnjë mënyrë nuk mund të na akuzoni neve, që kemi qenë të rregullt në mbledhje dhe e kemi mbajtur mbledhjen deri në fund, se ne jemi fajtorë që të tjerët kanë ikur prej mbledhjes.

Në këtë aspekt, unë mendoj që Grupi Parlamentar i PDK-së do të duhej të jetë më i përgjegjshëm dhe fajin e vet të mos ia hedhë askujt, por të vazhdojmë aty ku kemi mbetur.

Nuk ka gjykatë në botë, besoj, që mund ta kontestojë zgjedhjen e dy kandidatëve, të cilët i kanë marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur në Bordin e RTK-së. Çfarëdo varianti, që mund të sillet rrotull, ata janë zgjedhur në mënyrë procedurale krejt të rregullt. Vazhdojmë aty ku kemi mbetur, i zgjedhim edhe anëtarët tjerë dhe shkojmë!

KRYESUESI: Zoti Grabovci përsëri e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Zoti nënkryetar, kërkesa jonë është e qartë. Ne kërkojmë shtyrjen e seancës për javën e ardhshme. Prandaj, është e drejtë jona. Unë kërkoj përkrahjen me mirëkuptim prej kolegëve të tjerë. Ju faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYESUESI: E kemi një situatë kur po thoni se unë jam interpretues i Rregullores, por nuk po dua ta interpretoj atë për shkak se Rregullorja jemi ne si Kuvend dhe për të gjitha çështjet.

Realisht, dje para se të hyjmë në votim, nuk është votuar kapërcimi, ose shkelja e Rregullores për votimin.

Prandaj, mendoj që nga ky aspekt do të duhej që të shtyhet mbledhja për javën e ardhshme dhe shkelja të interpretohet nga Komisioni për Rregullore dhe pastaj Kryesia të vendosë sesi t'ia bëjmë. Unë mendoj që nga informatat që kam dhe nga Rregullorja që duhet të zbatohet në Parlament, për çdo shkelje Parlamenti duhet të votojë. Shkelje është votimi i njëhershëm për dy çështje.

(Dëgjohet debat në sallë.)

Jo, nuk ka vendosur. Nuk ka votim. Nuk ka vendim në procesverbal. Të lutem! Nuk ka votim në Parlament. Nuk e keni nxjerrë në votim. Dhe, unë po ju them, ne e kemi rrëzuar Presidentin me një lloj votimi të tillë, prandaj nuk po dua ta mohoj mocionin lidhur me këtë, s'po e quaj shkelje, por një kapërcim, do të thosha më i lehtë, por që dikush ka të drejtë të ankohe.

Prandaj, unë dua që Komisioni për Rregullore dhe Komisioni për Legjislacion ta shqyrtojë gjatë javës së ardhshme dhe në mbledhjen e radhës së Kryesisë të konstatohet nëse duhet përsëritur votimi, apo cili variant duhet të shkojë.

Me kaq e përfundoj seancën e sotme! Me kaq...

(Dëgjohet debat në sallë.)

Në votim? Ani, mirë. Por, pritni, ju lutem? E hedhim në votim miratimin e shkeljes. Shaip, ulu! Mirë, nuk është shkelje e trefishtë. Unë po konstatoj që dje të gjithë e kemi pranuar shkeljen dhe nuk kemi votuar për shkeljen.

(Dëgjohet debat në sallë.)

Atëherë, e hedh në votim mocionin e Grupit Parlamentar të PDK-së, të propozuar nga zoti Bajrami me arsyetimin...

(Dëgjohet debat në sallë.)

Prit të lutem! Unë jam tash këtu, unë po e hedh në votim, ju votoni kundër që dje nuk është zbatuar Rregullorja. Domethënë, nuk është votuar për shkelje të Rregullores.

(Dëgjohet debat në sallë.)

Votojmë për... Propozimi i Bajramit është që dje e kemi shkelur Rregulloren. Tani ky është mocion.

(Dëgjohet debat në sallë.)

Ky është mocion! Ky është mocion!

(Dëgjohet debat në sallë.)

Po, pse nuk po e pranoni një diçka që e kemi shkelë, o vëlla?! Po, është shkelë! Unë po ju them që është shkelur. Është shkelur!

Çështja tjetër? Mirë nuk po doni këtë ta votojmë. **E votojmë propozimin ose kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta shtyrë seancën për javën e ardhshme.** Votojmë tash!

Nuk miratohet kërkesa e Grupit Parlamentar që seanca të shtyhet për javën e ardhshme.

(Dëgjohet debat në sallë.)

Kënd? Jo, nuk e përsëris. Po, Zoti Grabovci e ka fjalën. Zoti Grabovci do shpjegim.

ADEM GRABOVCI: Kryesues!

Ju lutem, kontrollojeni teknikën! Nuk ka funksionuar, prandaj nuk kanë mundur... Kontrollojeni...! Mos u çaraveshni pa lidhje! Kontrollojeni teknikën, nuk ka funksionuar, nuk kanë pasur mundësi të votojnë deputetët. Kërkoj të hidhet në rivotim!

KRYESUESI: Unë ju lus të qëndroni në sallë! Mundësinë për ta kontrolluar e kemi. Edhe këtë mund ta plotësojmë. Teknika, regjia, listën e votimit dhe praninë dua të ma numëroni, ju që jeni këtu të paguar për atë punë!

Në sallë janë 101 deputetë. 6 deputetë janë pa kartelë, nuk e kanë kartelën. Jo, jo nuk ka problem, por ta shohim listën si është dhe në qoftë se ka...

(Dëgjohet debat në sallë.)

Jo, jo, është regjia, është në rregull. Nëse ka shkelje e përsëritim, nëse nuk ka e lëmë ashtu, nuk bëhet kiameti.

(Ndërprerje e incizimit.)

Numri i pranisë, sepse nuk po dua kurrkush të hidhërohet, ta shohim si është dhe vendosim. Shkojmë më tutje. Zoti Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Unë kërkoj pauzë prej një ore. Kemi nevojë për konsultime.

KRYESUESI: Faleminderit!

(Dëgjohet debat në sallë.)

(Ndërprerje e incizimit)

Unë mendoj që votimi e ka treguar të veten, janë disa parregullsi, domethënë disa nuk kanë votuar. Nuk kanë votuar, e kemi praninë, por nuk kanë votuar. Votimi është i vlefshëm. Kërkesa për pauzë duhet të miratohet! Faleminderit!

Një orë pauzë!

(Dëgjohet debat në sallë.)

Jo, pauza nuk votohet. Po, lëre, ne e kemi ndërprerë seancën për gjithçka. Është kërkesë e Grupit Parlamentar.

(Dëgjohet debat në sallë.)

E kanë kërkuar dhe unë dua t'ua plotësoj kërkesën. Mund të pini kafe, të pushoni!

Po pushojmë, çfarë të bëjmë. Mua më vjen keq! Unë nuk mund ta vazhdoj mbledhjen, sepse është kërkuar pauzë, nuk është kërkuar ndërprerje e seancës. Faleminderit!

(Dëgjohet debat në sallë.)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Të pranishëm janë 44 deputetë.

Unë dua të jua sqaroj një çështje. Votimi i djeshëm ka qenë i rregullt. E sa i përket asaj pse është votuar njëkohësisht për komisionin dhe për bordin, mendoj që ka qenë krejt normale, sepse edhe për komisionin edhe për bordin edhe së bashku edhe veç e veç, do të kishin votuar të njëjtit deputetë. Dhe, në këtë rrafsh nuk ka pasur asnjë vërejtje as kundërshtim kur e kemi filluar votimin.

Pasi ka përfunduar votimi i parë, rezultati ka qenë i ditur, megjithatë ka qenë kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, nga radhët e Lidhjes Demokratike, që rezultati të shpallet pasi të ndërpritet seanca, prej fillimit. Ka qenë kërkesë e juaja, jo imja.

Dhe, këtu ne mbrëmë e kemi mbyllur mbledhjen plenare për mungesë të kuorumit ose mungesën e deputetëve, siç e kemi edhe sot. Ky është rezultati. Mbledhja plenare sot nuk mund të vazhdojë me këtë përbërje dhe e lëmë për javën e ardhshme.

(Ndërhyrje)

Fjalën e ka, pasi edhe ia përmenda emrin, nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,
Respekt për korrektësi dhe për komunikim që kemi. Unë vetëm po precizoj saktësisht. Po, ka qenë kërkesë imja që e thashë edhe sot në fillim, që një votim i filluar të përfundojë. Jo interpretim përtej kësaj, as për kualitetin, sepse janë deputetët që votojnë qysh duan.

Dhe, aty është ndërprerë mbledhja. Ne s'kemi mund të vendosim bash kurrigjë, sepse s'kemi pasur çka të vendosim dhe sot, me kërkesën tuaj, në të vërtetë, me gjendjen në Kuvend, sepse s'kemi pasur kuorum, kemi ardhur këtu.

Domethënë, kurrigjë e veçantë nuk ka ndodhur, kështu që mendoj që nuk ka nevojë më të bëjmë interpretime të panevojshme, të kota. Kaq!

Ne kemi ardhur dhe jemi këtu që ta vazhdojmë mbledhjen. Nëse s'mund të vazhdohet, nuk është çështje jona.

KRYETARI: Po e shtyjmë mbledhjen plenare në mungesë të kuorumit, kurse për vazhdimin e saj të hënën do të vendosë Kryesia e Kuvendit.
A jeni dakord? Po. Mirupafshim në seancën e radhës!

(Vazhdimi i mbledhjes plenare më 30.1.2013)

(Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Kërkoj nga deputetët që t'i vendosin kartelat e tyre për ta konstatuar praninë e tyre edhe me elektronikë.

Prania elektronike është 71 deputetë, kurse prania fizike është 75. Kush është pa kartelë? Katër. Mirë, domethënë 75 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 21 dhe 24 janar 2013.

Konstatoj se në sallë janë 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për ta filluar punën.

Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, si në vijim.

- Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,

- Zgjedhja e anëtarëve të Bordit për Radiotelevizionin e Kosovës.

1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media

Para se të procedojmë me pikat e mbetura të rendit të ditës së seancës plenare, konstatoj se gjendja është si në vijim.

Sipas rezultateve të votimit në seancën plenare, të mbajtur më 24 janar 2013, për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar kanë qenë të propozuara dy kandidate, por asnjëra nuk i ka marrë votat e nevojshme.

Kurse për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komunitetit serb është zgjedhur zonja Vesna Jovanović, e cila i ka marrë votat e mjaftueshme.

Pra, sipas rezultateve të votimit në seancën plenare, të mbajtur më 24 janar 2013, duhet të përsëritet konkursi për zgjedhjen e një anëtari nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Të pranishëm 82 deputetë, prania fizike elektronike 79.

2. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Sipas rezultatit të votimit në seancën plenare, të mbajtur më 24 janar 2013, për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në votimin e parë, nga 6 kandidatët e propozuar

nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, që është dashur të zgjidhen tre kandidatë, vetëm dy kandidatë i kanë marrë votat e mjaftueshme, si vijon:

- Besa Bytyqi dhe
- Faton Mehmetaj.

Kandidatët me numrin më të vogël të votave, Ibrahim Kadriu dhe Murat Musliu, hiqen nga lista.

Prandaj, në rundin e dytë të votimit edhe për një anëtar duhet të shkojnë dy kandidatë të tjerë që kanë fituar më shumë vota, si vijon:

- Blerta Zeqiri dhe
- Mustafë Halili,

Kurse për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti turk, meqë asnjëri nuk e ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave, konkursi duhet të përsëritet.

Pra, në seancën e sotme duhet ta votojmë një kandidat nga dy të propozuar për anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Lus anëtarët e Komisionit të votimit, që janë emëruar në seancën e mbajtur më 24 janar 2013, t'i zënë vendet e tyre dhe të fillojmë procesin e votimit të fshehtë.

Sqarimet i morët, ky është rezultati i votimit të datës 24 janar. Jo, jo, jemi në procesin e votimit dhe nuk kemi asnjë kërkesë. Nga votat janë eliminuar, nuk i kam eliminuar unë.

Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri; Afrim Hoti,...

Koalicioni për Kosovë të Re? Myzejene kë e propozon grupi juaj? Do të thotë grupi juaj e propozon Sevdije Lamën. Sevdije, zini vendin tuaj!

...Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi,...

...Hashim Dëshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi

Haziri, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Haljilji, Myzejene Selmani...

...Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyqi, Sasha Milosavleviq, Petar Miletqi, Rada Trajkoviq, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Asllanaj, Sali Morina, Salije Mustafa, Sasha Gjokiq, Milivoje Stojanoviq, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviq, Sreten Ivanoviq, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri,...

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

...Vjollcë Krasniqi, Vjosë Osmani, Valbonë Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmak, Xhevdet Neziraj dhe Zenun Pajaziti.

(Ndërprerje e incizimit.)

NIJAZI IDRIZI: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Po fillojmë me numërimin e votave për anëtarë të Bordit të RTK-së:

Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, Mustafë Halili, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, e pavlefshme, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, Blerta Zeqiri, Blerta Zeqiri, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri; Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, e pavlefshme, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, Mustafë Halili, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, e pavlefshme, e pavlefshme, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, e pavlefshme, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, e pavlefshme, e pavlefshme, e pavlefshme, Mustafë Halili, Blerta Zeqiri, Mustafë Halili dhe Blerta Zeqiri.

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit votues, deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: I nderuari kryetar,
Të nderuar deputetë,

Komisioni votues për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës paraqet këtë raport për rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit numër 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit:

Komisioni votues, i formuar me vendim të Kuvendit, më 24 janar 2013, dhe i plotësuar sot, në përbërje nga 1 përfaqësues të secilit grup parlamentar:

- Nijazi Idrizi, PDK;
- Salih Morina, LDK;
- Albana Gashi, “Vetëvendosje”;
- Kymete Bajraktari, AAK,
- Sevdije Lama, AKR,
- Milivoje Stojanović, SLS,
- Fikrim Damka, “6+”;

pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në mbledhjen plenare, të mbajtur sot, më 30 janar 2013, konstaton:

- në votim kanë marrë pjesë 106 deputetë.
- të pavlefshme janë shpallur 39 fletëvotime,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, janë si në vijim:

- Blerta Zeqiri ka fituar 20 vota;
- Mustafë Halili ka fituar 47 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit numër 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se nuk kemi fitues as me këtë rast, për shkak se kemi të bëjmë me një votim progresiv, në të cilin do të duhej të kishin votuar për kandidatin 2/3 e votuesve, prandaj do të vazhdohet me procedura të mëtutjeshme.

KRYETARI: Faleminderit! Pra, Rregullorja nuk është shkelur dhe është shumë mirë. Konkursi për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës përsëritet për 2 kandidatë, 1 kandidat të shumicës shqiptare dhe një kandidat të pakicës turke.

Mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë